



Kingdom of the Netherlands




Centre for Legal
Empowerment
www.cle.al



ALBANIAN
INSTITUTES
for Research

MANUAL

PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT
TË PARTNERITETEVE PUBLIKE PRIVATE
NË SHQIPËRI



Tiranë, Maj 2025

MANUAL TRAJNIMI

***PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË
PARTNERITETEVE PUBLIKE PRIVATE
NË SHQIPËRI***

Ky Manual u mundësua me mbështetjen e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës në kuadër të programit MATRA.

Opinionit i shprehur në këtë Manual është personal i autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pozicionin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Holandës.

Tiranë, Maj 2025

PËRMBAJTJA

SHKURTIME	5
I. HYRJE	6
MODULI I	10
PARTNERITETI PUBLIK PRIVAT	10
1. Hyrje	10
2. Çfarë duhet kuptuar me Partneritet Publik Privat?	10
3. Dallimet midis një PPP-je dhe një Kontrate të Prokurimit Publik	14
3. Konceptet kryesore që duhet të mbahen parasysh për identifikimin e një Kontrate si PPP	16
4.1 Risku	17
4.2 Financimi	21
4.3 Monitorimi	23
5. Cilat janë format e PPP-ve?	23
6. Objekti i Prokurimit të Partneritetit Publik Privat	26
Figura nr. 5	28
7. Parimet mbi të cilat Zhvillohet Procedura për Dhënien e PPP-ve	29
7.1 Trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi (Neni 17, K.Pr.A)	29
7.2 Parimi i proporcionalitetit (Neni 12 K.Pr.A)	30
7.3 Parimi i efikasitetit	30
7.4 Parimi i reciprocitetit	31
7.5 Parimi i sigurisë ligjore	31
7.6 Parimi i parandalimit të konfliktit të interesave	32
MODULI 2	33
PROCEDURA E DHËNIES SË PPP-VE	33
1. Hyrje	33
2. Identifikimi i projektit dhe inicimi i procedurës së PPP-së	34
3. Roli dhe kompetenca e institucioneve kompetente në zhvillimin e procedurave të PPP-ve	35
3.1 Ministritë	36
3.1.1 Kompetencat dhe detyrat e ministrisë përpara lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues	36

3.1.2	Kompetencat dhe detyrat e ministrisë gjatë zbatimit të kontratës	37
3.2.	Agjencia e Prokurimit Publik	37
3.3	Njësia e trajtimit të Koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private (neni 12 ligjit).....	38
3.3.1	Bashkëpunimi me autoritet kontraktore	38
3.3.2	Bashkëpunimi me APP.....	39
3.3.3	Bashkëpunimi me Komitetin e përzgjedhjes së projekteve të koncesionit/PPP	39
3.4	Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/ PPP (neni 12/1).....	39
3.5.	Autoritetet kontraktuese (Neni 13 i ligjit)	40
4.	Fazat procedurale të Dhënies dhe Përzgjedhjes së një PPP-je.....	40
4.1	Procedura paraprake.....	41
4.1.1	Elementet që duhet të përmbajë studimi i fizibilitetit.....	42
4.1.2	Propozimet e pakërkura	44
4.2	Zhvillimi i procedurës së dhënies së PPP-së	45
4.2.1	Shpallja e njoftimit për zhvillimin e procedurës së dhënies së PPP-së.....	45
	Plotësimi i dokumenteve standarde në të gjitha rubrikat e tij është një kusht i domosdoshëm për garantimin e zhvillimit të një procedure të drejtë, të barabrtë, transparente dhe në përputhje me kuadrin ligjor.	49
4.2.2	Kriteret dhe dokumentacioni	49
4.2.3	<i>Kriteret e vlerësimit për dhënien e kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat. (neni 23 i LKPPP)</i>	50
4.2.4	Miratimi dhe konfirmimi i Procedurës së Koncesionit/PPP-së nga Ministria përgjegjëse për financat	51
4.2.5	Përzgjedhja e fituesit dhe nënshkrimi i Kontratës	52
5.	Procedura e ankimit (Neni 43, LKPP)	52
6.	Treguesit (indiktorët) për vlerësimin dhe monitorimin e respektimit të akteve ligjore dhe nënligjore për Zhvillimin e Procedurave të PPP-ve.....	53
	MODULI 3.....	56
	ELEMENTET E KONTRATËS SË PPP-së.....	56
1.	Hyrje	57
2.	Palët në një marrëdhënie PPP-je	57
2.1	Autoriteti Kontraktues	57
2.2	Operatori Ekonomik	58
2.3	Subjekti për qëllime të veçanta (SPV) (Neni 39, LKPP).....	59
3.	Përmbajtja e Kontratës së Koncesionit/PPP-së (Neni 27, LKPPP).....	60
4.	Afati i Kontratës së PPP-së (Neni 35, LKPP).....	67

5. Garancitë e realizimit të Kontratës (Neni 28, LKPP).....	67
6. Ndryshimi i Kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat (Neni 31, LKPP).....	68
7. Zgjidhja e Kontratës (Neni 36, LKPP).....	69
8. Treguesit (Indikatorët) për vlerësimin dhe monitorimin e respektimit të akteve ligjore dhe nënligjore për Zhvillimin e Procedurave të PPP-ve	70
MODULI 4.....	73
MONITORIMI I ZBATIMIT TË KONTRATËS SË PPP-SË.....	73
1. Hyrje	73
2. Situata aktuale e zbatimit të Kontratave të Koncesioneve/PPP-ve në Shqipëri	73
3. Monitorimi i zbatimit të Kontratave të PPP-ve	75
4. Procedura e monitorimit të zbatimit të Kontratave të Koncesionit/PPP-së.....	76
5. Afatet e monitorimit të zbatimit të Kontratave të Koncesioneve/PPP-ve	82
6. Treguesit (Indikatorët) për monitorimin e fazës së zbatimit të Kontratave të Koncesionit/PPP-ve	83
MODULI 5.....	85
TRANSPARENCA DHE MARRJA E INFORMACIONIT MBI NJË	
PROCEDURË/KONTRATË PPP-JE	85
2. Transparenca e institucioneve publike në lidhje me Zhvillimin Procedurës së PPP-ve	86
2.1 Regjistri i Koncesioneve/Partneritetit Publik Privat.....	87
2.2 Programet e transparencës	90
2.3 Informacioni në lidhje me dokumentet standarde të Procedurës së PPP-së dhe njoftimit të PPP-ve	91
3. E drejta për të kërkuar informacion mbi një procedurë koncesioni/PPP-je	93
4. E drejta e informimit dhe respektimi i parimit të konfidencialitetit	95
RASTE STUDIMORE.....	99
LITERATURA.....	100

SHKURTIME

APP	Agjencia e Prokurimit Publik
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
KDI	Komisioneri për të Drejtën e Informimit
ATRAKO	Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve
KPP	Komisioni i Prokurimit Publik
GJK	Gjykata Kushtetuese
GJL	Gjykata e Lartë
GJED	Gjykata Evropiane e Drejtësisë
BE	Bashkimi Evropian
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
KPA	Kodi i Procedurës Administrative
LKPPP	Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”; i ndryshuar
LPP	Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; i ndryshuar
VKM	
NR.575/2013	VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me Koncesion/Partneritet Publik Privat,” i ndryshuar
PPP	Partneritet Publik Privat
AK	Autoritet Kontraktor
BOT	Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë
OP	Operator Ekonomik
SQV	Subjekti për Qëllime të Veçanta

I. HYRJE

Manuali i Trajnimit mbi “*Monitorimin e Kontratave të Partneritetit Publik Privat*”, është hartuar në kuadër të projektit “*Building capacities for sustainable monitoring of public contracts*”, i zbatuar nga Centre for Legal Empowerment (CLE) me mbështetjen e “*MATRA - European Cooperation Embassy Program 2024*”.

Manuali ka për qëllim të fuqizojë shoqërinë civile, ekspertë të fushës, studentët në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të procedurave dhe lidhjen e Kontratave të Partneritetit Publik Privat (PPP) në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe zbatimi dhe monitorimi i tyre nga institucionet përgjegjëse. Nëpërmjet trajnimeve, informimit dhe njohurive të thelluara synohet që të ndërtohet një koalicion i organizatave të shoqërisë civile, medias, akademikëve dhe ekspertëve me aftësitë dhe mjetet e nevojshme për të monitoruar dhe raportuar për aktivitetet e prokurimit të Partneritetit Publik Privat, duke nxitur llogaridhënien e institucioneve kompetente.

Aftësimi, informimi dhe thellimi i njohurive mbi PPP-të do të shërbejë si një pikënisje dhe udhëzues (guide) për aktorët e shoqërisë civile, gazetarë, studentë apo aktorë të tjerë që të ndërmarrin nisma në kuadër të mirëmenaxhimit të buxhetit të shtetit në rastin e Kontratave të PPP-së, zbatimi i kritereve dhe kushteve, të cilat mundësojnë ofrimin e një shërbimi cilësor dhe efektiv nga operatorët që marrin përsipër kryerjen e një shërbimi apo veprimtarie në bazë të një PPP-je, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të legjislacionit nëpërmjet:

- Ndërtimit të një analize të plotë dhe të gjithanshme mbi elementet, kriteret dhe kushtet e zbatimit, efektet juridike dhe pasojat e një Kontrate PPP-je.
- Ofritit për organizatat e shoqërisë civile, gazetarë, studentë apo aktorëve të tjerë të një udhëzuesi (guide) me gjuhë të thjeshtë mbi kushtet dhe kriteret ligjore, si dhe indikatorët dhe mënyrën e monitorimit të zbatimit në praktikë, në mënyrë që të nxiten, përmirësohen dhe harmonizohen nismat e tyre për të monitoruar zbatimin e PPP-ve.
- Ndërtimit të një observatori, i cili do të shërbejë si një vend takimi midis organizatave të shoqërisë civile, gazetarëve, studentëve apo aktorëve të tjerë me institucionet publike, me qëllim informimin, ofrimin e një asistence të mirëfilltë ligjore, si dhe monitorimin e procedurave të Kontratave të Partneritetit Publik Privat.

Nëpërmjet këtij manuali do të analizohen në mënyrë të detajuar parimet, kushtet dhe kriteret për dhënien e një procedure të PPP-së, lidhjen e kontratës, monitorimin e zbatimit të saj, duke u ndalur në katër komponente kryesore:

1. **Çfarë do të kuptojmë me PPP dhe si mund të dallojmë një Kontratë PPP-je?**
2. **Zhvillimi i procedurës për dhënien e një Kontrate PPP-je.**
3. **Kontrata e PPP-së dhe monitorimi i zbatimit të saj.**
4. **Transparenca dhe e drejta e informimit mbi PPP-të.**

Metodat në bazë të të cilëve do bazohet realizimi i këtij manuali janë:

Metoda e kërkimit shkencor. Përmes kësaj metode do të synohet kërkimi shkencor në lidhje me identifikimin dhe analizimin e parashikimeve ligjore ndërkombëtare dhe të legjislacionit të brendshëm në lidhje me standardet e aplikimit të procedurave të PPP-ve, të drejtat dhe detyrimet e institucioneve publike, të drejtat dhe detyrimet e operatorëve që ofrojnë shërbimet në bazë të

kontratave publike (PPP). Janë marrë në analizë raporte dhe studime të kryera nga organizata të tjera në lidhje me zbatimin e PPP-ve, me qëllim krahasimin e të dhënave dhe identifikimin e indikatorëve konkrete për secilin modul.

Metoda cilësore, në lidhje me aspekte të ndryshme të zbatimit të procedurave të PPP-ve janë dërguar kërkesa për informacion institucioneve të ndryshme. Në bazë të të dhënave/dokumentacionit të vendosur në dispozicion janë analizuar në mënyrë konkrete konceptet dhe procedurat e dhënies së PPP-ve.

Monitorime të procedurave të PPP-ve. Gjithashtu janë monitoruar procedura, kontrata dhe dokumentet standarde të dhënies së procedurave të PPP-së me qëllim ndërthurjen e analizës ligjore me aplikimin e tyre në praktikë. Në vijim të analizës janë identifikuar konceptet dhe kriteret/kushtet për zhvillimin, përzgjedhjen e operatorit fitues, lidhjen e kontratës, si dhe procedurën e monitorimit të zbatimit të kontratës. Janë përzgjedhur disa kriteret dhe indikatorë të ligjit, të cilat janë formuluar në gjuhë të thjeshtë, me qëllim që të mund të zbatohen nga grupet e trajnuara, të që do t'u referohen për vijimin e monitorimeve në të ardhmen.

Manuali do të ndahet në pesë (5) module, ku secili modul do të strukturohet në disa nëntema, me qëllim analizimin në mënyrë të detajuar të të gjitha elementeve që përmbajnë katër (4) komponentët e mësipërm:

Moduli 1: Do të përmbajë një analizë të detajuar se çfarë do të kuptojmë me Partneritet Publik Privat, kriteret sesi mund të dallojmë një kontratë PPP-je, cilat janë konceptet kryesore mbi të cilat zhvillohet një procedurë PPP-je, parimet të cilat udhëheqin procedurën e PPP-së, fushat dhe llojet e PPP-ve.

Moduli 2: Do të përmbajë një analizë të detajuar të zhvillimit të procedurës së PPP-së, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen, roli dhe kompetenca e institucioneve, bashkëpunimi midis tyre para dhe gjatë zhvillimit të procedurës së dhënies së PPP-së dhe monitorimi pas lidhjes së Kontratës së PPP-së. Në fund të modulit do të shpjegohen në mënyrë të detajuar indikatorët për monitorimin dhe analizimin e të dhënave për zhvillimin e procedurës së PPP-së.

Moduli 3: Do të përmbajë një analizë të detajuar të elementeve dhe kushteve që duhet të përmbajë Kontrata e PPP-së, të drejtat dhe detyrimet e palëve, respektimi i detyrimeve dhe përgjegjësitë ligjore në rast të shkeljeve të detyrimeve, përfundimi dhe zgjidhja e kontratës. Analiza ligjore do të ndërthuret me shembuj nga praktika me qëllim konkretizimin e aspekteve ligjore me zbatimin e tyre. Në fund të modulit do të shpjegohen në mënyrë të detajuar treguesit për monitorimin dhe analizimin e të dhënave të Kontratës së PPP-së.

Moduli 4: Në këtë modul do të analizohet dhe trajtohet në mënyrë të detajuar një nga aspektet më të rëndësishme të një kontrate të PPP-së, që lidhet me monitorimin gjatë zbatimit të kontratës. Analiza do të ndërthuret me raste nga praktika, të dhëna statistikore, raporte të institucioneve kompetente me qëllim dhënien e një tabloje të plotë mbi kriteret dhe elementet e monitorimit të kontratës, rekomandimet për përmirësimin e zbatimit të Kontratës, efektet që kanë raportet e

monitorimit për përmirësimin e ofrimit të shërbimit apo kryerjes së veprimtarisë nga ana e operatorëve. Në fund të modulit do të shpjegohen në mënyrë të detajuar treguesit (indiktorët) për monitorimin dhe analizimin e elementeve të zbatimit të një Kontrate të PPP-së.

Moduli 5: Do të përmbajë një analizë të detajuar mbi transparencën dhe të drejtën e publikut për t'u informuar mbi procedurat, kontratat e PPP-së dhe monitorimit të zbatimit të tyre. Do të analizohen rastet kur kjo e drejtë mund të kufizohet për shkak të respektimit të parimit të konfidencialitetit/sekretit tregtar. Analiza ligjore do të ndërthuret me raste nga praktika, me qëllim thellimin e njohurive dhe konkretizimin e aspekteve ligjore me synimin e ofrimit të elementeve dhe mjeteve juridike sesi mund të aksesojmë informacionin në lidhje me PPP-të. Në fund të modulit do të shpjegohen në mënyrë të detajuar indikatorët për monitorimin e respektimit të parimit të transparencës dhe të drejtës së informimit nga institucionet publike.

Manuali synon dhënien e një tabloje të plotë mbi kriteret, parimet, procedurat e zhvillimit të PPP-ve, përzgjedhja e ofertuesit, monitorimi i zbatimit të kontratave, duke i ndërthurur me raste nga praktika/shembuj konkretë, që do të shërbejnë si një udhëzues praktik për informimin dhe trajnimin e gazetarëve, punonjësve të OJF-ve, studentëve, ekspertëve, juristëve, paraligjorëve etj. duke pasur në fokus identifikimin e problematikave dhe dhënien e rekomandimeve konkrete për përmirësimin e tyre.

Manuali ka për qëllim:

- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi konceptet kryesore të një procedure PPP-je, si dhe të rëndësisë që kanë Kontratat e PPP-së në shërbimet që ofrohen për publikun.
- Të ofrojë njohuri të thelluara në lidhje me procedurat, kriteret dhe kushtet e lidhjes së një kontrate të PPP-së dhe elementeve thelbësore që duhet të përmbajë kontrata.
- Të shërbejë si një udhëzues i plotë dhe me një gjuhë të thjeshtë në lidhje me hapat dhe fazat e zhvillimit të një PPP-je.
- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi zbatimin dhe monitorimin e një Kontrate të PPP-së gjatë zbatimit të saj.
- Të shërbejë si një urë lidhëse midis publikut dhe institucioneve kompetente, duke i mundësuar dhe dhënë aktorëve të shoqërisë civile, gazetarëve, studentëve apo aktorëve të tjerë mjetet ligjore për t'u përfshirë në mënyrë aktive në monitorimin e PPP-ve.
- Nëpërmjet ndërthurjes së metodës teorike me raste (kazuse) dhe zgjidhjes së ushtrimeve nga praktika, do të synojmë aftësimin dhe rritjen e kapacitetit ligjor të aktorëve të shoqërisë civile, studentëve, gazetarëve dhe praktikantëve të ligjit për njohjen e kuadrit ligjor të PPP-ve dhe monitorimin e tyre.

Aktorët e shoqërisë civile, gazetarët, studentët dhe çdo person i interesuar që do marrë pjesë në trajnime apo do studiojë “Manualin”, do ketë aftësitë e duhura për të ndërmarrë nisma të përfshirjes aktive në rritjen e përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve kompetente, përmirësimin të mënyrës së zbatimit të ligjit dhe kontratës së PPP-së, si dhe të monitorimit të zbatimit të kontratës, monitorimit të cilësisë së shërbimit apo e veprimeve që do kryhen dhe ofrohen në kuadër të kontratës nga ana e operatorëve, ndikimi në buxhetin e shtetit në raport me produktin që do marrin qytetarët etj.

MODULI I

PARTNERITETI PUBLIK PRIVAT

1. Hyrje

Miradministrimi i fondeve publike është një element i rëndësishëm jo vetëm për funksionimin e aparatit shtetëror, por edhe në krijimin dhe përmirësimin e shërbimeve të ndryshme për qytetarët. Mënyra e administrimit të fondeve publike dhe rregullat e shpërndarjes (alokimit) të tyre te operatorët ekonomikë për blerjen e mallrave, kryerjen e punëve apo ofrimin e shërbimeve janë parashikuar në ligjin për prokurimet publike dhe ligjin për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat.¹

Bashkëpunimi midis një institucioni publik dhe një subjekti juridik (operatori ekonomik) për të kryer një veprim apo një shërbim në interes publik, bazuar në një marrëveshje juridike (kontratë) është emërtuar si Kontratë e Partneritetit Publik Privat ose PPP.

Ndryshe nga Kontratat e lidhura në sektorin privat, ku palët me marrëveshje midis tyre përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet për të hyrë në marrëdhënie kontraktore, PPP-të i nënshtrohen një procedure të veçantë, e cila rregullohet nga ligji i posaçëm.

Modeli i ekonomisë së tregut që po ndjek Shqipëria, me një sektor shtetëror gjithnjë e më të vogël, e bën të domosdoshëm ngritjen dhe forcimin e një partneriteti mes sektorit shtetëror dhe atij privat, sidomos për projekte me rëndësi strategjike. Qëllimi kryesor i një partneriteti të tillë sigurisht është përmirësimi i efikasitetit dhe cilësisë së shërbimit dhe produkteve. Këto marrëdhënie kanë lindur si një instrument i rëndësishëm për të pakësuar deficitin infrastrukturor. Sfida parësore e një qeverie, kur është fjala për një angazhim të tillë partneriteti, “konsiston në mënyrën sesi do të realizojë ndërveprimin e sektorit publik me atë privat”. Kjo sfidë nuk mund të marrë një përgjigje standarde, pasi për çdo sektor dhe në shumicën e rasteve, për çdo projekt, ka një përgjigje specifike.²

Në këtë modul do të analizohen elementet që përcaktojnë një marrëdhënie juridike si Partneritet Publik Privat, dallimet me Kontratat e tjera të prokurimit publik, parimet që udhëheqin Zhvillimin e një Procedure të PPP-së.

2. Çfarë duhet kuptuar me Partneritet Publik Privat?

Kalimi i të drejtës për kryerjen e disa shërbimeve apo veprimeve nga institucionet publike te subjektet private, të financuara nga buxheti i shtetit apo nga subjekti privat (kundrejtë të drejtës për të përfituar të ardhurat e ofrimit të shërbimit) kërkon ndërrmarjen e një sërë veprimesh me qëllim miradminsitrimin e buxhetit dhe ofrimit të një shërbimi cilësor për qytetarët.

¹ Zhidro, A & Kurti, A (2021) “Kryerja e një vepre penale, kriter skualifikues për të marrë pjesë në prokurimet publike dhe përfitimin e fondeve publike. Rastet përjashtimore”. Konferencë Shkencore, organizuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, 18 shkurt 2021

² Shih Kraja, D. Doktoratura “Partneriteti Publik Privat, Koncesionet si një mënyrë menaxhimi dhe financimi i shërbimeve publike”, aksesuar në datën 29.01.2025 në linkun [Doktoratura-Durim-Kraja-Fakulteti-Ekonomik-Departamenti-i-Manaxhimit 2 PPP.pdf](#)

Shteti hyn shpesh në marrëdhënie kontraktore me një subjekt privat për krijimin, ndryshimin e veprimeve juridike të ndryshme, si shitjen, dhënien me qira të pronave shtetërore, ndërtimin e një objekti shtetëror, apo që kryen një funksion publik, krijimin e një subjekti tregtar me bashkëpronësi midis shtetit dhe subjektit privat, realizimin e një shërbimi, apo kryerjen e një vepre publike, si p.sh. ndërtimi i një rruge publike, prodhimi i energjisë etj.

Të gjitha këto veprime juridike të kryera midis dy palëve, shtetit nga njëra anë (institucionet publike) dhe subjektit privat nga ana tjetër, vishen me formën juridike të kontratave administrative.

“Kontrata administrative” është një marrëveshje, e cila krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie konkrete, sipas së drejtës publike dhe në të cilën të paktën njëra nga palët kontraktuese është një organ publik. (Neni 3, pika 4 e Kodit të Procedurës Administrative).

Kontrata e Partneritetit Publik Privat është një nga llojet e kontratave administrative, e cila nënkupton një formë bashkëpunimi afatgjatë, të rregulluar me kontratë, ndërmjet autoritetit kontraktues, domethënë partnerit publik, dhe një ose më shumë operatorëve ekonomikë, domethënë partnerit privat.

Bashkëpunimi midis një institucioni publik dhe një subjekti juridik (operatori ekonomik) për të kryer një veprim apo një shërbim në interes publik, bazuar në një marrëveshje juridike (kontratë) është emërtuar si Kontratë e Partneritetit Publik Privat ose PPP.

Bazuar në përkufizimin e dhënë nga Udhëzuesi referues për Partneritetet Publik Privat, (Banka Botërore, 2014), si një koncept i gjerë që duhet të aplikohet, si për infrastrukturën dhe shërbimet e reja ashtu edhe për ato ekzistuese, një PPP mund të përkufizohet si:

“Një kontratë afatgjatë ndërmjet një pale publike dhe një pale private,³ për zhvillimin dhe/ose menaxhimin e një vepre ose shërbimi publik, në të cilin agjenti privat bart rrezik të konsiderueshëm dhe përgjegjësi menaxhimi gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, ndërsa shpërblimi është i ndërlidhur në mënyrë të konsiderueshme.”⁴

³ "Palë private" është termi i përzgjedhur për t'iu referuar agjentit (agjentëve) ose pjesëmarrësit (pjesëmarrësve)

⁴<https://ppp-certification.com/sites/ëëë.ppp-certification.com/files/documents/Kapitulli%201%20-%20Partneriteti%20Publik-Privat%20-%20Hyrje%20dhe%20Pasqyr%C3%AB.pdf>

Bazuar në përcaktimet e shumta, OECD-ja ka bërë përgjithësimin e tyre duke dhënë një përkufizim të koncesioneve, i cili është pranuar në përgjithësi. Sipas tij një marrëveshje me palët private mund të konsiderohet Koncesion/PPP, kur

“Përfitimet financiare dhe jofinanciare të koncesionarit të sigurohen pjesërisht ose tërësisht nga e drejta për të shfrytëzuar punët/shërbimet e kryera” dhe “... risku për shfrytëzimin e kësaj mundësie të mbetet tërësisht mbi koncesionarin.”⁵

Referuar përkufizimeve të mësipërme, si dhe bazuar në dispozitat e akteve ligjore në fuqi, skema e një Kontrate të PPP-së, është si më poshtë:




Figura nr.1

Skema e mësipërme paraqet në parim marrëdhënien midis autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik në një procedurë të Partneritetit Publik Privat, e cila është e një lloji të veçantë, pasi ndryshe nga kontratat publike ku riskun e mban autoriteti kontraktor, te PPP-të risku, si rregull, duhet të tranferohet te Operatori Ekonomik, por nga ana tjetër, autoriteti kontraktor është përgjegjës ndaj publikut në lidhje me shërbimin që ofrohet dhe menaxhimin/mbrojtjen e buxhetit të shtetit nga pasojat negative. Në vijim të manualit do të shpjegohen në mënyrë të detajuar secila nga këto elemente.

⁵ Shih Manuali i Auditimit të Projekteve të Partneritetit Privat Publik (PPP), Kontrolli i Lartë i Shtetit

Ndryshe nga kontratat e lidhura në sektorin privat, ku palët me marrëveshje midis tyre përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet për të hyrë në marrëdhënie kontraktore, PPP-të i nënshtrohen një procedure të veçantë, e cila rregullohet nga ligji i posaçëm.

Ligji që rregullon PPP-të është me nr. 125/2013 *“Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”*,⁶ i cili ka ndryshuar mbi katër (4) herë, për shkak të zhvillimit ekonomik, teknologjik, politik; me qëllim përshtatjen dhe rregullimin e problematikave të konstatuara, duke e përafruar legjislacionin me „*acquis communautaire*“.

Me qëllim që një kontratë publike të konsiderohet PPP, duhet të plotësojë disa kushte (Neni 8 i Ligjit):

- a) partneri privat merr përsipër detyrimin për t'u ofruar shërbime publike përdoruesve të shërbimeve brenda fushës së kompetencave të partnerit publik dhe/ose detyrimin për t'i siguruar partnerit publik parakushtet e nevojshme për t'u ofruar shërbimet publike përdoruesve të shërbimeve dhe/ose veprimtaritë brenda fushës së kompetencave të tij;
- b) partneri privat, me qëllim që të përmbushë detyrimet e shkronjës “a” të kësaj pike, mund të marrë përsipër:
 - i) detyrimin që të financojë, të projektojë, të ndërtojë dhe/ose të rindërtojë/të rinovojë objektin e infrastrukturës publike, të operojë dhe të mirëmbajë objektin e infrastrukturës publike të ndërtuar dhe/ose të rindërtuar/të rinovuar rishtazi;
 - ii) detyrimin që të përdorë, të operojë dhe të mirëmbajë një objekt ekzistues të infrastrukturës publike;
 - iii) çdo kombinim i detyrimeve të përmendura më lart, për sa kohë që kombinimi i këtyre detyrimeve është për qëllim të përmbushjes së objektivave të përcaktuar në shkronjën “a” të kësaj pike;
- c) në kuadër të marrjes përsipër të detyrimeve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, partneri privat zakonisht merr përsipër nivele dhe shtrirje të ndryshme të risqeve, që lidhen me financimin, ndërtimin, kërkesën dhe/ose disponueshmërinë, dhe të tjera si operimi, menaxhimi, mirëmbajtja dhe risqet teknike, varësisht nga forma e Partneritetit Publik Privat dhe varësisht nga përcaktimi, rast pas rasti;
- d) për kohëzgjatjen e partneritetit publik privat çdo partner, zakonisht, merr përgjegjësinë për rastet e riskut që janë nën sferën e ndikimit të tij ose përgjegjësia ndahet;
- e) partneri privat shpërblehet kryesisht, por jo ekskluzivisht, në përputhje me kontratën:
 - i) duke iu dhënë e drejta për të shfrytëzuar veprat publike dhe/ose shërbimin publik, kryesisht me qëllimin e vendosjes së tarifave ose pagesave nga përdoruesit fundorë dhe konsumatorët ose kjo e drejtë së bashku me mbështetjen financiare;

⁶ Ky ligj përafron direktivën 2004/18/EC të Parlamentit Europian dhe të Këshillit të 31 marsit 2004 për koordinimin e procedurave të prokurimit për shpalljen fituese të kontratave publike për punë, furnizime dhe shërbime, numri CELEX: 32004L0018, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, Seria L, nr. 134, datë 30.4.2004, faqe 114-240.

- ii) me pagesat e rregullta të drejtpërdrejta të paguara nga/ose në emër të partnerit publik, zakonisht në lidhje me disponueshmërinë e objektit dhe/ose shërbimit të ofruar;
 - iii) me forma të tjera të mbështetjes financiare, duke përfshirë transferimin e të drejtave materiale dhe të drejtave të tjera reale;
 - iv) një kombinim i mjeteve të përshkruara më lart;
- dh) partneri publik i mundëson partnerit privat kryerjen e aktiviteteve tregtare, të përcaktuara në kontratë së bashku me detyrimet që rrjedhin nga shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike, nëse kjo siguron nivelin e nevojshëm të efikasitetit të kostos së pjesëmarrjes private dhe kthimit të arsyeshëm të investimit, si dhe një vlerë më të mirë të parasë.

Kontratat e prokurimit publik, që nuk i plotësojnë kushtet e këtij neni, nuk konsiderohen Partneritet Publik Privat. Kushte të tilla nënkuptojnë, por nuk kufizohen vetëm në kohëzgjatjen e kontratës, transferimin e risqeve kryesore të natyrshme dhe mjetet e shpërblimit.

3. Dallimet midis një PPP-je dhe një Kontrate të Prokurimit Publik

Shpesh në praktikë nuk arrihet të bëhet dallimi midis një kontrate të Prokurimit Publik dhe një Kontrate të Partneritetit Publik Privat. Të dy kontratat, ndonëse në pamje të parë mund të duken si të ngjashme, kanë dallime thelbësore midis tyre, të cilat fillojnë nga normat juridike që i rregullojnë deri në kushtet dhe kriteret specifike, mënyra e zbatimit, institucionet përgjegjëse etj.

Për të lehtësuar konstatimin e dallimeve midis një kontrate PPP dhe një kontrate të Prokurimit Publik, ndryshimet janë pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

	Kontratë PPP-je	Kontratë Prokurimi Publik
Emërtimi i kontratës	Kontratë e Partneritetit Publik Privat	Kontratë e Prokurimit Publik
Forma e kontratës	Me shkrim	Me shkrim
Baza ligjore	Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”; i ndryshuar VKM nr. 575, datë 10.7.2013 për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion Partneritet Publik Privat; i ndryshuar	Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; i ndryshuar
Autoritet kontraktor	1. Ministritë	a) institucionet kushtetuese, institucionet e tjera qendrore, institucionet e

	2. Njësitë e qeverisjes vendore	pavarura dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore; b) çdo ent: i. themeluar për të ndjekur një interes të përgjithshëm dhe me karakter joekonomik apo tregtar; ii. i cili ka personalitet juridik; iii. i financuar kryesisht nga shteti, autoritetet rajonale apo vendore ose nga ente të tjera publike apo i administruar prej tyre ose me një bord administrativ, menaxherial apo mbikëqyrës, ku më shumë se gjysma e anëtarëve të tyre emërohen nga shteti, autoritetet rajonale ose vendore apo nga entet e tjera publike; c) organizatat e formuara nga një ose disa nga këto autoritete apo nga një ose disa nga këto organe publike.
Subjekt privat	1. Çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre. 2. Subjekti për qëllime të veçanta (SPV) me kapital të përzier, që zotërohet bashkërisht nga partneri publik dhe privat	Çdo person fizik ose juridik, ose ent publik apo grup personash/entesh, përfshirë shoqëritë me sipërmarrje të përkohshme të tyre.
Risku	Operatoti ekonomik	Autoriteti kontraktor/operatori ekonomik
Shpërblimi	a. Nga operatori ekonomik b. Nga pagesat e shërbimit/shfrytëzimit të objektit/veprimtrisë c. Kompensim nga buxheti i shtetit	Buxheti i shtetit

Tabela nr.1

Sa më sipër, kur jemi përpara një kontrate publike, me qëllim kualifikimin e saj si kontratë PPP-je apo një kontratë e Prokurimit Publik, apo një kontratë tjetër administrative, duhet të mbahen parasysh elementet dalluese të sipërcituar.

3. Konceptet kryesore që duhet të mbahen parasysh për identifikimin e një Kontrate si PPP

Referuar kuadrit ligjor aktual dhe zbatimit të tij në praktikë, shpesh Kontratat e PPP-së janë të njëjta me Kontratat e Prokurimit Publik, pasi një nga elementet thelbësore që bën dallimin midis tyre është risku, i cili në Kontratat aktuale të PPP-së nuk transferohet plotësisht te Operatori Ekonomik.

Bazuar në përcaktimet e shumta, BE i klasifikon Kontratat, që nuk bëjnë transferimin e riskut tek Operatori Ekonomik privat, si kontrata publike të zakonshme dhe jo Koncesione/PPP. Kështu, bazuar edhe në përkufizimin e Direktivës, një Kontratë e tillë nuk mund të jetë koncesion dhe nuk mund t'u nënshtrohet dispozitave të veçanta të Direktivës për koncesionet. Bazuar në këtë Direktivë, edhe Kontratat e PPP-ve të përcaktuara në ligjin shqiptar për koncesionet mund të konsiderohen si kontrata publike të zakonshme midis institucioneve publike dhe operatorëve privatë. Rrjedhimisht, Kontratat publike me operatorët privatë për punë dhe shërbime publike të klasifikuara si PPP, janë të njëjta me prokurimet standarde.⁷

Ndonëse një nga elementet kryesore të një Kontrate PPP-je është risku, në praktikë konstatohen përkufizime dhe përcaktime të ndryshme në lidhje me transferimin e riskut, duke ngatërruar kualifikimin e saktë të Kontratave.

Në Manualin e publikuar nga ATRAKO, në lidhje me konceptin e “riskut”, është shprehur se:

“Në kontratat e PPP partneri privat merr përsipër një pjesë të rreziqeve të lidhura me zbatimin e kontratës. Ndarja e rreziqeve midis partnerëve të kontratës, bazohet mbi parimin që rreziqet duhet ti ngarkohen palës e cila objektivisht i përballon më mirë ato. Gjithashtu, zakonisht në këto kontrata, çdo partner merr përgjegjësinë për rastet e rrezikut që janë nën sferën e ndikimit të tij. Ndarja e rreziqeve midis palëve dhe niveli përkatës i rrezikut të marrë përsipër nga partneri privat përcaktohen rast pas rasti, në varësi të formës së partneritetit publik privat dhe duke marrë në konsideratë rreziqet që lidhen me të gjitha aspektet kontraktore, të tilla si angazhimet kontraktore në lidhje me punimet, shërbimet, operimin, mirëmbajtjen, detyrimet financiare dhe rreziqet teknike.”⁸

Në kushtet kur ka udhëzime dhe përkufizime të ndryshme në lidhje me natyrën e PPP-ve është shumë e rëndësishme që të kuptohen në mënyrë të qartë elementet dhe kushtet e një marrëdhënie të Partneritetit Publik Privat, me qëllim jo vetëm kualifikimin në mënyrë të saktë, por edhe eliminimin e efekteve negative në buxhetin e shtetit dhe në cilësinë, efikasitetin e ofrimit të shërbimit/kryerjes së veprimtarisë objekt koncesioni/PPP-je.

Tri konceptet kryesore që duhet të mbahen parasysh, kur flasim për një kontratë PPP-je, janë pasqyruar më poshtë:

⁷ Shih Manualin i Auditimit të Projekteve të Partneritetit Privat Publik (PPP), Kontrolli i Lartë i Shtetit

⁸ http://atrako.gov.al/?page_id=973



Figura nr.2

Konceptet më të përdorura gjatë analizimit të një Procedure-Kontrate PPP-je janë risku, financimi dhe monitorimi.

4.1 Risku

Risku është një nga elementet thelbësore që dallon një Kontratë PPP-je nga Kontratat e tjera publike. Në të gjitha përkufizimet që bëhen për marrëdhënien juridike të Partneritetit Publik Privat, specifikohet që në këtë marrëdhënie risku duhet të transferohet te Operatori Ekonomik, në të kundërt nuk mund të kualifikohet si PPP.

Rregulli që risku të jetë kriteri kryesor në shfrytëzimin e mundësisë së koncesionit përcaktohet posaçërisht edhe nga Komisioni Evropian, që në fillimet e praktikës së koncesioneve. Ai thekson se:

“Një tipar kyç i koncesioneve është e drejta e koncesionarit për të kryer ndërtimin ose ofruar shërbimin kundrejt një kompensimi për ndërtimin e kryer ose shërbimin e ofruar. Dallimi kryesor, krahasuar me prokurimin publik, qëndron në faktin se risku thelbësor në një rast të tillë duhet t'i mbetet koncesionarit i cili duhet gjithashtu që të garantojë edhe financimin të paktën për pjesën më të rëndësishme të projektit.”⁹

Duhet të saktësojmë që në çdo Kontratë, e cila është një veprim juridik i dyanshëm, të dyja palët kanë detyrime dhe të drejta reciproke, që në rastin konkret do të përkthehet në atë që fakti apo që risku transferohet te operaori ekonomik/koncesionari, nuk do të thotë se autoriteti kontraktor nuk ka asnjë detyrim, përkundrazi, ai duhet të respektojë detyrimet e përcaktuara në kontratë dhe

⁹ Manualin i Auditimit të Projekteve të Partneritetit Privat Publik (PPP), Kontrolli i Lartë i Shtetit, fq. 8.

kuadrin ligjor në fuqi. Theksojmë që autoriteti kontraktor ka përgjegjësinë përballë qytetarëve për cilësinë, efektshmërinë dhe standartin e dhënies së shërbimit apo ndërtimit të një objekti për interes publik.

Marrëdhënia midis autoritetit kontraktor, operatorit ekonomik/koncesionarit mund të shpjegohet si më poshtë:




Figura nr.3

Grafiku i mësipërm pasqyron se Operatori Ekonomik ka përgjegjësi kundrejt Autoritetit Kontraktues për zbatimin në mënyrë efektive të Kontratës së PPP-së, ndërsa kundrejt qytetarit përgjegjësinë e ka Autoriteti Kontraktues, i cili duhet të marrë të gjitha masat për mbikëqyrjen dhe monitorimin e Kontratës. Çdo Autoritet Kontraktues ka detyrimin që të bëjë një analizë të detajuar të riskut dhe llojeve të tij për dhënien e një shërbimi apo veprimtarie në procedurë të Partneritetit Publik Privat.

Gjithashtu duhet të përcaktohet se cilat risqe do të transferohen nga Autoriteti Kontraktues te Operatori Ekonomik. Duhet të realizohet një analizë cilësore dhe sasiore e riskut në mënyrë që të identifikohet dhe të vlerësohet gama e riskut që mund të ndikojë mbi projektin. Ky informacion përdoret për zhvillimin e strategjive për menaxhimin e riskut dhe do të jetë një bazë e mirë për shpërndarjen e risqeve midis partnerëve publikë dhe private.

Gjatë hartimit të studimit të fizibilitetit duhet të merren në analizë kategoritë e risqeve, konkretisht¹⁰:

¹⁰ VKM nr. 575, datë 10.7.2013. “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat,” i ndryshuar.

- a. **risqet e trojeve:** lidhen me disponueshmërinë dhe cilësinë e vendndodhjes së projektit, të tilla si: kostoja dhe koha e marrjes së truallit, lejet e nevojshme ose sigurimi i së drejtës së kalimit për një rrugë, efekti i kushteve gjeologjike ose i kushteve të tjera të truallit, dhe kosto e plotësimit të standardeve mjedisore;
- b. **risqet e projektimit, ndërtimit dhe të vënies në punë:** lidhen me situatat ku ndërtimi zgjat më shumë ose kushton më shumë sesa pritej, ose që cilësia e projektimit apo e ndërtimit nënkupton se aseti nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e projektit;
- c. **risqet e funksionimit:** lidhen me suksesin e operacioneve, duke përfshirë riskun e ndërprerjes së shërbimit ose të disponueshmërisë së aseteve, riskun që ndonjë ndërveprim rrjeti nuk punon siç pritej, ose që kostoja e operimit dhe mirëmbajtjes së objektit është e ndryshme nga sa pritej;
- d. **risqet e kërkesës dhe risqe të tjera tregtare:** lidhen me situatat ku përdorimi i objektit është i ndryshëm nga sa pritej, ose që të ardhurat nuk janë mbledhur siç pritej;
- e. **risqet ekonomike ose financiare:** lidhen me ndryshimet në normat e interesit, kurset e këmbimit ose inflacionit që ndikojnë negativisht në rezultatet e projektit;
- f. **risqet e pronësisë së aseteve:** risqet që lidhen me pronësinë e aseteve, duke përfshirë riskun që teknologjia vjetërohet, ose që vlera e aseteve në fund të kontratës është e ndryshme nga sa pritej;
- g. **risqet politike:** lidhen me vendimet politike, që mund të ndikojnë negativisht mbi projektin;
- h. **risqet e ndryshimit të kuadrit ligjor:** risku që një ndryshim në ligjin ose në rregullat e përgjithshme ndikon negativisht mbi projektin, të tilla si: ndryshimet në tatimet e përgjithshme të korporatave ose në rregullat që rregullojnë këmbimin e monedhës, ose riatdhesimin e fitimeve;
- i. **risqet e forcës madhore:** risqet që lidhen me ngjarjet përtej kontrollit të palëve në kontratë, të tilla si: fatkeqësitë natyrore, luftëra ose trazira civile, që ndikojnë mbi projektin.

Krahas risqeve të sipërpërmendura, mund të konstatohen dhe risqe të tjera në varësi të llojit të shërbimit/veprimtarisë apo fushës së dhënies së Koncesionit/PPP-së.

Risqet e mësipërme mund të transferohen të gjitha te operatori ekonomik ose mund të ndahen midis operatorit ekonomik dhe autoritetit kontrator. Si rregull i përgjithshëm, alokimi i riskut merr në konsideratë parimin se pala, e cila do të mbajë riskun, është ajo, e cila është në pozitë më të mirë për të përballuar riskun dhe/ose për të minimizuar pasojat e tij.

Mund të përdoren tri llojet e shpërndarjeve (alokimeve) të riskut si më poshtë: (Neni 7, VKM nr.575/2013):

- a) risku i mbajtur - risqet që do të mbahen nga autoriteti kontraktues;
- b) risku i transferueshëm - risqet që do të transferohen te partneri privat;
- c) risku i përbashkët - risqet që do të mbajnë të dyja palët, siç është rënë dakord në kontratë.

Alokimi i riskut do të përdoret, gjithashtu, si një mjet themelor për të cilësuar nëse koncesioni/PPP është klasifikuar si “brenda” ose “jashtë” bilancit të qeverisë sipas mënyrës së kombinimit të alokimeve të tri llojeve të mëposhtme të risqeve:

- a) risku i ndërtimit;

- b) risku i disponueshmërisë;
- c) risku i kërkesës.

Referuar të dhënave të publikuara në raportin vjetor të vitit 2023 prej Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë konstatohet që risqet ndahen midis dy palëve kontraktore, autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik.

Referuar raportit për monitorimin e kontratave të koncesioneve/PPP-ve evidentohen 12 lloje risqesh, të cilat ndahen midis autoriteti kontraktor dhe operatorit ekonomik.¹¹

Shembull

Në Kontratën e Koncesionit/PPP-së të lidhur për përmirësimin e Autostradës “Milot-Morinë”, shfrytëzimi dhe mirëmbajtja efikase e saj nga ana e shoqërisë koncesionare përbëhet nga 12 risqe të identifikuara:

1. Autoriteti Kontraktues ka mbajtur 3 risqe:
 - a. riskun politik;
 - b. riskun e qeverisjes;
 - c. riskun e ndryshimeve ligjore
2. Partnerit Privat i janë transferuar 4 risqe:
 - a. risku i ndërtimit;
 - b. risku i transferimit të aseteve;
 - c. risku i operimit dhe performances;
 - d. risku i ribalancimit të ekuilibrit financiar.
3. Ndërkohë që 5 risqe janë ndarë midis dy palëve kontraktore, konkretisht:
 - a. risku i kërkesës;
 - b. risku financiar;
 - c. risku i forcës madhore;
 - d. risku i rinegocimit;
 - e. risku i ndërprerjes së kontratës;

Nga verifikimi i kuadrit ligjor, dokumenteve model të tenderit, si dhe disa kontratave Koncesionare/PPP të studiuar, raporteve të institucioneve publike rezulton që nuk ka një përcaktim konkret mbi konceptin e riskut dhe mekanizmin sesi ai transferohet te operatori ekonomik.

¹¹ <https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2024/06/RVP-2023-.pdf>, fq.13 dhe 14.

Konstatohet që koncepti i riskut është transferuar te kontratat Koncesionare/PPP-të në fushën e energjisë elektrike, por ende ka kontrata që nuk e parashikojnë duke ndikuar në rritjen e riskut në buxhetin e shtetit.¹²


Në disa praktika Koncesionare/PPP-ve risku analizohet në studimin e fizibilitetit, por është sipërfaqësor dhe nuk shqyrton në mënyrë të detajuar të gjitha elementet, llojet e risqeve dhe mënyrën e alokimit të tyre.

4.2 Financimi

Ligji parashikon që financimi i ofrimit të një shërbimi apo ndërtimi i një objekti nëpërmjet një procedure të PPP-së, realizohet nëpërmjet:

- i) duke iu dhënë e drejta për të shfrytëzuar veprat publike dhe/ose shërbimin publik, kryesisht me qëllimin e vendosjes së tarifave ose pagesave nga përdoruesit fundorë dhe konsumatorët ose kjo e drejtë së bashku me mbështetjen financiare;
- ii) me pagesat e rregullta të drejtpërdrejta të paguara nga ose në emër të partnerit publik, zakonisht në lidhje me disponueshmërinë e objektit dhe/ose shërbimit të ofruar;
- iii) me forma të tjera të mbështetjes financiare, duke përfshirë transferimin e të drejtave materiale dhe të drejtave të tjera reale;
- iv) një kombinim i mjeteve të përshkruara më lart;

Referuar të dhënave statistikore rezultojnë të jenë nënshkruar 230 Kontrata Koncesionare deri në vitin 2023, nga të cilat:



¹² Manuali i Auditimit të Projekteve të Partneritetit Privat Publik (PPP), Kontrolli i Lartë i Shtetit

Figura nr.4

Referuar të dhënave të grafikut të mësipërm, rezulton që 93 % të Kontratave, ose 215, nuk mbështeten financiarisht nga buxheti i shtetit, ndërsa 7 % ose 15 Kontrata mbështeten nga buxheti i shtetit.¹³

Pjesëmarrja private në financimin e një projekti nuk është një kusht i domosdoshëm që një projekt të konsiderohet si PPP. Sigurimi i financimit privat mund të jetë një pikësynim ose motivim më vete për një autoritet publik për të prokuruar infrastrukturën. Për më tepër, financimi privat (zakonisht në kuadër të strukturës "financim projekti") mund të jetë gjithashtu një faktor qenësor për efikasitetin, sepse kur partneri privat financon të gjithë ose një pjesë madhore të infrastrukturës dhe shpërblimi i tij bazohet në performancën (disponueshmëria dhe/ose shfrytëzimi) i një infrastrukture të tillë, atëherë financimi është në rrezik.¹⁴

Ky është një mekanizëm i fuqishëm për të harmonizuar objektivat e partnerëve publikë dhe privatë; stimulon partnerin privat të jetë proaktiv në maksimizimin e objektivit të palës publike (i cili është të sigurojë që infrastruktura të jetë në dispozicion dhe të funksionojë dhe/ose të mirëmbahet në mënyrë të mjaftueshme).

Financimi privat gjithashtu stimulon partnerin privat të menaxhojë kostot gjithëjetësore (gjatë ciklit jetësor të pasurisë). Kjo do të thotë që, pas mbulimit të kostove operative, partneri privat ka të ardhura të mjaftueshme për të paguar borxhin e tij dhe për t'u siguruar kthimin e investimit te investitorët e tij.¹⁵

Nga monitorimi i kontratave të PPP-së dhe dokumenteve shoqëruese, është konstatuar që ka dhe raste kur financimi i projektit është marrë përsipër nga koncesionari. Për të përmbledhur tri (3) konceptet kryesore të një kontrate PPP-je, po pasqyrojmë më poshtë një rast konkret të shkëputur nga një studim fizibiliteti, për të cilën është lidhur kontrata e Koncesionit/PPP-së.

Shembull:¹⁶

1. **Realizimi i investimeve nga koncesionari** e lejon qeverinë që të mos prekë buxhetin e shtetit, duke e lejuar atë që të përdorë burimet në fusha strategjike, ku ndoshta aplikimi i koncesioneve do të ishte më i vështirë (arsimi, infrastruktura etj.)

¹³ <https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2024/06/RVP-2023-.pdf>

¹⁴ Shih Udhëzuesi i APMG për certifikimin e Partneritetit Publik-Privat, fq.20, aksesuar në linkun aksesuar <https://ppp-certification.com/sites/www.ppp-certification.com/files/documents/Kapitulli%201%20-%20Partneriteti%20Publik-Privat%20-%20Hyrje%20dhe%20Pasqyr%C3%AB.pdf>

¹⁵ Shih Udhëzuesi i APMG për certifikimin e Partneritetit Publik-Privat, fq.20, aksesuar në linkun aksesuar <https://ppp-certification.com/sites/ëëë.ppp-certification.com/files/documents/Kapitulli%201%20-%20Partneriteti%20Publik-Privat%20-%20Hyrje%20dhe%20Pasqyr%C3%AB.pdf>

¹⁶ <https://ëëë.infrastruktura.gov.al/ep-content/uploads/2019/12/AL-STUDIM-FIZIBILITETI-VIA.pdf>

2. Koncesioni nuk **prek nivelin e borxhit të shtetit shqiptar**, një prioritet ky i politikave financiare dhe ekonomike.
3. **Koncesionari mbart risqet e biznesit**; ky është një tjetër element që favorizon koncesionin. **Qeveria nuk mbart risqe financiare.**
4. Koncesionari do të kalojë 2% të të ardhurave të Ministria, duke krijuar kështu një burim shtesë të ardhurash.
5. Projekti mund të fillojë menjëherë pas dhënies së koncesionit, duke evituar kështu procedurat standarde për realizimin dhe aprovimin e buxhetit, realizimin e tenderit (apo disa tenderave) që do krijonin vonesa.
6. Zbatimi i këtij projekti nga një koncesionar privat do të krijojë dhe mundësitë e arritjes së rezultateve që vijnë gjithmonë nga sektori privat, i cili synon maksimumin e fitimit.
7. Nëse projekti do të zbatohet sipas mënyrës klasike, pra të menaxhohej nga Ministria, atëherë kjo do të ishte një barrë shtesë mbi burimet e Ministrisë (si burime ekonomike dhe njerëzore) ndërkohë që në **rastin e koncesionit, i vetmi angazhim i shtetit, do jetë në monitorimin e koncesionarit sipas ligjit.**

Sa më sipër, është e rëndësishme që të bëhet një studim i thelluar i kostos financiare që mund të ketë një projekt, objekt prokurimi të Partneritetit Publik Privat. Me qëllim maksimizimin e efektivitetit dhe cilësisë së kryerjes së shërbimit apo realizimit të objektit, duhet që risku të transferohet te koncesionari dhe financimi të orientohet drejt vetëfinancimit të projektit nga operatori ekonomik.

4.3 Monitorimi

Një nga proceset më të rëndësishme që garanton zbatimin e kontratës në përputhje me kushtet e përcaktuara është monitorimi i saj gjatë zbatimit hap pas hapi nga autoriteti kontraktor, duke ndikuar në marrjen e masave paraprake për të planifikuar, për të parashikuar çdo lloj risku në të ardhmen. Në modul nr. 4 do të analizohet në mënyrë të detajuar procesi i monitorimit të kontratave.

5. Cilat janë format e PPP-ve?

Marrëdhënia midis autoritetit publik dhe subjektit privat mund të formësohet në mënyra të ndryshme, në varësi të objektit të kontratës, llojit dhe natyrës së shërbimit apo punës publike, ndarjen e risqeve, mënyrën e realizimit të shpërblimit.

Ligji për PPP-të i kategorizon PPP-të në tri forma:

- a) si punë publike me koncesion;
- b) koncesion i shërbimeve publike;
- c) kontratë e punëve publike;

“Kontratë Koncesioni” është e nënshkruar ndërmjet autoritetit kontraktues, në njërën anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm apo subjektit, për qëllime të veçanta (SPV), i themeluar nga operatori ekonomik në fjalë, kontratë, e cila përmban përcaktimet që rregullojnë të drejtat dhe detyrimet në lidhje me koncesionin e dhënë.

“Kontratë e Partneritetit Publik Privat” ka kuptimin e një kontrate pune publike apo kontrate të shërbimit publik, që plotëson kushtet, të cilat e përcaktojnë atë si një Partneritet Publik Privat, sikurse është rregulluar në këtë ligj dhe që nënshkruhet ndërmjet autoritetit kontraktues në njërën anë dhe operatorit ekonomik të zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm.

Përveç kërkesave të përcaktuara në këtë nen, Partneriteti Publik Privat mund të përfshijë krijimin e një subjekti për qëllime të veçanta (SPV) me kapital të përzier, që zotërohet bashkërisht nga Partneri Publik dhe Privat. Nëse kontributet kapitale të partnerit publik janë të tilla që vlera ose ndikimi i tyre eliminojnë transferimin e nevojshëm të risqeve kryesore të natyrshme të projektit te partneri privat, siç rregullohet nga ky ligj, një kontratë apo ndërmarrje e tillë nuk konsiderohet si një Partneritet Publik Privat (PPP).

Referuar rasteve nga praktika dhe përkufizimeve ndërkombëtare, kontratat e PPP-ve mund të jenë të llojeve të ndryshme. Në tabelën më poshtë pasqyrohen disa nga llojet e kontratave të PPP-ve.¹⁷ Referuar kësaj ndarje, për ta konkretizuar përdorimin e këtyre kontratave në Shqipëri, do të japim shembuj konkretë të zbatimit të tyre.

Lloji i PPP-ve	Shpjegim	Zbatimi në Shqipëri
Ndërmarrjet e përbashkëta	Sektori privat dhe publik krijojnë një entitet në pronësi të përbashkët për të zbatuar një projekt që sjell përfitime për të dyja palët.	Në Shqipëri janë krijuar disa ndërmarrje shtetërore, ku një institucion publik në partneritet me një subjekt privat krijojnë një shoqëri të përbashkët. Kemi 3 lloje shoqërishë: 100 % kapitali zotërohet nga shteti- p.sh. Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike Grup (OSHEE)

¹⁷ Manual KLSH, fq.6 ; ISSAI 5240 Guideline on Best Practice for the Audit of Risk in Public/Private Partnership (PPP), page 3

		• Më shumë se 50 % zotërohet nga institucioni publik- p.sh. Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike • Subjekti privat zotëron me shumë se 50 % të kuotave- P.sh. A.R.M.O
Franshizat	Sektori privat lejohet të ofrojë për publikun shërbimet që normalisht do të ofroheshin nga shteti, në këmbim të një tarife që e paguajnë qytetarët.	Referuar këtij shpjegimi, mund të kualifikohet si kontratë franshizat kontrata e PPP-së e lidhur për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe pashaportave elektronike në Shqipëri
Koncesionet	Janë të ngjashme me franshizat, përveç se sektori privat zakonisht do të bëjë edhe financimin për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme, si një urë apo rrugë.	Në Shqipëri kontratat e koncesionare janë më të përdorurat, të cilat kanë për objekt ndërtimin e rrugëve, ndërtimin e hidrocentraleve, në fushën shëndetësore etj.
Projekte investimi të financuara privatisht	Një kompani private merr fondet për projektimin, ndërtimin /rinovimin dhe funksionimin/ mirëmbajtjen e një aseti publik si spitali. Pasi aktivi të bëhet funksional, një tarifë e rregullt paguhet nga sektori publik për një periudhë të caktuar (zakonisht 20-35 vjet).	
Privatizimi	Kompanitë publike u shiten investitorëve privatë.	Në Shqipëri, rrjeti i tregtisë me shumicë dhe pakicë u privatizua në fillim të viteve 1990. Rrjeti përfshinte dyqane, restorante, depo dhe objekte të vogla prodhuese.

Tabela nr. 2

Pavarësisht formave të ndryshme që mund të shfaqet një PPP, të gjitha kontratat e PPP-së dhe përzgjedhja e operatorit fitues duhet t'i nënshtrohen rregullave dhe parimeve të parashikuara në ligjin për Koncesionet dhe PPP-të, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij me qëllim zhvillimin e një procedure të drejtë, të paanshme duke pasur si bosht orientimi ofrimin e një shërbimi apo veprimtari të një cilësie dhe efikasiteti më të lartë për qytetarët.

6. Objekti i Prokurimit të Partneritetit Publik Privat

“Objekti i koncesionit” janë veprat publike dhe/ose shërbimet publike të siguruara në bazë të një marrëveshjeje koncesioni në çdonjërin nga sektorët e ligjshëm të renditur në këtë ligj. (neni i 3 ligjit për).

Fushat ku realizimi i punimeve apo ofrimi i shërbimeve mund të jepen me partneritet publik privat janë: (neni 4 i ligjit të PPP-së)

- a. Transport, ku përfshihen:
 - Sistemi i hekurudhave;
 - transportin hekurudhor;
 - portet;
 - aeroportet;
 - rrugët;
 - tunelet;
 - urat;
 - parkimin;
 - transportin publik;
- b. prodhim dhe shpërndarje e energjisë elektrike dhe energjisë për ngrohje;
- c. prodhim dhe shpërndarje e ujit, trajtim, mbledhje, shpërndarje dhe menaxhim i ujërave të zeza, ujitje, drenazhim, pastrim i kanaleve dhe digave; i mbeturinave, duke përfshirë mbledhjen, trajtimin, transferimin dhe depozitimin e menaxhim tyre;
- d. telekomunikacion, shkencë dhe arsim;
- e. turizëm, argëtim dhe hoteleri;
- f. kulturë dhe sport;
- g. shëndetësi;
- h. shërbime sociale;
- i. burgje dhe infrastrukturë gjyqësore;
- j. rehabilitim i tokës dhe pyjeve;
- k. parqe industriale, miniera dhe infrastrukturë të ngjashme për mbështetjen e biznesit;
- l. strehim;
- m. godina të administratës publike, teknologji e informacionit dhe infrastrukturë e bazës së të dhënave;
- n. shpërndarje e gazit natyror;

- o. rehabilitim dhe zhvillim urban dhe suburban.
- p. ndriçimi publik në territorin e njësive administrative vendore;
- q. bujqësi.

Sa më sipër, konstatohet që autoritetet publike mund të delegojnë kryerjen e një pune publike apo shërbimi të një subjekti privat gati në të gjithë sferat dhe fushat.

Por, kryerja e disa punëve publike apo dhënia e shërbimit publik nuk mund të delegohet nga autoriteti publik të subjekti privat dhe ekskluzivitetin për t'i ofruar, e ka autoriteti publik.

Partneriteti Publik Privat nuk zbatohet në rastet (neni 5 i ligjit):

- a. kur realizimi i tyre duhet të shoqërohet me masa të veçanta të sigurisë, në përputhje me ligjet,
- b. rregulloret ose dispozitat administrative në fuqi apo kur një gjë e tillë kërkohet nga mbrojtja e interesave thelbësorë të shtetit;
- c. për blerjen ose marrjen me qira, me çfarëdo mjetesh financiare, të pasurisë së paluajtshme ose të të drejtave të lidhura me to. Megjithatë, kontratat e shërbimeve financiare, të nënshkruara në të njëjtën kohë para ose pas kontratës së blerjes ose të qirasë, në çfarëdo forme, i nënshtrohen këtij ligji;
- d. për blerjen, zhvillimin, prodhimin ose bashkëprodhimin e materialeve të programit apo reklamave të destinuara për reklamim nga transmetuesit, për publikimin në media dhe kontratat për kohën e transmetimit;
- e. për koncesionet, të cilat u nënshtrohen rregullave të ndryshme dhe që jepen në përputhje me rregullat procedurale të veçanta të organizatave ndërkombëtare;
- f. për shërbimet e arbitrazhit dhe të pajtimit;
- g. për shërbimet financiare, në lidhje me nxjerrjen, shitjen, blerjen apo transferimin e titujve ose instrumenteve të tjera financiare, në mënyrë të veçantë, transaksionet nga autoritetet kontraktuese për të mbledhur para ose kapital;
- h. për të gjitha shërbimet e përmendura në procedurat për dhënien e kontratave sektoriale në ligjin e prokurimit publik;
- i. për shërbimet e transportit ajror;
- j. për Koncesione/Partneritete Publike Private, që u nënshtrohen rregullave të ndryshme dhe të cilat janë dhënë në përputhje me marrëveshjet ndërkombëtare, që Republika e Shqipërisë i ka lidhur me një ose disa shtete të tjera, të nënshkruara në pajtim me Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Europian dhe që përfshijnë punë, mallra apo shërbime të destinuara për zbatimin e përbashkët ose përdorimin e projekteve nga ana e vendeve nënshkruese;
- k. për Koncesionin/Partneritetin Publik Privat, në atë masë që ky ligj bie ndesh me një detyrim të shtetit, që është në bazë ose që rrjedh prej një marrëveshjeje me një ose më shumë shtete të tjera a me një organizëm ndërkombëtar, mbizotërojnë dispozitat e kësaj

marrëveshjeje. Në të gjitha aspektet e tjera, procedurat dhe parimet e dhënies së Koncesionit/Partneritetit Publik privat rregullohen me këtë ligj;

- l. për koncesionet e shërbimit publik që një autoritet kontraktues ia ka dhënë një autoriteti tjetër kontraktues ose një shoqate të autoriteteve kontraktuese, në bazë të një të drejte ekskluzive që ata gëzojnë, sipas legjislacionit në fuqi;
- m. për ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve të energjisë së rinovueshme, sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2013 “Për burimet e rinovueshme të energjisë”, përveç hidrocentraleve, me kapacitet të instaluar mbi 2 MË.

Përfshirja e këtyre fushave nga dhënia me PPP është në përputhje dhe me Direktivat 2014 /23/BE “Mbi dhënien e kontratave të koncesionit” për shkak të rëndësisë dhe duke pasur në fokus mbrojtjen e interesit publik është në kompetencën ekskluzive të insitucioneve publike për ofrimin e shërbimeve apo kryerjen e ndërtimeve/veprimtarive të tjera.

Nga 224¹⁸ Kontrata lidhur nga viti 2004 deri në vitin 2023, objekti i Kontratave të Koncesionit/PPP-ve pasqyrohen si më poshtë: ¹⁹




Figura nr. 5

Nga grafiku i mësipërm konstatohet që fusha ku janë lidhur më shumë kontrata nga Koncesioni/Shëndetësisë është fusha e energjisë, e pasuar nga fusha e transportit. Nga të dhënat

¹⁸ Shënim nga 230 kontrata në total, për 6 prej tyre janë zgjidhur kontratat

¹⁹ Shih Raportin Vjetor për vitin 2023 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

rezulton që 82 % e Kontratave janë në fushën e energjisë. 4 % e Kontratave të klasifikuara në grupin “të tjera” janë në fushën e bujqësisë, kontrollit fiskal dhe në sektorin e zhvillimit ekonomik dhe urban.

7. Parimet mbi të cilat Zhvillohet Procedura për Dhënien e PPP-ve

Zhvillimi i procedurës për dhënien e Partneriteteve Publike Private ngrihet mbi disa parime, të cilat garantojnë zhvillimin e një procesi të rregullt dhe mbrojtjen e të drejtave të palëve në proces. Në ligjin për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat janë renditur disa parime, por nuk janë parashikuar se çfarë ato përfshijnë, si rrjedhojë për efekt të një analize të plotë do t'i referohemi Kodit të Procedurës Administrative për përkufizimin e tyre.

7.1 Trajtimi i barabartë dhe mosdiskriminimi (Neni 17, K.Pr.A)

Organi publik ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me parimin e barazisë. Palët, që janë në situata të njëjta objektive, trajtohen në të njëjtën mënyrë. Në raste të veçanta, kur bëhet një trajtim i diferencuar, ky trajtim duhet të justifikohet vetëm nga karakteristikat objektive që lidhen me rastin e veçantë.

Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civile, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.

Në procedurat e dhënies së PPP-ve çdo subjekt trajtohet në mënyrë të barabartë dhe duke shmangur çdo diskriminim dhe operatori ekonomik fitues përzgjidhet në një garë të drejtë, duke u bazuar në kriteret dhe kushtet e përcaktuara në ligj.

Gjykata Evropiane e Drejtësisë në një sërë vendimesh ka interpretuar parimin e barazisë dhe diskriminimit, duke u shprehur se²⁰:

Gjykata ka deklaruar se parimi i trajtimit të barabartë të ofertuesve synon të ofrojë mundësi të barabarta për të gjithë ofertuesit kur formulojnë ofertat e tyre, pavarësisht nga kombësia e tyre (shih dhe çështja C-87/94 Komisioni kundër Belgjikës [1996] ECR I-2043, paragrafët 33 dhe 54). Si rezultat, duhet të zbatohet parimi i trajtimit të barabartë të tenderuesve në koncesionet e shërbimeve publike, duke shmangur çdo lloj diskriminimi në bazë të kombësisë.

²⁰ Ruth Nielsen, Laë Department, Copenhagen Business School
<https://arbetsratt.juridicum.su.se/filer/pdf/kLaë46/discrimination.procurement.pdf>, fq.12

Sa më sipër, autoritetet publike duhet të respektojnë parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit nga momenti i përcaktimit të kriterëve deri në përzgjedhjen e operatorit ekonomik fitues. Mosrespektimi i këtij parimi përveçse përbën shkelje administrative, kualifikohet dhe si vepër penale.²¹

7.2 Parimi i proporcionalitetit (Neni 12 K.Pr.A)

Gjatë procedurave të dhënies së PPP-ve çdo veprim administrativ, i cili, për arsye të mbrojtjes së interesit publik ose të të drejtave të të tjerëve, mund të kufizojë një të drejtë individuale, ose mund të cenojë interesat legjitim, zhvillohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Veprimi administrativ është në përputhje me parimin e proporcionalitetit vetëm kur ky veprim është:

- a) i nevojshëm për të arritur qëllimin e përcaktuar me ligj dhe e arrin atë me mjetet dhe masat që çënojnë më pak të drejtat apo interesat legjitime të palës;
- b) i përshtatshëm për të arritur qëllimin e parashikuar në ligj;
- c) në përpjesëtim të drejtë me nevojën që e ka diktuar atë.

Parimi i proporcionalitetit imponon evidentimin e nevojës reale të ndërhyrjes në të drejtat individuale në një situatë konkrete. Përveç kësaj, përdorimi i këtyre mjeteve duhet të jetë i domosdoshëm, çka do të thotë se synimi nuk mund të arrihet me mjete të tjera. Domosdoshmëria lidhet edhe me përdorimin e mjeteve më pak të dëmshme për subjektet që u cenohen të drejtat dhe liritë. Po kështu, ndërhyrja për kufizimin e një të drejte ose lirie të bëhet me mjete të përshtatshme, që i përgjigjen drejt qëllimit që synohet të arrihet (shih vendimet).²²

7.3 Parimi i efikasitetit

Efikasiteti është një mjet me të cilin mund të arrihen rezultatet e synuara ose pritshmëritë në më pak humbje kohe, në më pak përpjekje dhe shpenzime.²³

²¹ Neni 258 i Kodit Penal “Shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”:

“Kryerja nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik i veprimeve në kundërshtim me ligjet që rregullojnë lirinë e pjesëmarrjes dhe barazinë e shtetasve në tendera dhe ankande publike, për të krijuar avantazhe ose privilegje të padrejta për të tretët, kur tenderi ose ankandi publik është deri në vlerën 800.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, kur kryhet në tender ose ankande publike me vlerë mbi 800.000 lekë ose ekuivalencën në monedhë të huaj, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.”

²² Shih vendimet nr. 70 datë 27.12.2023; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 1, datë 16.01.2017; nr. 30, datë 05.07.2021; nr. 20, datë 20.04.2021; nr. 16, datë 01.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese

²³ Komentari i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, SIGMA, aksesuar në https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëpcontent/uploads/2018/05/Komentari_i_kodit_te_procedurave_administrative_te_Republikes_se_shqiperise nga SIGMA edition April 2018.pdf (fq.730)

7.4 Parimi i reciprocitetit

Parimi i reciprocitetit nënkupton që kontrata ndërmjet organit publik kompetent, nga njëra anë dhe palës tjetër, është reciproke, që nënkupton se angazhimet e marra janë reciproke.²⁴

Palët në një kontratë administrative reciproke nuk kanë të njëjtën liri dhe autonomi në lidhje me përmbajtjen e kontratës krahasuar me lirinë dhe autonominë, që kanë lidhje me përmbajtjen e një kontrate private. Në qoftë se palëve të një kontrate administrative do t'iu jepej e njëjta liri që kanë palët e një kontrate private, atëherë ekziston rreziku i komercializimit të shërbimeve administrative. Duhet të respektohen disa kufizime në mënyrë që një kontratë administrative të mos kthehet në një çështje të pastër negocimi lidhur me çështjen e përfitimeve reciproke.²⁵

7.5 Parimi i sigurisë ligjore

Siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës.²⁶ Shteti i së drejtës, i cili garantohet që në Preambulën e Kushtetutës, është një nga parimet më themelore e më të rëndësishme në shtetin dhe shoqërinë demokratike. Si i tillë, ai përbën një normë të pavarur kushtetuese, prandaj shkelja e tij përbën në vetvete bazë të mjaftueshme për deklarimin e një ligji si antikushtetues.²⁷

Parimi i sigurisë juridike përfshin, krahas qartësisë, kuptueshmërisë dhe qëndrueshmërisë së sistemit normativ, edhe besimin te sistemi juridik, pa marrë për sipër garantimin e çdo pritshmërie për mosndryshim të një situate të favorshme ligjore. Besueshmëria ka të bëjë me bindjen e individit se nuk duhet të shqetësohet vazhdimisht ose të jetojë me frikë për ndryshueshmërinë dhe pasojat negative të akteve juridike, të cilat mund të cenojnë jetën e tij private ose profesionale dhe të përkeqësojnë një gjendje të vendosur me akte të mëparshme.²⁸

Duke qenë se një ndër elementet më thelbësore të parimit të shtetit të së drejtës është edhe ai i sigurisë juridike, del se rregullimet ligjore që kanë të bëjnë me të drejtat e shtetasve duhet të kenë qëndrueshmëri të mjaftueshme që siguron vijimësinë e tyre. Si rregull, nuk mund të mohohen pritshmëri të ligjshme të qytetarëve nga ndryshimet në legjislacion dhe shteti duhet të synojë të ndryshojë një situatë të rregulluar më parë vetëm nëse ndryshimi sjell pasoja pozitive, konkretisht trajtim më të mirë për subjektet përfituese. Sanksionimi i të drejtave dhe lirive të njeriut të pranuar

²⁴ Po aty fq. 622

²⁵ Komentari i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, SIGMA, aksesuar në https://eëë.drejtësia.gov.al/epcontent/uploads/2018/05/Komentari_i_kodit_te_procedurave_administrative_te_Republikes_se_Shqiperise nga SIGMA edition April 2018.pdf (fq. 622).

²⁶ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 20.12.2005; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.02.2007; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 12.02.2010; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 12.11.2008.

²⁷ Vendim i Gjykatës kushtetuese nr.34, datë.20.12.2005.

²⁸ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.34, datë 20.12.2005; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë 12.02.2010; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 12.11.2008; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 15.04.2015; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4 datë 23.02.2016.

në Kushtetutë dhe shoqërimi i tyre me masat për vënien në jetë të tyre duhet të synojë përmirësimin dhe rritjen e standardeve të të drejtave, forcimin e shtetit ligjor.

Nëse masat e marra sjellin përkeqësimin në mënyrë të paarsyeshme të gjendjes ligjore të personave të tjerë, mohojnë të drejtat e fituara ose injorojnë interesat legjitime të këtyre, atëherë do të dhunohet parimi kushtetues i barazisë së të drejtave dhe, në përgjithësi, do të rrezikohet arritja e qëllimit madhor të ndërtimit të shtetit të së drejtës²⁹. Për të zbatuar drejt këtë parim kërkohet, që ligji në një shoqëri të ofrojë siguri, qartësi dhe vazhdimësi, në mënyrë që individët t'i drejtojnë veprimet e tyre në mënyrë korrekte e në përputhje me të.³⁰

7.6 Parimi i parandalimit të konfliktit të interesave³¹

Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi të tij publike.

Në zbatim të nenit 21 pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”, kategoritë e zyrtarëve përcaktuar në Kreun III, Seksioni II, që iu ndalohe në mënyrë absolute të përfitojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nga lidhja e kontratave me një palë një institucion publik janë: Presidenti i Republikës, Kryeministri, ZvKryeministri, Ministrat ose Zv/ministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët e Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë e në atë të Apelit, Avokati i Popullit, Anëtari i Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, Anëtari i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Anëtarët e Enteve Rregullatore, (Këshilli i Mbikëqyrjes i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zv/Guvernatorin; të konkurrencës, telekomunikacionit; energjisë; furnizimit me ujë; të sigurimeve; letrave me vlerë; medieve, Sekretarët e Përgjithshëm të institucioneve qëndrore si dhe çdo zyrtar tjetër, në çdo institucion publik, që është të paktën i barazvlefshëm për nga pozicioni me drejtorët e përgjithshëm, titullarët e institucioneve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 3 dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pike, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit

²⁹Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.02.2007; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 43 datë 26.06.2015.

³⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 36, datë 15.10.2007; Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 5 datë 05.02.2015;

³¹ <https://eëë.app.gov.al/legjislacioni/koncesionetppp/dokumente-standarde/>

dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Në qoftë se një nga subjektet e mësipërme ndodhet në një situatë të konfliktit të interesit të sipërcituar nuk mund të marrë pjesë as si operatorr ekonomik dhe të konkurrojë në një procedurë PPP-je dhe në raste se është pjesë e sturkturës së institucionit ku punon, ai nuk mund të marrë vendime në rast se një person i lidhur me të konkurren në procedurën e prokurimit të PPP-ve.

MODULI 2

PROCEDURA E DHËNIES SË PPP-VE

1. Hyrje

Dhënia e të drejtës operatorit privat për të kryer një shërbim apo një veprimtari/ndërtim të një objekti, i cili do t'u shërbejë qytetarëve, i nënshtrohet një procedure ligjore e cila rregullohet nga ligji për koncesionet dhe PPP-të, si dhe nga aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Është shumë e rëndësishme të respektohen të gjitha hapat procedurale, afatet e parashikuara në ligj, deri në lidhjen e kontratës, pasi shkelja e procedurës e bën procedurën e dhënies së PPP-së dhe lidhjen e kontratës të paligjshme.

Krahas akteve ligjore dhe nënligjore, janë miratuar dhe një sërë dokumentesh standard, të cilat duhet të plotësohen si nga operatori ekonomik, që merr pjesë në një procedurë prokurimi të PPP-së, ashtu edhe nga institucionet publike. Theksojmë që, ndonëse në kontratën e PPP-së është palë vetëm autoriteti kontraktor që është kompetent për dhënien e një shërbimi/veprimtarie në Prokurim Publik/PPP, në realizimin e procedurës së PPP-së ndërveprojnë dhe një sërë institucioneve, të cilët në faza të ndryshme të procesit administrativ kanë role dhe kompetenca të ndryshme në zhvillimin e procedurës së prokurimit të PPP-së.

Në këtë modul do të analizohen në mënyrë të detajuar kompetencat dhe roli i secilit institucion në procedurën e dhënies së PPP-së, fazat procedurale në të cilën kalon një procedurë PPP-je deri në përzgjedhjen e fituesit dhe lidhjen e kontratës, dokumentet standard, që duhet të plotësohen në çdo procedurë prokurimi.

Në fund të modulit do të pasqyrohen disa nga indikatorët, të cilët do të shërbejnë si një udhëzues për të gjithë aktorët e shoqërisë civile, gazetarë, studentë apo ekspertë të tjerë të pavarur për të monitoruar zhvillimin e një procedure të dhënies së PPP-së në përputhje me kuadrin ligjor.

2. Identifikimi i projektit dhe inicimi i procedurës së PPP-së³²

Dhënia e një shërbimi apo kryerjes së një ndërtimi/veprimtarie nëpërmjet procedurës së PPP-së kushtëzohet ose nxitet nga situata konkrete, të cilat mund lidhen me:

- a) procesi i planifikimit kombëtar, rajonal/lokal apo në nivel sektori;
- b) analiza e gjendjes infrastrukturore, identifikimi i mungesave të shërbimeve dhe/ose nevojave të investimit;
- c) projektide të nxitura nga përparësitë e politikave.

Për shqyrtimin e situatës dhe mundësisë për dhënien e Koncesionit/PPP, autoriteti kontraktues ngre komisionin e Koncesionit/PPP-së, i cili ka për detyrë përgatitjen e një raporti përmbledhës paraprak, i cili përqendrohet veçanërisht në aspekte të domosdoshmërisë e të përshtatshmërisë së idesë së projektit dhe merr parasysh një gamë të gjerë të alternativave të realizimit.

Raporti paraprak duhet të përmbajë:

- a. përshkrimin e situatës aktuale, duke përfshirë të metat dhe mundësitë, një pasqyrë të tregut;
- b. parashikimet afatmesme dhe afatgjata të nevojave;
- c. përshkrimin e përgjithshëm të projektit;
- d. legjislacionin që rregullon objektin e fushës së investimit;
- e. në rastin e një projekti që përfshin kryerjen e një funksioni institucional, natyrën e funksionit institucional në fjalë dhe masën në të cilën ky funksion institucional, si ligjërisht ashtu edhe nga natyra e tij, mund të kryhet nga një palë private;
- f. në rastin e një projekti që përfshin përdorimin e pronës shtetërore, një përshkrim të pronës shtetërore në fjalë, përdorimet, nëse ka, subjekt i të cilave është aktualisht një pronë e tillë shtetërore, dhe një përshkrim të llojeve të përdorimit, në të cilat mund të përfshihet ligjërisht një subjekt privat;
- g. përfitimet strategjike dhe operationale që priten nga projekti;
- h. bashkërendimin me politikat e përgjithshme të investimeve sektoriale apo rajonale;
- i. skenarët teknikë dhe ekonomikë, me anë të të cilëve mund të arrihen objektivat e projektit;
- j. vlerësimet paraprake të kostos së projektit dhe të qëndrueshmërisë financiare;

³² VKM nr.575, datë 10.07.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar

- k. analizën paraprake financiare dhe/ose ekonomike bazuar në informacionet në dispozicion;
- l. alternativat e alokimit të risqeve kryesore të mundshme, ndërmjet palës publike dhe subjektit privat;
- m. konkluzionet e rekomandimet, duke përfshirë modelet e zbatueshme/të përshtatshme të Partneritetit Publik Privat;³³

Pas përgatitjes së raportit paraprak nga komisioni i Koncesionit/PPP-së, autoriteti kontraktues merr vendim:

- a) shtyrjen e zbatimit të projektit.
- b) Refuzimin e plotë të zbatimit të projektit. Në rastin e refuzimit, bazat për ndërprerjen mund të përbëhen nga provat thelbësore të mungesës së mundshme të fizibilitetit të projektit. Prova të tilla krijohen në bazë të krahasimeve paraprake të përfitimeve dhe kostove të përdoruesve, të informacionit për mungesën e fizibilitetit/përshtatshmërisë financiare apo të konkluzionit se objekti në përgjithësi nuk është i nevojshëm ose nuk është më pjesë e prioritetëve të institucionit;
- c) vazhdimin e procedurave me përgatitjen e studimit të fizibilitetit;

3. Roli dhe kompetenca e institucioneve kompetente në zhvillimin e procedurave të PPP-ve

Zhvillimi i një procedure të partneritetit publik privat kërkon ndërveprimin e disa institucioneve me qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe efektiv në përcaktimin e fushës, kufirit monetar, përzgjedhjen e operatorit ekonomik, monitorimin e zbatimit të kontratës deri në përfundimin e saj. Institucionet publike që janë pjesë e procesit të zhvillimit të procedurës së PPP-së në faza të ndryshme të këtij procesi janë të ndryshëm.

³³ Ndryshuar me VKM Nr. 420/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa” në Vendimin nr. 575, datë 10.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion / partneritet publik privat”

Faza paraprake	Gjatë zhvillimit të procedurës së PPP-së	Gjatë zbatimit të kontratës së PPP-së
• Autoriteti kontraktor • Njësia e trajtimit të Koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private	• Autoriteti kontraktor • Ministria e Financës • APP • Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/ PPP	• Autoriteti kontraktor • Ministria përgjegjëse e financës

Tabela nr.3

Më poshtë do të analizohen në mënyrë të detajuar roli dhe kompetenca e secilit institucion gjatë zhvillimit të procedurës së PPP-së.

3.1 Ministrinë

Ministria e Ekonomisë dhe Financës është institucioni përgjegjës për orientimin dhe harmonizimin e veprimtarive për zhvillimin e Koncesioneve /Partneriteteve Publike Private. (neni 9/1 i ligjit për PPP-të).

3.1.1 Kompetencat dhe detyrat e ministrisë përpara lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik fitues³⁴

Ministria përgjegjëse për financat vlerëson dhe miraton paraprakisht:

- të gjitha projektet e PPP-ve;
- çdo ndryshim apo transferim të tyre;

Vlerësimi dhe monitorimi i PPP-ve nga ministria e financave konsiston në:

- implikimet fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore;
- deficitin buxhetor;
- qëndrueshmërinë e borxhit publik;
- detyrimet kontingjente eventuale.

³⁴Neni 10 i ligjit për PPP-të

Autoritetet kontraktuese janë të detyruara që përpara nënshkrimit të kontratës së Koncesionit/ PPP me ofertuesin ekonomik të shpallur fitues ta paraqesin atë për vlerësim në ministrinë përgjegjëse për financat.

Në qoftë se autoriteti kontraktues nuk e ka shpallur operatorin fitues brenda dy-viteve nga marrja e miratimit nga ministria përgjegjëse për financat, do të dërgojë studimin e fizibilitetit të rishikuar edhe një herë për miratim.

3.1.2 Kompetencat dhe detyrat e ministrisë gjatë zbatimit të kontratës

Pas lidhjes së kontratës dhe fillimit të zbatimit të saj, Ministria e Financave luan një rol të rëndësishëm në ecurinë e zbatimit të kontratës dhe përmbushjes së detyrimeve nga ana e autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik.

Autoritetet kontraktuese kanë detyrimin që të raportojnë pranë ministrisë:

- Raporte të përmbledhura të monitorimit të zbatimit të kontratave të Koncesionit/ PPP me argumentet dhe shpjegimet përkatëse. Detyrimi për të raportuar është në çdo kohë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, raporte të përmbledhura të monitorimit të zbatimit të kontratave të Koncesionit/ PPP me argumentet dhe shpjegimet përkatëse.
- Pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe të konfirmuara nga autoritetet tatimore të vitit paraardhës të shoqërive koncesionare. Afati për të dorëzuar pasqyrat financiare është brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti.

Pas vlerësimit të raporteve, ministria ka të drejtë që t'u rekomandojë autoriteteve kontraktuese marrjen e masave për përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve dhe punëve publike, objekt i këtyre kontratave, si dhe për minimizimin apo eliminimin e risqeve të drejtpërdrejta e të tërthorta që ndikojnë në buxhetin e shtetit.

Ministri përgjegjës për financat përgatit një raport vjetor të përmbledhur mbi ecurinë e kontratave aktive të koncesionit/ PPP, si aneks i raportit vjetor të zbatimit të buxhetit.

3.2. Agjencia e Prokurimit Publik

Institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kriterëve dhe procedurave të dhënies së PPP-ve është Agjencia e Prokurimit Publik (APP).

Në ligjin për Konkensionet dhe Partneritetin Publik Privat parashikohet që APP ka për kompetencë monitorimin e respektimit të procedurave konkurruese të koncesioneve /partneriteteve publike private sipas legjislacionit për prokurimet publike, pas nënshkrimit të kontratës dhe, në rast të

shkeljeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij, vendos gjoba ose propozon marrjen e masave administrative.

Kjo dispozitë referon te ligji për prokurimet në lidhje me kriteret dhe zhvillimin e procedurave të hetimit për zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi dhe marrjen e masave kundrejtë subjekteve që kanë shkelur ligjin.

Në nenin 13/2/g të LPP, parashikohet që:

“Agjencia e Prokurimit Publik: Verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik, pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore, shqyrton rekomandimet e organeve audituese për procedurat e prokurimit, si dhe monitoron mbarrëvajtjen e sistemit të prokurimit publik, nëpërmjet informacioneve të marra nga raportet periodike të autoriteteve kontraktore.”

Në nenin 65 pika 1 e LPP parashikohet se:

“1. Agjencia e Prokurimit Publik verifikon zbatimin e procedurave të prokurimit publik pas fazës së nënshkrimit të kontratës së prokurimit, por, në çdo rast, jo më vonë se 2 vjet nga nënshkrimi i saj.”

Afati dyvjeçar pas nënshkrimit të kontratës zbatohet edhe në rastet kur shkelja është konstatuar nga një strukturë audit, pasi ligji për prokurimet, është një ligj i posaçëm, i cili prevalon ndaj çdo ligji tjetër “lex specialis derogat lex generalis” dhe në asnjë dispozitë tjetër nuk është parashikuar një afat i posaçëm për shkeljet e konstatuara nga strukturat e auditimit, si rrjedhojë do të zbatohet afati i parashikuar në nenin 65 të LPP.

3.3 Njësia e trajtimit të Koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private (neni 12 ligjit)

Njësia e trajtimit të koncesioneve/partneriteteve publike private është në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, dhe ka për kompetencë nxitjen dhe asistimin e autoriteteve kontraktuese në përgatitjen, vlerësimin dhe negocimin e Koncesioneve/Partneriteteve Publike Private. Njësia bashkëpunon me disa institucione me qëllim asistimin në zhvillimin e një procedure të drejtë të dhënies së PPP-ve në përputhje me ligjin dhe standardet ndërkombëtare.

3.3.1 Bashkëpunimi me autoritet kontraktore

Një nga kompetencat kryesore të Njesisë është asistimi i autoriteteve kontraktore në:

- a) përgatitjen e studimit të fizibilitetit;
- b) përgatitjen e dokumenteve të procedurës konkurruese dhe kriterëve të vlerësimit;
- c) vlerësimin e propozimeve dhe përcaktimin e ofertuesit më të mirë;

- ç) kryerjen e negociemeve dhe nënshkrimin e kontratës së koncesionit;
- d) monitorimin e kontratave të koncesionit.

3.3.2 Bashkëpunimi me APP

- a) bashkëpunon me APP-në për hartimin dhe publikimin e dokumenteve standarde të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat.

3.3.3 Bashkëpunimi me Komitetin e përzgjedhjes së projekteve të koncesionit/PPP

- i. I propozon për miratim Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP, kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar në hartimin e studimeve të fizibilitetit të projekteve të Koncesionit/PPP;
- ii. I propozon për miratim Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP, kërkesat e ministrisë përgjegjëse për financat për mbështetje me ekspertizë të specializuar për kryerjen e oponencës së studimeve të fizibilitetit të projekteve të Koncesionit/PPP;
- iii. I propozon për miratim Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/ PPP, kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar për kryerjen e oponencës së propozimeve të pakërkua;
- iv. Kryen procedurat e përzgjedhjes së konsulentëve të jashtëm, në përputhje me procedurat e prokurimit publik;

3.4 Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/ PPP (neni 12/1)

Në vitin 2019 krahas institucioneve të sipërpërmendura, u krijua Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP. Kompetenca kryesore e këtij institucioni është përzgjedhja e projekteve të Koncesionit/PPP, të cilat do të mbështeten me ekspertizë të specializuar në hartimin e studimit të fizibilitetit dhe /ose në kryerjen e oponencës së tyre.

Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP, organ administrativ kolegjal, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, në përbërje të tij ka këta anëtarë:

- a) ministrin përgjegjës për financat;
- b) ministrin përgjegjës për infrastrukturën;
- c) ministrin përgjegjës për energjinë dhe industrinë;
- d) ministrin përgjegjës për zhvillimin urban;
- e) ministrin përgjegjës për mjedisin.

Komiteti fton, rast pas rasti, pa të drejtë vote, përfaqësues nga bota akademike, si dhe titullarët e autoritetit kontraktues, të cilët kanë fushë të veprimtarisë objektin e projektit të Koncesionit/PPP, për të argumentuar kërkesën e tyre.

3.5. Autoritetet kontraktuese (Neni 13 i ligjit)

Zhvillimi i procedurës konkurruese dhe lidhja e Kontratës me Operatorin Ekonomik fitues bëhet nga autoritetet kontraktuese, të cilët janë dhe njëra palë e kontratës, duke mbartur të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga ligji dhe nga Kontrata e lidhur.

Autoritetet kontraktuese janë:

- a) ministritë e linjës;
- b) njësitet e qeverisjes vendore.

Kur objekt i kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat është fushë e veprimtarisë së më shumë se një autoriteti kontraktor; Këshilli i Ministrave me vendim përcakton autoritetin kontraktor/autoritetet kontraktore, sipas rastit.

4. Fazat procedurale të Dhënies dhe Përzgjedhjes së një PPP-je

Korniza ligjore që rregullon PPP-në si një metodë për prokurimin dhe menaxhimin e infrastrukturës ka disa elemente që përcaktojnë kufijtë ose rregullat e tyre prandaj duhet:³⁵

- Të jetë i bazuar në zgjidhje teknike, “projekt” të përshtatshëm ose optimal: ky zakonisht quhet identifikim;
- Të bëhet vlerësimi i duhur financiar për të parë nëse janë të realizueshme (si zgjidhja teknike, ashtu edhe realizimi i projektit si PPP), se PPP është zgjidhja më e mirë e prokurimit dhe se duhet të përgatitet siç duhet para tenderimit: kjo ka të bëjë me vlerësimin dhe përgatitjen;
- Të përgatitet një kontratë e mirë-strukturuar e PPP-së dhe një proces i mirëprojektuar tenderimi: në këtë Udhëzues për PPP, këto quhen si strukturim dhe hartim i kontratës dhe tenderit;
- Të prokurohen ose tenderohen në mënyrë efektive, në përputhje me kërkesat ligjore dhe normative në fuqi: kjo mund të quhet si vetë proces i tenderimit (ndonjëherë i quajtur "menaxhimi i transaksionit");
- Të menaxhohet gjatë kohëzgjatjes së kontratës: kjo quhet menaxhim i kontratës.

Skema e zhvillimit të procedurës së një PPP-je³⁶:

³⁵ Udhëzues:<https://ppp-certification.com/sites/ëëë.ppp-certification.com/files/documents/Kapitulli%201%20-%20Partneriteti%20Publik-Privat%20-%20Hyrje%20dhe%20Pasqyr%C3%AB.pdf> , fq.139,150

³⁶ Udhëzues:<https://ppp-certification.com/sites/ëëë.ppp-certification.com/files/documents/Kapitulli%201%20-%20Partneriteti%20Publik-Privat%20-%20Hyrje%20dhe%20Pasqyr%C3%AB.pdf> ,




Tabela nr. 4

Kjo strukturë është parashikuar dhe në ligjin për Koncesionet dhe PPP-të, ku procedura e prokurimit fillon nga studimi i fizibilitetit dhe mbaron me përfundimin e kontratës së PPP-së.

4.1 Procedura paraprake

Në rastet kur autoriteti kontraktues merr vendim për vijimin e realizimit të projektit, bazuar në raportin paraprak të hartuar nga komisioni i Koncesioneve/PPP-ve vijon me hartimin e studimit të fizibilitetit.

Autoriteti kontraktues harton studimin e fizibilitetit përpara se të ndërmarrë angazhim për realizimin e projektit. Studimi i fizibilitetit siguron shqyrtimin dhe vlerësimin e aspekteve teknike, ekonomike dhe tregtare të një projekti të propozuar, të cilat do të jenë baza për vendimin e investimit.³⁷

Në studimin e fizibilitetit, në të cilin detajohet informacioni i përfshirë në raportin përmbledhës, përcaktohen veçoritë kryesore të projektit, bazuar në analizën teknike, ekonomike e financiare, analizën e ndikimit mjedisor e social, si dhe në analizimin e faktit nëse projekti i hartuar si një Koncesion/PPP është ekonomikisht më i favorshëm, krahasuar me alternativën e prokurimit tradicional.

Në rastet e Koncesioneve/PPP për HEC-et, studimi i fizibilitetit hartohet nga komisioni i Koncesionit/PPP, pas marrjes së opionencës teknike shtetërore nga strukturat përgjegjëse të ngarkuara për të bërë këtë opionencë.

Procedura e zhvillimit të një PPP-je nis me krijimin e komisionit të dhënies së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, i cili brenda 60 ditëve pune nga krijimi duhet të hartojë studimin e fizibilitetit për PPP-në. (neni 19 i ligjit për Koncesionet dhe PPP-të). Ky afat mund të shtyhet për shkaqe të kompleksitetit të projektit me jo më shumë se 30 ditë pune.

³⁷ VKM nr.575, datë 10.07.2013 (neni4)

4.1.1 Elementet që duhet të përmbajë studimi i fizibilitetit

Studimi i fizibilitetit përmban, në mënyrë të veçantë:

- Përmbledhjen operacionale dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit;
- Analizat:
 1. Teknike;
 2. Financiare;
 3. Ekonomike;
 4. Ligjore;
- Studimet mjedisore dhe implikimet në natyrë;
- Anekset shoqëruese, shtesat e kërkuara, konkluzionet dhe rekomandimet.

1. *Analiza teknike*³⁸ është pjesë e studimit të fizibilitetit dhe ka si objekt kryesor të demonstrojë se projekti mund të zbatohet duke përdorur teknologjitë e propozuara dhe pa risqe të paarsyeshme teknike. Analiza teknike duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a) sfondin e projektit.

- *iniciatorin e projektit;*
- *historinë e shkurtër të projektit;*
- *studimet e kryera tashmë, të tilla, si: studimet e parainvestimeve, studimet mbështetëse, hulumtimet, rilevimet e trojeve;*
- *konceptin e projektit dhe objektivat kryesore;*
- *përfituesit e projektit;*

b) vendndodhjen dhe truallin:

- *vendndodhjen dhe, në qoftë se është rasti, listën e alternativave të mundshme të trojeve;*
- *sipërfaqen totale që do të zihet në mënyrë të përhershme dhe/ose të përkohshme;*
- *statusin ligjor të tokës që do të zihet;*
- *pasuritë e tjera publike, të cilat do të përdoren, nëse ka ndonjë të tillë;*

c) kushtet lokale:

- *klima dhe fenomenet natyrore specifike për zonën;*
- *topografinë (duhen bashkëlidhur studimet topografike);*
- *gjeologjinë dhe sezmicitetin (duhen bashkëlidhur studimet/raportet gjeoteknike me rekomandime për themelet);*
- *gjendja aktuale e rrjetit dhe e lidhjes së shërbimeve;*
- *disponueshmëria e rrugëve hyrëse, nëse ka ndonjë të tillë;*

ç) përshkrimin konstruktiv, funksional dhe teknik të projektit. Ky seksion siguron kryesisht rezultatet që pritet të arrihen dhe nuk përshkruan në mënyrë të detajuar se si do të arrihen.

- *përshkrimin e punëve kryesore civile që do të realizohen, duke përfshirë pjesët*

³⁸ Po aty neni 5

përkatëse të skicuara në lidhje me:

- planin e vendndodhjes së zonës;
- planin e përgjithshëm;
- planet e përgjithshme dhe seksionet e arkitekturës, rezistencës, instalimeve;
- planet e veçanta, profilet gjatësore, profilet tërthore, sipas kërkesës.
- *metodat e ndërtimit;*
- *teknologjinë dhe pajisjet, të cilat mendohen të përdoren;*
- *parametrat kryesorë të projektit si: kapacitetet, sipërfaqet, volumet, gjatësitë, dhe tregues të tjerë të veçantë;*
- *listën e standardeve teknike përkatëse që do të vëzhgohen;*

d) periudha e vlerësuar e ndërtimit (në muaj).

i. Analiza financiare

“Kufi monetar” është vlera monetare, sipas së cilës, në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e prokurimit publik, përcaktohen rregullat procedurale, kryesisht në përcaktimin e afateve kohore në procedurat e prokurimit që do të përdoren nga autoriteti ose enti kontraktor. (neni 4/23 i LPP)

Autoriteti kontraktues llogarit vlerën e parashikuar të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat si vlerë totale e objektit të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, duke përfshirë të gjitha ndryshimet e mundshme dhe optionet e kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, pa vlerën e TVSH-së.

Analiza ekonomike dhe financiare është pjesë e studimit të fizibilitetit dhe objektivi i saj kryesor është të përcaktojë “vlerën e parasë” së projektit dhe përfshin:

a. Kosto të drejtpërdrejta:

- *Të investimeve* - të cilat lidhen në mënyrë specifike me ndërtimin e objekteve të reja dhe mund të përmbajnë, por nuk kufizohen në shpenzimet fillestare për përgatitjen e projektit, duke përfshirë shërbimet financiare, ligjore, të prokurimit, teknike dhe të menaxhimit të projektit, kostot e projektimit, kostot e tokës apo të blerjes së një aseti të ri, kostot e përgatitjes së truallit, kostot e ndërtimeve dhe të vënies në funksionim, duke përfshirë edhe lëndët e para, pajisjet, instalimet, fuqinë punëtore, menaxhimin dhe trajnimin, dhe rrethana të tjera.
- *Të mirëmbajtjes* - përfshijnë kostot e mbajtjes së aseteve gjatë ciklit të plotë të projektit në gjendjen e kërkuar për të dhënë rezultatet e specifikuara, dhe mund të përfshijnë kostot e lëndëve të para, mjetet dhe pajisjet, si dhe kostot e personelit të shoqëruara me mirëmbajtjen.
- *Operative*- lidhen me funksionimin e përditshëm të objektit dhe përfshijnë koston e plotë të personelit (ku futen pagat, përfitimet e punonjësve, detyrimet për kontributet e pensioneve, kontributet e sigurimeve, trajnimin dhe zhvillimin, pushimet vjetore, shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzime të pritshme shtesë), kostot e shërbimeve, lëndët e para dhe materialet e konsumit, kostot e drejtpërdrejta të menaxhimit, si dhe shpenzimet e sigurimit.

b. **Kostot indirekte të projektit** - janë një pjesë e koston së administrimit të objektit, dhe përfshijnë:

- Kostot e kohës;

- Kosto të punës së drejtuesve të lartë, personelit, kontabilitetit, faturimit, shërbimeve ligjore, qirasë, komunikimet;
- Burime të tjera institucionale të shfrytëzuara nga projekti.

Gjithashtu studimi i fizibilitetit të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat apo analiza e përmbledhur e dhënies me koncesion përmban:

- përcaktimin e llojit dhe objektin e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat;
- vlerësimin e risqeve të drejtpërdrejta financiare dhe ndikimin në buxhetin e qeverisë qendrore dhe vendore;
- vlerën e parashikuar të kontratës;
- vlerësimet në lidhje me kriteret e zgjedhjes dhe të dhënies së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat;
- kohëzgjatjen e propozuar të kontratës, si edhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit.

Gjatë hartimit të studimit të fizibilitetit duhet të merren parasysh:

- interesi publik;
- ndikimi në mjedis dhe mbrojtja e mjedisit - studimi identifikon efektet e mundshme negative apo të kundërta në përbërësit mjedisorë por që nuk kufizohen vetëm te: popullsia, ajri, toka, uji, peizazhi, fauna, flora, aspekte të biodiversitetit, duke përfshirë speciet e rrezikuara, ekosistemet e ndjeshme dhe identifikimin e atyre që mbrohen ligjërisht.
- qëndrueshmëria, përshtatshmëria financiare e projektit;
- treguesit e vlerës së parasë;
- harmonizimi i projektit me objektivat kombëtare dhe sektoriale strategjike;
- risqet direkte dhe indirekte financiare dhe ndikimet në buxhetin qendror dhe në atë të qeverisjes vendore;
- mbështetja e nevojshme financiare;
- realizueshmëria teknike dhe tregtare;
- interesi i tregut dhe aftësia për të tërhequr operatorët e interesuar ekonomikë dhe mbështetësit financiarë.

Përpara shpalljes së procedurës së dhënies me koncesion/ PPP, autoritetet kontraktuese dërgojnë studimin e fizibilitetit, si dhe çdo ndryshim të mëtejshëm të tij, në ministrinë përgjegjëse për financat. Ministria përgjegjëse për financat e vlerëson dhe miraton studimin.

4.1.2 Propozimet e pakërkuara

Autoriteti kontraktues autorizohet të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror, me kusht

që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt, për të cilin procedurat e përzgjedhjes kanë nisur apo janë shpallur.

Në qoftë se propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm, pas vlerësimit paraprak, autoriteti kontraktues mund të ndërmarrë veprimet për dhënien e Koncesionit/PPP. Nuk do të pranohen propozimet e pakërkua, të shoqëruara me studim në formë minimale.

Kur procedura e dhënies së Koncesionit/PPP e nisur mbi një propozim të pakërkuar finalizohet me nënshkrimin e kontratës, autoriteti kontraktues kompenson shpenzimet e bëra nga propozuesi për përgatitjen e studimit të fizibilitetit, vetëm nëse propozuesi i pakërkuar nuk është ofertuesi fitues.

Shuma e kompensimit për propozimin e pakërkuar nuk mund të jetë më e lartë se 1 % e vlerës së investimit. Vlera e përcaktuar e kompensimit do të publikohet në dokumentet e procedurës konkurruese dhe do të paguhet nga ofertuesi i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës.

Nga të dhënat statistikore rezulton se rreth 13 % e kontratave të miratuara në total janë propozime të kërkuara nga autoritetet kontraktues, në kuadër të një procedure përzgjedhëse konkurruese. Ndërsa pjesa tjetër e kontratave të miratuara janë propozime të pakërkua që u janë ofruar autoriteteve kontraktuese me qëllim ofrimin e një shërbimi/investimi në fusha të ndryshme.³⁹

4.2 Zhvillimi i procedurës së dhënies së PPP-së

Procedura për dhënien e Koncesioneve/Partneriteteve Publike Private fillon me publikimin e njoftimit të kontratës dhe përfundon me publikimin e njoftimit të fituesit për dhënien e kontratës ose me vendimin për ndërprerjen e procedurës së dhënies së kontratës. (neni 24 i ligjit)

4.2.1 Shpallja e njoftimit për zhvillimin e procedurës së dhënies së PPP-së

Në njoftimin e kontratës së Koncesionit duhet të përfshihen të paktën të dhënat e mëposhtme:

- a. emri, adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike të autoritetit kontraktues;
- b. lloji, subjekti dhe objekti i koncesionit;
- c. vendndodhja e veprimtarisë koncesionare që do të ndërmerret;
- d. kohëzgjatja e kontratës së koncesionit;
- e. vlera e parashikuar e kontratës koncesionare;
- f. afati i fundit për dorëzimin e ofertave;
- g. adresa në të cilën duhet të dërgohen ofertat;
- h. gjuha/gjuhët dhe shkrimi/shkrimet, në të cilën/cilat duhet të hartohen ofertat;
- i. koha dhe vendi i hapjes publike të ofertave;
- j. kriteret për përjashtimin e ofertuesve;

³⁹ <https://financa.gov.al/ep-content/uploads/2024/06/RVP-2023-.pdf>

- k. kriteret në lidhje me gjendjen ligjore dhe përshtatshmërinë për të ndjekur aktivitetin profesional, aftësinë;
- l. teknike dhe profesionale, si dhe dëshmitë e të dhënat, me anë të të cilave një operator ekonomik vërteton plotësimin e kërkesave të tilla;
 - i. lloji dhe vlera e garancisë së tenderit që ofertuesit duhet të paraqesin;
 - ii. kriteret për dhënien e kontratës;
 - iii. emri dhe adresa e organit përgjegjës për procedurën e shqyrtimit, si dhe të dhënat për afatet për shqyrtimin e kërkesës.

Palët e interesuara për procedurën konkurruese kanë të drejtë të kërkojnë ndryshimin ose korrigjimin e dokumenteve standarde të procedurës konkurruese. Kjo kërkesë duhet depozituar brenda 10 ditëve, nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të kontratës. Në rast se dokumentet e procedurës konkurruese ndryshohen ose korrigjohen, afati i fundit për dorëzimin e ofertave mund të shtyhet, në përputhje me rrethanat, por jo më shumë se 10 ditë.

Njoftimi i kontratës botohet në një formular standard dhe publikohet në formë elektronike në platformën elektronike të prokurimit dhe në Buletinin e Prokurimit Publik.

Ky njoftim duhet të plotësohet nga çdo institucion i njësisë qendrore (Ministritë) apo njësisë vendore të cilët shpallin një procedure të prokurimit publik. Njoftimi është i ndarë në pesë (5) seksione të cilat përmbajnë të dhëna:

- Të dhënat e autoritetit kontraktor;
- Objekti i kontratës:
 - *Lloji i Kontratës;*
 - *Përshkrim i shkurtër i kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat;*
 - *Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin;*
 - *Vendodhjen e kontratës.*
- Procedura e PPP-së:
 - *Lloji i procedurës së PPP-së*
 - *Kriteret e përzgjedhjes së fituesit;*
 - *Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje;*
 - *Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje;*
 - *Periudha e vlefshmërisë së ofertave: (e shprehur në ditë);*
 - *Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje.*
- Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik
- Informacione plotësuese

Më poshtë po pasqyrojmë formatin standard të njoftimit të kontratës së PPP-së për ofrimin e shërbimeve:⁴⁰

--

⁴⁰ <https://ëëë.app.gov.al/GetData/DoenloadDoc?documentId=72cb6b87-3bfe-41c1-83d9-357f4590b5b0>

NJOFTIMI I KONTRATËS

Seksioni 1

Autoriteti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri _____
Adresa _____
Tel/Fax _____
E-mail _____
Faqja e Internetit _____

1.2 Lloji i autoritetit kontraktor dhe aktiviteti ose aktivitetet kryesore:

Institucion qendror Institucion i pavarur ☐ Njësi e Qeverisjes Vendore ☐

Seksioni 2

Objekti i Kontratës

2.1 Lloji i Kontratës

☐ Shërbime

2.2 Përshkrim i shkurtër i kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat

1. Objekti i kontratës _____
2. Forma e kontratës _____
3. Burimi i financimit _____

2.3 Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:

Kohëzgjatja në muaj ☐☐☐ ose ditë ☐☐☐☐ ose duke filluar nga ☐☐☐☐☐☐ me përfundim në ☐☐☐☐☐☐

2.4 Vendndodhja e objektit të kontratës:

Seksioni 3

Informacioni ligjor, ekonomik, financiar dhe teknik

3.1 Kriteret e Pranimi sipas Shtojcës nr. 9

3.2 Sigurimi i Ofertës (i zbatueshëm në rastin e procedurave të prokurimit me vlerë më të lartë se kufiri i lartë monetar, në rast se kërkohet nga autoriteti kontraktor): Operatori Ekonomik në një procedurë Koncesioni/Partneritetit Publik Privat, paraqet Formularin e sigurimit të Ofertës, kur kërkohet, sipas Shtojcës 3.

Vlera e kërkuar e sigurimit të Ofertës është _____ Lekë (shuma e shprehur në fjalë).

Seksioni 4

Procedura

4.1 Lloji i procedurës:

E hapur E kufizuar Me negociim me shpallje paraprake

48

Plotësimi i dokumenteve standarde në të gjitha rubrikat e tij është një kusht i domosdoshëm për garantimin e zhvillimit të një procedure të drejtë, të barabrtë, transparente dhe në përputhje me kuadrin ligjor.

4.2.2 Kriteret dhe dokumentacioni

Në dhënien e Koncesioneve/Partneriteteve Publike Private, autoriteti kontraktues mund të përdorë procedurën e hapur, procedurën e kufizuar ose procedurën me negociim, me shpallje paraprake të njoftimit të kontratës. Për të vazhduar procesin e përzgjedhjes së fituesit duhet të pranohet së paku një ofertë e vlefshme.

Kur jepen Koncesione të punëve publike, afati për Dorëzimin e Ofertave është jo më pak se 30 ditë nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Në njoftimin për shpalljen e Procedurës së Dhënies së një shërbimi/veprimtarie në procedurë PPP-je, duhet të publikohen dhe dokumentet standarde që duhet të plotësohen nga Autoriteti Kontraktor dhe nga Operatori Ekonomik.

Në tabelën më poshtë do të pasqyrohen dokumentet standarde që duhet të plotësohen nga Autoriteti Kontraktor dhe dokumentet standarde që duhet të plotësohen nga Operatori Ekonomik, me qëllim që dosja e prokurimit të Partneritetit Publik Privat të jetë e plotë dhe të jenë përmbushur të gjitha kriteret dhe kushtet e parashikuara në ligj.⁴¹

Autoriteti kontraktor	Operatori ekonomik
Formulari i Ftesës për Ofertë i Procedurës së Kufizuar ose Me Negocim me Shpallje;	Formulari i Ofertës;
Formular për Vërtetimin e Kualifikimit/Pjesëmarrjes;	Formulari i sigurimit të Ofertës Shtojca;
Formulari për Njoftimin e Skualifikimit;	Formulari i Informacionit Konfidencial;
Formulari i Njoftimit të Fituesit;	Deklaratë mbi Përmbushjen e Specifikimeve teknike nga Operatori Ekonomik;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;	Formular i Vlerësimit për realizimin e punimeve;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;	Deklarata e Disponueshmërisë së makinerive;
Njoftim i Nënshkrimit të Kontratës;	Deklaratë mbi Gjendjen Gjyqësore; Kriteret e Vlerësimit;

⁴¹ Shënim: Dokumentacioni është ndarë referuar dokumenteve standarde të publikuar nga APP

	Vetëdeklarim për Ofertuesit e Huaj;
	Projekt-zbatimi dhe Specifikimet teknike;
	Preventivat ;
	Formulari i Ankesës në Autoritetin Kontraktor;
	Formulari i Prokurës.
	Formulari i Sigurimit të Kontratës;

Tabela nr.5

Dokumentet standarde duhet të publikohen së bashku me Njoftimin e Kontratës, me qëllim që çdo operator të ketë mundësi t'i plotësojë ato në përputhje me kërkesat e ligjit. Mosplotësimi i dokumentacionit të shpallur në njoftim apo mosplotësimi në mënyrën e duhur, mund të përbëjë shkak për skualifikimin e operatorit nga gara.

4.2.3 Kriteret e vlerësimit për dhënien e kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat. (neni 23 i LKPPP)

Kriter vlerësimi për dhënien e kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat është oferta ekonomike më e favorshme, bazuar në kritere të ndryshme, të lidhura me objektin e Koncesionit /Partneritetit Publik Privat në fjalë, që përfshijnë:

- Cilësinë;
- Meritat teknike;
- Karakteristikat estetike;
- Karakteristikat funksionale të mjedisit;
- Kostot e drejtimit;
- Kostoja e efektivitetit;
- Ofrimin e shërbimeve pas dorëzimit të produkteve dhe asistencën teknike;
- Datën e dorëzimit dhe periudhën e dërgesës ose periudhën e përfundimit të punimeve;
- Çmimin e shërbimit për përfituesit fundorë; shumën e tarifës së Koncesionit.

Komisioni i dhënies së Koncesionit specifikon në dokumentet e tenderit dhe në njoftimin e Kontratës koeficientët relativë, që ai i jep secilit prej kritereve të zgjedhura për të përcaktuar ofertën ekonomike më të favorshme. Këta koeficientë mund të shprehen duke parashikuar një gamë me një shtrirje të përshtatshme maksimale. Kur kjo nuk është e mundur, për shkak të arsyeve të justifikuara, Autoriteti Kontraktues tregon në njoftimin e Kontratës kriteret, sipas rendit zbritës të rëndësisë.

Shembull⁴²

Nr. Kriteret:

⁴² Shembulli është marrë nga një njoftim kontrate për realizimin e një projekti koncesionar në fushën e ndërtimit të infrastrukturës rrugore

1. Propozimi teknik për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës:
a. Projektide konceptuale;
b. Metodologjia e punimeve;
c. Plani operacional i mirëmbajtjes dhe disponueshmërisë
d. Sinjalistika e përkohshme dhe Siguria në kantier gjatë ekzekutimit të punimeve të ndërtimit
2. Ndikimi mjedisor
3. Ndikimi social
4. Afati i përfundimit të punimeve
5. Oferta Financiare

Në qoftë se ndonjë akt tjetër ligjor, që rregullon Koncesionet, përcakton tarifën më të ulët të Koncesionit, të cilën koncesionari është i detyruar ta paguajë, atëherë autoriteti kontraktues e deklaron këtë shumë në dokumentet e tenderit, si shumë të cilën ofertuesit duhet ta përfshijnë në ofertat e tyre.

4.2.4 Miratimi dhe konfirmimi i Procedurës së Koncesionit/PPP-së nga Ministria përgjegjëse për financat

Çdo projekt për dhënien e Koncesionit/PPP-së duhet të miratohet dhe konfirmohet nga Ministria përgjegjëse për financat. Autoriteti Kontraktues i paraqet një kërkesë me shkrim Ministrisë përgjegjëse për financat, e cila duhet të përmbajë (neni 18 dhe 19 i VKM-së nr.575/2013):

- a) projektkontratën;
- b) një raport të përmbledhur final të studimit të fizibilitetit, i cili duhet të përmbajë:
 - pasqyrën e flukseve të arkës;
 - analizën e risqeve që mund të ndikojnë projektin, e cila duhet të përfshijë një vlerësim cilësor dhe sasior, në rast të materializimit të këtyre risqeve;
 - dokumentin që projekti është parashikuar në programin buxhetor (PBA);

Pas marrjes së dokumentacionit të përcaktuar nga ky nen, Ministria përgjegjëse për financat verifikon dokumentacionin dhe, nëse vlerësohet i paplotë, kërkon plotësimin e tij.

Ministria miraton ose refuzon projektin jo më vonë se 40 (dyzet) ditë nga dita e marrjes së dokumentacionit të plotë, nëse Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë ndonjë kërkesë për plotësimin apo shpjegimin e dokumentacionit. Në rast se Autoriteti Kontraktues ka marrë një kërkesë të tillë, atëherë afati zgjatet 15 (pesëmbëdhjetë) ditë, nga dita kur është marrë informacioni.

Në rast se një projekt është hartuar me ndihmën e Agjencisë së Trajnimit të Koncesioneve (ATRAKO) ose të ekspertëve të jashtëm, atëherë Ministria përgjegjëse për financat nëpërmjet Autoritetit Kontraktues mund të kërkojë nga subjektet në fjalë një mendim shtesë për çështje që kanë rëndësi për objektin e analizës, e cila është nën autoritetin e Ministrisë përgjegjëse për financat.

E njëjta procedurë zbatohet pas negocimit të kontratës me operatorin e shpallur fitues dhe përpara nënshkrimit të saj. Autoriteti Kontraktues e dërgon projektkontratën për vlerësim përfundimtar në Ministrinë përgjegjëse për financat.

Kontratat e Koncesionit/PPP-së me mbështetje financiare dhe që marrin përsipër risqe fiskale, pas nënshkrimit nga palët dhe vetëm pas marrjes së vlerësimit përfundimtar nga Ministria përgjegjëse për financat, dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave.

4.2.5 Përzgjedhja e fituesit dhe nënshkrimi i Kontratës⁴³

Pas hapjes së ofertës, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave do ta shqyrtojë atë për të përcaktuar në qoftë se oferta është e pranueshme, në qoftë se dokumentacioni i kërkuar është dorëzuar, në qoftë se dokumentacioni i kërkuar për t'u firmosur nga ofertuesi është nënshkruar rregullisht dhe vetëm në qoftë se Oferta është e rregullt.

Vlerësimi i Autoritetit Kontraktues do të bazohet në të dhënat dhe vetë përmbajtjen e Ofertës, duke mos iu drejtuar burimeve të tjera. Megjithatë, kur është e nevojshme, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mund të kërkojë sqarime nga Ofertuesit, të cilat nuk e ndryshojnë thelbin e Ofertës.

Sqarimet duhet të jenë vetëm me shkrim ose/dhe të reflektuara në procesverbalin gjegjës. Gjithashtu, në raste të veçanta, Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e tij për të përfshirë edhe ekspertë të ndryshëm, të cilët mund të ndihmojnë në trajtimin e atyre çështjeve për të cilat Komisioni i Vlerësimit të Ofertave has vështirësi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave vlerëson një ofertë të vlefshme edhe kur ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk shmangin karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e procedurës përzgjedhëse, apo gabime, që mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.

Nëse më shumë se një ofertë financiare ka të njëjtën vlerë ose ka pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave harton klasifikimin përfundimtar, i cili duhet të njoftohet publikisht dhe t'u komunikohet Ofertuesve. Pas njoftimit të klasifikimit përfundimtar, çdo ofertues mund të kërkojë rishikim administrativ të procesit të përzgjedhjes, kur gjykon se një veprim i ndërmarrë nga Autoriteti Kontraktues dhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është në kundërshtim me parashikimet ligjore.

5. Procedura e ankimit (Neni 43, LKPP)

Çdo Operator Ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një Procedurë Konkurruese, kur është dëmtuar ose rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e Autoritetit Kontraktor të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, për të cilën pretendon se është marrë në kundërshtim me këtë ligj, ka të drejtë të ankimojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

⁴³ <https://www.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=72cb6b87-3bfe-41c1-83d9-357f4590b5b0>

Në rastin e Ankesave për dokumentet e Procedurës Konkurruese, Operatorët Ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme e publikimit të njoftimit të Kontratës në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Në rastin e Ankesave për Vendimin e Vlerësimit/Klasifikimit përfundimtar, Operatorët Ekonomikë kanë të drejtë të ankimojnë brenda 10 ditëve, duke filluar nga dita e nesërme, kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhej të ishte vënë në dijeni.

Një kopje me shkrim e Ankesës i dërgohet detyrimisht për dijeni edhe Autoritetit Kontraktor. Me marrjen e Ankesës me shkrim, Autoriteti Kontraktor pezullon vazhdimin e Procedurës Konkurruese deri në shqyrtimin plotësisht të Ankesës, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi nga KPP-ja.

Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet me shkrim, sipas formularit përkatës, ku shënohen emri dhe adresa e ankuesit, referimi për procedurën konkrete dhe bazën ligjore, ku ankuesi mbështet pretendimin për shkeljet, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin dhe provat përkatëse, për të cilat ai mendon se mbështesin ankimin e tij.

Komisioni i Prokurimit Publik përgjigjet me shkrim brenda 10 ditëve, nga data e depozitimit të Ankesës. Kur për shqyrtimin e Ankesës kërkohet informacion nga Autoriteti Kontraktor, KPP-ja përgjigjet me shkrim, jo më vonë se 20 ditë.

Procedura e Rishikimit Administrativ dhe Vendimmarrja e KPP-së, në përfundim të shqyrtimit të Ankesës, bëhen në përputhje me parashikimet përkatëse në legjislacionin e prokurimit publik.

Ndaj vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik, ankimuesi ka të drejtë të ankimojë në gjykatën përkatëse, që shqyrton mosmarrëveshjet administrative. Ankimi në gjykatë nuk pezullon procedurat konkurruese, lidhjen e kontratës apo ekzekutimin e detyrimeve mes palëve.

6. Treguesit (indiktorët) për vlerësimin dhe monitorimin e respektimit të akteve ligjore dhe nënligjore për Zhvillimin e Procedurave të PPP-ve

Me qëllim monitorimin e respektimit të kriterëve dhe kushteve, si dhe hapave procedurale për Zhvillimin e Procedurave për dhënien e PPP-ve, monitorimi duhet të orientohet drejt treguesve cilësorë dhe sasiorë. Disa nga treguesit mund të jenë:

	TREGUESIT E PERFORMANCËS	PO/JO
	A është procedura e zhvilluar për dhënien e PPP-së ‘procedurë e pakërkuar’?	

	A është SVP?	
	Dhënia e PPP-së është bërë me procedurë normale?	
	Procedura e PPP-së financohet 100% nga buxheti i shtetit?	
	Procedura e PPP-së financohet 100% nga operatori ekonomik?	
	Procedura e PPP-së financohet pjesërisht nga buxheti i shtetit dhe pjesërisht nga operatori ekonomik?	
	A është PPP-ja në formën e një ndërmarrje të përbashkët?	
	A është PPP-ja në formën e një “franzhis”?	
	A është PPP-ja në formën e një koncesioni?	
	A është përcaktuar dhe vlerësuar risku te kontrata e PPP-së?	
	A janë analizuar në mënyrë të detajuar në studimin e fizibilitetit:	
	• risqet e trojeve;	
	• risqet e projektimit, ndërtimit dhe të vënies në punë;	
	• risqet e funksionimit;	
	• risqet e kërkesës dhe risqe të tjera tregtare;	
	• risqet ekonomike ose financiare;	
	• risqet e pronësisë së aseteve;	
	• risqet politike;	
	• risqet e ndryshimit të kuadrit ligjor;	
	• risqet e forcës madhore;	
	A është transferuar risku te operatori ekonomik?	
	• risku politik;	
	• risku i qeverisjes;	
	• risku i ndryshimeve ligjore	
	• risku i ndërtimit;	
	• risku i transferimit të aseteve;	
	• risku i operimit dhe performancës;	
	• risku i ribalancimit të ekuilibrit financiar.	
	A është hartuar studimi i fizibilitetit për PPP-në?	
	A është hartuar studimi i fizibilitetit brenda 60 ditëve nga krijimi i komisionit?	
	A ka pasur raste që është shtyrë afati i sipërcituar?	
	A i përmban studimi i fizibilitetit elementet e mëposhtme?	
	• përcaktimin e llojit dhe objektin e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat;	
	• vlerësimin e risqeve të drejtpërdrejta financiare dhe ndikimin në buxhetin e qeverisjes qendrore dhe vendore;	
	• vlerën e parashikuar të kontratës;	
	• vlerësimet në lidhje me kriteret e zgjedhjes dhe të dhënies së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat;	
	• kohëzgjatjen e propozuar të Kontratës, si edhe çdo informacion tjetër të nevojshëm për përgatitjen e dokumentacionit të tenderit;	

	• përmbledhjen operationale dhe përshkrimin e përgjithshëm të projektit;	
	• analizat teknike, financiare, ekonomike dhe ligjore;	
	• studimet mjedisore dhe ndikimet në mjedis;	
	• anekset shoqëruese, shtesat e kërkuara, konkluzionet dhe rekomandimet.	
	Në rastin e Koncesioneve/PPP-ve për HEC-e, a është marrë oponencë nga strukturat kompetente përpara hartimit të studimit të fizibilitetit?	
	A është dërguar studimi i fizibilitetit për miratim në Ministrinë përgjegjëse për financat?	
	A i është bashkangjitur kërkesës drejtuar Ministrisë dokumentacioni i mëposhtëm?	
	• projektkontrata;	
	• raporti final i përmbledhur i studimit të fizibilitetit, i cili përmban: ○ pasqyrën e flukseve të arkës; ○ analizën e risqeve që mund të ndikojnë Projektin, e cila duhet të përfshijë një vlerësim cilësor dhe sasior, në rast të materializimit të këtyre risqeve; ○ dokumentin që Projekti është parashikuar në programin buxhetor (PBA);	
	A është shprehur Ministria përgjegjëse për financat brenda 40 ditëve?	
	A e ka miratuar Ministria përgjegjëse për financat kërkesën dhe studimin e fizibilitetit?	
	A e ka refuzuar Ministria përgjegjëse për financat kërkesën dhe studimin e fizibilitetit?	
	A përmban njoftimi i Kontratës të gjitha elementet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet standarde?	
	A janë plotësuar të gjitha rubrikat/seksionet e njoftimit të Kontratës nga Autoriteti Publik?	
	A janë përcaktuar kriteret e vlerësimit në njoftimin e Kontratës?	
	A janë përcaktuar koeficientët gjegjës për secilin kriter?	
	A është pulikuar njoftimi i Kontratës të paktën 30 ditë përpara dorëzimit të Ofertave?	
	A janë plotësuar nga Operatori Ekonomik të gjitha dokumentet standarde sipas parashikimeve ligjore?	
	A ka pasur ankesa ndaj dokumenteve të Procedurës Konkurruese?	
	A ka pasur ankesa ndaj vendimarrjes së përzgjedhjes së Operatorit fitues?	
	A janë iniciuar procese gjyqësore për mosrespektim të rregullave të Zhvillimit të Procedurës së PPP-ve?	
	A janë monitoruar zbatimi i kushteve dhe kriterëve ligjore për dhënien e PPP-ve nga APP?	
	A ka konstatuar shkelje të procedurave APP-ja?	

	A janë të trajnuar nëpunësit civilë në lidhje me zbatimin në mënyrë të duhur dhe në përputhje me ligjin të kriterëve dhe kushteve për Zhvillimin e Procedurave të PPP-ve?	
	A janë të trajnuar nëpunësit civilë lidhur me plotësimin në mënyrën e duhur të dokumenteve?	

	TREGUESIT E PERFORMANCËS	Në përqindje %
	Sa % zotëron ndërmarrja shtetërore dhe sa % zotëron institucioni publik nga 100% i kuotave?	
	Sa % zotëron ndërmarrja shtetërore, kur institucioni publik zotëron mbi 50% të kuotave?	
	Sa % zotëron ndërmarrja shtetërore, kur institucioni publik zotëron nën 50 % të kuotave?	
	Sa % e Kontratave janë lidhur nga Ministritë?	
	Sa % e Kontratave janë lidhur nga institucionet e njësive vendore?	
	Sa % e Kontratave të PPP-së kanë për objekt shërbime?	
	Sa % e Kontratave të PPP-së kanë për objekt kryerjen e veprimtarive/ndërtimeve?	
	Sa % e Kontratave të PPP-ve janë në fushën e energjitikës?	
	Sa % e Kontratave të PPP-ve janë në fushën e mjedisit?	
	Sa % e Kontratave të PPP-ve janë në fushën e shëndetësisë?	
	Sa % e Kontratave të PPP-ve janë në fushën e infrastrukturës publike?	
	Sa % e Ankesave të bëra në lidhje me dokumentet e Procedurave Konkurruese janë pranuar?	
	Sa % e Ankesave të bëra në lidhje me Procedurën e PPP-së dhe përzgjedhjen e Operatorit Fitues janë pranuar?	
	Sa % e çështjeve janë dërguar në gjykatë?	
	Sa % e çështjeve janë pranuar nga gjykata, sepse janë konstatuar shkelje të ligjit dhe Procedurave të Zhvilluara për dhënien e PPP-ve?	

MODULI 3 ELEMENTET E KONTRATËS SË PPP-së

1. Hyrje

Kontrata e Partneritetit Publik Privat është një veprim juridik që lidhet midis dy palëve, duke iu nënshtruar një procedure të veçantë që rregullohet nga një ligj i posaçëm. Krahës elementeve specifike që duhet të përmbajë një kontratë PPP-je, ajo në formë dhe përmbajtje në lidhje me përmbushjen e detyrimeve, afateve, zgjidhjen e kontratës etj, i nënshtrohet rregullimeve ligjore të parashikuara në Kodin Civil.

Përcaktimi në mënyrë të qartë i të drejtave dhe detyrimeve, si dhe të kushteve kontraktuale është një nga faktorët më të rëndësishëm që shërben jo vetëm si rregullator i marrëdhënies midis dy palëve kontraktuese, por edhe si një mekanizëm për ofrimin e një shërbimi cilësor mbrojtjen e buxhetit të shtetit nga ndikimet negative, si psh. ndërprerja e njëanshme e Kontratës nga Autoriteti Kontraktor për shkak se Operatori Ekonomik nuk ka zbatuar detyrimet në Kontratë në afatin e caktuar, mund të ngarkoj shtetin me detyrime për shpërblim dëmi nëse kjo situatë nuk është parashikuar si shkak për zgjidhjen e Kontratës.

Në dokumentet standarde të Zhvillimit të Procedurës së dhënies së Koncesionit/PPP-së janë parashikuar dhe kushtet e përgjithshme që duhet të përmbajë Kontrata e PPP-së.

Në këtë modul do të analizohen në mënyrë të detajuar elementet thelbësore që përmban një Kontratë Koncesioni/PPP-je, cilat janë palët kontraktuese, afati, shkaqet e zgjidhjes së Kontratës, rastet dhe Procedura se kur mund të ndryshohet Kontrata. Në fund të modulit do të pasqyrohen disa nga treguesit që do të shërbejnë për monitorimin e respektimit të kuadrit ligjor në lidhje me hartimin, përmbajtjen dhe zgjidhjen e Kontratës.

2. Palët në një marrëdhënie PPP-je

Marrëdhënia juridike e Partneritetit Publik Privat ka dy palë, në njërën anë është autoriteti publik kontraktor dhe nga ana tjetër është pala private, që mund të jetë më shumë se një subjekt privat (p.sh. bashkimi i dy ose me shumë subjekteve).

2.1 Autoriteti Kontraktues

Janë organet, të cilave ky ligj u jep kompetencat për të ndërmarrë një Procedurë për Dhënie e Koncesioneve/Partneriteteve Publike Private.

Autoritetet Kontraktuese janë:

- a) ministritë e linjës;
- b) njësitë e qeverisjes vendore.

Sa më sipër nuk mund të jenë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor në një Kontratë Koncesioni/PPP-je një institucion i pavarur (p.sh. KLSH, AP etj) ose institucionet e sistemit të drejtësisë.

2.2 Operatori Ekonomik⁴⁴

Operatori Ekonomik zakonisht i referohet shoqërisë kryesore të sektorit privat ose shoqërive që do të përfshihen në realizimin e Projektit, ndërsa "partneri privat" i referohet kundër-palës kontraktuale të palës publike. Në një PPP, është e zakonshme që një grup i palëve private të themelojnë një konsorcium për të ofertuar për Kontratën e PPP-së. Kur konsorciumit i jepet Kontrata, ajo krijon një shoqëri të re për të nënshkruar Kontratën dhe për të vepruar si partner privat.⁴⁵

Nocioni "operator ekonomik" duhet të interpretohet në mënyrë të gjerë, duke përfshirë personat dhe/ose subjektet, të cilët ofrojnë kryerjen e punimeve, furnizimin e produkteve ose ofrimin e shërbimeve në treg, pavarësisht nga forma juridike në të cilën ata kanë zgjedhur të operojnë. Kështu, shoqëritë tregtare, degët, bashkimet e shoqërive tregtare, shoqëritë kooperative, kompanitë e kufizuara, universitetet, publike ose private dhe format e tjera të subjekteve, të ndryshëm nga personat fizikë, duhet të përfshihen në nocionin e Operatorit Ekonomik, pavarësisht në qoftë se janë apo jo "persona juridikë" në të gjitha rrethanat.⁴⁶

Palë private duhet të jetë një person juridik, i cili ka zotësi juridike për të vepruar, është themeluar dhe regjistruar konform rregullave që parashikohen në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.⁴⁷

Krahas plotësimit të kushteve të themelimit dhe regjistrimit, subjekti privat duhet të përmbushë kriteret si më poshtë:⁴⁸

4. nuk është në proces falimentimi,
 5. nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP
 6. nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, që lidhet me aktivitetin e profesional, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
 7. ka plotësuar detyrimet fiskale;
 8. ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, (lëshuar nga Administrata Tatimore).
- Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Këto kriteret duhet të vërtetohen përmes dokumenteve lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së Ofertës.

Operatori Ekonomik mund të jetë i huaj dhe në këto raste duhet të jetë i regjistruar në regjistrat përkatës profesionale ose tregtarë të shtetit në të cilin ata janë themeluar, duke vërtetuar personalitetin e tyre ligjor. Për këtë kandidatët duhet të dorëzojnë një kopje të Ekstraktit mbi historikun e subjektit lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit. Kandidati/Ofertuesi i huaj

⁴⁴ Ligji për Koncesionet/PPP-të dhe VKM nr. 575, datë 10.07.2013, i ndryshuar

⁴⁵ [Kapitulli 1 - Partneriteti Publik-Privat - Hyrje dhe Pasqyrë.pdf](#), fq.18.

⁴⁶ [Direktiva e BE për prokurimin publik.pdf](#)

⁴⁷ Ligj nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare"

⁴⁸ <https://ëëë.app.gov.al/GetData/DownloadDoc?documentId=65f0a90d-33e8-4003-bebd-09a91b3558f4>

duhet të vërtetohet se ai i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër. Kur dokumentet e sipërpërmendura nuk lëshohen në shtetin e tyre të origjinës, atëherë mjafton një deklaratë me shkrim. Në qoftë se gjuha e përdorur në procedurë është shqip, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Me Ofertën që dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të jenë:

- a. Marrëveshja e noterizuar, sipas së cilës bashkimi i Operatorëve Ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

Në rast të bashkimit të grupeve të Operatorëve Ekonomikë, Autoriteti Kontraktues duhet t'ua kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, me qëllim të dorëzimit të Ofertës ose Kërkesës për pjesëmarrje.

Oferta që paraqitet nga një grup Operatorësh Ekonomikë, duhet të përcaktojë një përfaqësues, i cili i përfaqëson të tjerët gjatë Procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë Zbatimit të Kontratës. Në Ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit ose e punës, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

Para dorëzimit të Ofertës, grupi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen:

- përfaqësuesi i grupit;
- përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit;
- elementet konkrete të detyrimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi.

Në rastet kur bashkimi i Operatorëve Ekonomikë shpallet fitues, Kontrata duhet të nënshkruhet nga secili prej anëtarëve të këtij bashkimi.

Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, ose në rrethana të tjera që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë Zbatimit të Kontratës, Autoriteti Kontraktor mund të vazhdojë Kontratën me një operator tjetër ekonomik. Ai caktohet si përfaqësues i grupit dhe i propozuar nga anëtarët e tjerë jopërfaqësues, me kusht që të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar Kontratën. Përndryshe, Autoriteti Kontraktor mund të tërhiqet nga Kontrata.

Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, kur përfaqësuesi i grupit nuk cakton një zëvendësues, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i grupit, me kusht që të plotësojë kërkesat.

2.3 Subjekti për qëllime të veçanta (SPV) (Neni 39, LKPP)

Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë në dokumentacionin e tenderit që Operatori Ekonomik, zgjedhur si ofertuesi më i suksesshëm, të krijojë një person juridik, me seli në Republikën e Shqipërisë, i cili lidh kontratën.

Subjekti për qëllime të veçanta mund të marrë pjesë vetëm në realizimin e një Kontrate Koncesioni/Partneriteti Publik Privat, për të cilën ai është themeluar.

Në rastin e përcaktuar në pikën 1 të këtij Neni, në dokumentacionin e tenderit përcaktohen forma e personit juridik, shuma minimale e kapitalit, detyrimet e ofertuesit më të suksesshëm, në lidhje me themelimin e saj, si dhe marrëdhëniet e tjera midis ofertuesit më të suksesshëm, subjektit për qëllime të veçanta dhe Autoritetit Kontraktues.

3. Përmbajtja e Kontratës së Koncesionit/PPP-së⁴⁹ (Neni 27, LKPPP)

Kontrata përcakton të drejtat dhe detyrimet e Autoritetit Kontraktues dhe Koncesionarit/Partnerit Privat, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

Kontrata duhet të hartohet në përputhje me dokumentet e tenderit, me informacionet që gjenden në njoftimin e Kontratës, me Ofertën e zgjedhur dhe me njoftimin e dhënies së Kontratës.

Përveç Kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtën, në përputhje me këtë ligj, me dokumentet e tenderit, me vendimin e dhënies së koncesionit dhe me Ofertën e zgjedhur, të lidhë marrëveshje dhe/ose Kontrata shtesë dhe/ose të kushtëzuara, rast në të cilin Autoriteti Kontraktues njofton paraprakisht Ministrinë e Financave.

Marrëveshje dhe/ose Kontrata shtesë dhe/ose të kushtëzuara, të përshkruara në pikën 4 të këtij Neni, quhen në veçanti ato, të cilat janë të lidhura për të siguruar financimin e nevojshëm për zbatimin e Kontratës. Në këto raste, një Kontratë e kushtëzuar mund të jetë Kontrata e kredisë, që lidhet me një bankë të nivelit të dytë, e cila mundëson dhënien e një kredie për financimin e projektit.

Referuar dokumenteve standarde të tenderit, Kontrata duhet të përmbajë dispozitat e mëposhtme, të cilat konsiderohen dhe “kushtet e përgjithshme të kontratës”:

○ Qëllimi

Në këtë dispozitë parashikohet qëllimi i Kontratës, baza ligjore që rregullon marrëdhënien juridike/kontratën midis palëve. Në rastin konkret, ligji që rregullon Kontratën e Koncesionit/PPP-së është ligji për Koncesionet/Partneritetin Publik Privat në Republikën e Shqipërisë dhe Kodit Civil Shqiptar.

○ Përkufizime

⁴⁹ Neni 27 i LKPPP dhe dokumenat standard të tenderit të publikuar nga APP, aksesuar <https://ëëë.app.gov.al/GetData/DoenloadDoc?documentId=72cb6b87-3bfe-41c1-83d9-357f4590b5b0>

Në këtë dispozitë përcaktohen kuptimi dhe përkufizimi i disa prej termave kyçe të Kontratës, si p.sh:

- “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit, formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentet e tjer, të cilat përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- “Përfaqësuesi i Autoritetit Kontraktor” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor, i cili është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- “Termat e Referencës” shprehin objektin dhe qëllimin e Kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e shërbimeve, që do të sigurohen.

- **Hartimi i Kontratës**

- Njoftimi i ofertës fituese do të shërbejë për hartimin e Kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentet e tenderit.
- Egzistenca e Kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit duke sanksionuar të gjitha marrëveshjet midis palëve.

- **Praktikat e korruptuara, konflikti i interesit dhe kontrolli i procesverbaleve**

- Autoriteti Kontraktor mund t’i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme Kontratën në qoftë se zbulon që kontraktori ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent, që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumenteve të tenderit për këtë Koncesion/Partneritet Publik Privat.
- Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e Kontratës ose t’i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

- **Informacioni konfidencial**

- Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në mirëkuptim (konfidencë) të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacionet e tjera të ofruara nga pala tjetër, në lidhje me Kontratën.
- Kontraktori mund t’i japë nënkontraktorit dokumente të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar, me qëllim që nënkontraktori të zbatojë punën e tij sipas Kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në Kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtun ruajtjen e konfidencës, siç thuhet në Paragrafin më sipër.

- **Prona intelektuale**

- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë, të gjitha të drejtat e pronës

intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës, do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor, i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë, kontraktori, pas përfundimit të Kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat, si: hartat, diagramet, skicimet, specifikimet, planet, statistikën, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhur ose përgatitur nga kontraktori gjatë zbatimit të Kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumenteve dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdorë për qëllime që s'kanë lidhje me Kontratën, pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhvishjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas Kontratës.
- Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i Kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas Kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit, që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

- **Origjina e materialeve**

- Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. Kur materialet janë prodhuar nëpërmjet procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti, që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit, që furnizon me materiale.

- **Komunikimi**

Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim. Në Kontratë përcaktohen adresat dhe të dhënat e kontaktit të secilës palë, si dhe personi përgjegjës, të cilit do t'i bëhen komunikimet.

- **Detyrimet e përgjithshme të kontraktuesit**

- Kontraktuesi duhet t'i kryejë shërbimet dhe të përmbushë detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, mbështetëse dhe ekonomike, në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale të pranuar në përgjithësi.
- Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit, të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme, si dhe metoda të sigurta.

- Në rast se Kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesë e ruajë gjithmonë interesin publik.
- Nëse Kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në marrëdhëniet me palët e treta, përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime, që janë jashtë kompetencës së tij në përfaqësimin e Autoritetit Kontraktues.
- **Detyrimet e veçanta të kontraktuesit**
 - Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha shërbimet, siç specifikohet tek Termat e References.
 - Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha shërbimet, në sasi të përcaktuara, siç kërkohen nga Kontrata, përfshirë, por jo të kufizuara nga të gjitha raportet, dokumentet, studimet, skicimet dhe planimetritë.
 - Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e shërbimeve, siç kërkohet në Kontratë.
- **Specifikime dhe skicime**
 - Në rast se Kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të përgatisë të gjitha specifikimet dhe skicimet, duke përdorur sisteme të pranuar dhe të njohura në përgjithësi të pranueshme për Autoritetin Kontraktues dhe të marrë parasysh standardet më të fundit.
 - Në qoftë se Kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë përgatitur në bazë asnjënjë, përse i përket nxitjes së konkurrencës në prokurimin e objekteve të skicimit.
- **Lejet dhe licensat**

Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose licensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e shërbimeve në këtë Kontratë, veç rastit kur palët bien ndryshe në ujdi.

- **Siguracioni i përgjegjësisë profesionale**
 - Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithësi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoritetin Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e shërbimeve.
 - Në rast se nuk është përcaktuar në Kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithësi si të mjaftueshme në rrethanat e shërbimeve, që po sigurohen.

- **Nryshimi i ligjeve dhe rregulloreve**

Kur pas datës së nënshkrimit të Kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i Kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Kontratës.

- **Forca Madhore**

- Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit të Kontratës, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, kur dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas Kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.
- Për qëllimet e këtij Neni, “Forcë Madhore” do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, ndonëse nuk kufizohen nga veprimet e Autoritetit Kontraktor, në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, luftërat ose revolucionin, zjarri, përmblytja, tërmeti, epidemitë me shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.
- Në qoftë se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktori duhet të njoftojë menjëherë Autoritetin Kontraktues. Me përjashtim të rastit, kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, ai duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas Kontratës në masë praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin, kur nuk pengohet nga Forca Madhore.

- **Negociatat dhe amendamentet**

- Kontratat e parashikuara me këtë ligj mund të ndryshohen duke i shtuar kontratës një aneks, me kusht që kjo mundësi të parashikohet në dokumentacionin e tenderit dhe në Kontratë.
- Ndryshimet në Kontratë bëhen nga Autoriteti Kontraktues dhe Koncesionari/Partneri Privat.
- Ndryshimet në Kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese, veçanërisht në rastet e mëposhtme:
 - d) kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve;
 - e) kur humbet objekti i Kontratës ose kur ekziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në rastin e Forcës Madhore;
 - f) gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor;
 - g) në raste të tjera që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve, ose në realizimin e Kontratës.

- Ndryshimet e kushteve thelbësore të Kontratës që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë Kontratën, kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së Kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat.
- Termi “kushtet thelbësore” i referohet në veçanti kushteve, të cilat në rast se do të kishin qenë të përfshira në njoftimin fillestar të Kontratës ose në dokumentacionin e tenderit, do të kishin bërë të mundur që ofertuesit të dorëzonin një ofertë në thelb të ndryshme, si dhe sikur ndryshimet do të kishin tejkaluar objektin e Kontratës në atë masë, që këto ndryshime do të përfshinin shërbimet, të cilat nuk mbuloheshin fillimisht.
- Autoriteti Kontraktues kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave për të gjitha ndryshimet e planifikuara, të cilat ndikojnë ose krijojnë riskun e ndikimit direkt/indirekt në buxhetin e shtetit ose në buxhetin e organeve vendore, të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare, siç përcaktohet nga ky ligj.
- Autoriteti Kontraktues njofton jo më vonë se 20 ditë Ministrinë e Financave për ndryshimet e bëra në Kontratë në përputhje me këtë Nen.

● **Ndërprerja për shkak të falimentimit**

- Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë Kontratën në çdo kohë, në rast se Kontraktori falimenton ose bëhet i paafat të paguajë.
- Autoriteti Kontraktor duhet t’i japë Kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

● **Ndërprerja për shkak të interesit publik**

- Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë Kontratën në çdo kohë, në rast se gjykon që ky veprim duhet ndërmarrë për t’i shërbyer sa më mirë interesit publik.
- Autoriteti Kontraktor duhet t’i japë Kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
- Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktorin për të gjitha punët e pranuar, të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t’i paguajë Kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktori do të kërkojë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

● **Nënkontraktimi**

1. Autoriteti Kontraktues mund:
 - a) t’i kërkojë Koncesionarit që të japë Kontrata të cilat janë minimalisht 30 % e vlerës totale të Kontratës së Koncesionit të palët e treta, duke siguruar në të njëjtën kohë një mundësi për tenderuesit për ta rritur këtë përqindje, ndërkohë që kjo përqindje minimale specifikohet në Kontratën e Koncesionit;
 - b) të kërkojë nga tenderuesit që të tregojnë në ofertat e tyre përqindjen e vlerës totale të Kontratës, që ata planifikojnë t’u caktojnë palëve të treta.
2. Për nënkontraktimin e Partneriteteve Publike Private, që realizohen si Kontrata të punëve publike ose të shërbimit publik, zbatohen dispozitat përkatëse të Ligjit të Prokurimit Publik në përputhje me rrethanat.

- **Transferimi i të drejtave**

- Në përputhje me dispozitat e këtij Neni, me pëlqimin paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues, Kontrata e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat mund të transferohet te një person i tretë, që përmbush kërkesat e përshtatshmërisë, të përcaktuara në dokumentacionin e tenderit, në bazë të cilit Kontrata ishte dhënë fillimisht. Transferimi nuk kryhet në rast se këto kërkesa u referohen kushteve, që nuk janë më të nevojshme për përmbushjen e Kontratës, për faktin se këto detyrime dhe kërkesa të përmendura janë tashmë duke u konsumuar ose duke u realizuar nga Koncesionari /Partneri Privat i mëparshëm.
- Transferimi i Kontratës së Koncesionit nuk prish cilësinë dhe nuk përkeqëson vazhdimësinë e realizimit dhe të përmbushjes së Kontratës.
- Kur Koncesionari/Partneri Privat është një subjekt për qëllime të veçanta, atëherë ndryshimi i të drejtave të pronësisë apo i menaxhimit të Subjektit për Qëllime të Veçanta (SPV), si rezultat i transferimit të kapitaleve ose të aksioneve të biznesit, nuk mund të zbatohet pa miratimin e Autoritetit Kontraktues dhe të Ministrisë së Financave, përveç kur ky është një rezultat i tregtimit të rregullt të aksioneve në një treg të rregulluar të kapitalit.
- Autoriteti Kontraktues kërkon një miratim paraprak nga Ministria e Financave për të gjitha transferimet e planifikuara të Kontratës, të cilat ndikojnë ose krijojnë rrezikun e ndikimit në ndonjë mënyrë në buxhetin e shtetit ose në buxhetin e njësisë të qeverisjes vendore, ose të cilat mund të ndryshojnë në ndonjë mënyrë mbështetjen financiare, siç përcaktohet nga ky Ligj.
- Autoriteti Kontraktues njofton Ministrinë e Financave për transferimet e Kontratës të bëra në përputhje me këtë Nen.

- **Sigurimi i Kontratës**

Brenda _____ ditëve nga marrja e njoftimit për fitimin e Kontratës, Kontraktori duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e Kontratës në vlerën dhe formën, siç parashikohet në Kontratë. Dështimi për të dhënë sigurimin e Kontratës në formën dhe në vlerën e kërkuar brenda _____ ditëve do të rezultojë në anulimin e Kontratës dhe humbjen e sigurimit të Ofertës të Kontraktorit.

- **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

- Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.
- Në rast se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrëveshjeve sipas Kontratës dhe Procedurave Juridike në fuqi, sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

Përbushja e detyrimeve kontraktuale mbi shpërblimin në rastin e shkaktimit të demit, rregullohen nga Kodi Civil, në të gjitha rastet kur këto rregulla nuk janë parashikuar në Kontratë ose nuk parashikohen në Ligjin për Prokurimin Publik.

Krahas kushteve të përgjithshme të sipërcituara, Kontrata që lidhet midis Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik, duhet të specifikohen dhe kushtet e posaçme, të cilat lidhen me aspekte të ndryshme teknike, financiare të kryerjes së shërbimit /veprimtarisë objekt Koncesioni/PPP.

4. Afati i Kontratës së PPP-së (Neni 35, LKPP)

Kontrata e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat lidhet për një periudhë të caktuar. Kontrata e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se 35 vjet.

Autoriteti Kontraktues përcakton në studimin e fizibilitetit të Koncesionit/Partneritetit Publik Privat afatin e Kontratës, në mënyrë të tillë që kohëzgjatja e saj nuk e kufizon konkurrencën më shumë nga sa është e nevojshme, me qëllim që të sigurohet amortizimi i vlerës reale të investimeve të Koncesionarëve/Partnerëve Privatë dhe një normë e arsyeshme e kthimit të investimit. Afati kohor duhet i tillë duke marrë parasysh kostot dhe risqet e marra përsipër nga Koncesionari/Partneri Privat për kohëzgjatjen e Kontratës.

Afati kohor, për të cilin është dhënë Koncesioni/Partneriteti Publik Privat, fillon nga data e hyrjes në fuqi të Kontratës. Ai mund të zgjatet, nëse është e nevojshme, për shkak të ndryshimeve të Kontratës.

5. Garancitë e realizimit të Kontratës (Neni 28, LKPP)

Para nënshkrimit ose hyrjes në fuqi të Kontratës, Autoriteti Kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e Kontratës dhe instrumentet e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet në rast të dështimit të Koncesionarëve/Partnerëve Privatë për të përbushur detyrimet e parashikuara në Kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj.).

Sigurimi i Kontratës do të jetë deri në 5 % të vlerës së Kontratës dhe përcaktohet në dokumentet e tenderit. Kjo masë mund të reduktohet në mënyrë përpjesëtimore gjatë ekzekutimit të Kontratës. Në asnjë rast, gjatë kohëzgjatjes së saj, nuk mund të jetë më i vogël se 25 % e “vlerës fillestare të sigurimit”.

6. Ndryshimi i Kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat (Neni 31, LKPP)

Kontratat e Koncesioneve/PPP-ve mund të ndryshohen pas lidhjes së tyre, por vetëm duke plotësuar kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj.

Rregullat dhe kriteret për ndryshimin e kushteve të Kontratës janë parashikuar në Ligjin për PPP-të dhe në VKM-në nr. 575, datë 10.7.2013:

“Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat”, i ndryshuar.

E drejta për të bërë ndryshime të Kontratës pas lidhjes, duhet të përcaktohet në dokumentet standarde të tenderit dhe duhet t’u njoftohet Operatorëve Ekonomikë, që në momentin e njoftimit të procedurës për dhënien e Koncesionit/PPP-së.

Çdo ndryshim ose transferim i Kontratës së Koncesionit/PPP, duhet të dorëzohet në Ministrinë përgjegjëse për financat për miratim paraprak, e cila vlerëson dhe verifikon implikimet e mundshme fiskale, të drejtpërdrejta ose jo, mbi buxhetin e Autoritetit Kontraktues, buxhetin e shtetit ose që ndryshon në çfarëdolloj mënyre mbështetjen financiare. (Neni 23 i VKM-së)

Autoriteti Kontraktues paraqet me shkrim shkaqet e ndryshimit të propozuar dhe/ose të transferimit të Kontratës, shoqëruar me dokumentacionin përkatës, i cili përfshin:

- *një raport cilësor dhe sasior risku*
- *një raport mbi implikimet fiskale vjetore të drejtpërdrejta dhe/ose të pritshme të ndryshimeve gjatë kohëzgjatjes së Kontratës*
- *një përshkrim të burimeve të financimit për shërbimin e detyrimeve të drejtpërdrejta, duke përfshirë, por pa u kufizuar në pagesat e tarifave vjetore të disponueshmërisë si dhe garancitë.*

Ministria përgjegjëse për financat jep miratimin jo më vonë se 20 ditë, nga dita e marrjes së dokumentacionit të plotë, në bazë të pikës 2 të këtij neni, në rast se nuk kërkon informacion shtesë nga Autoriteti Kontraktues. Në rast se kërkohet një informacion i tillë, atëherë afati zgjatet 15 ditë nga dita, kur është marrë informacioni.

Në rastet kur ndryshimi ose transferimi i Kontratës së Koncesionit/PPP-së, i cili mbështet financiarisht nga buxheti i shtetit, merr përsipër risqe fiskale, Autoriteti Kontraktues ka detyrimin që pas marrjes së miratimit nga Ministria përgjegjëse për financat, ta dërgojë për miratim në Këshillin e Ministrave.

Ndryshimet në Kontratë bëhen me kërkesë të Autoritetit Kontraktues dhe/ose Koncesionari/Partneri Privat. Ndryshimet në Kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

- a. kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve;
- b. kur humbet objekti i Kontratës ose kur ekziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në rastin e Forcës Madhore;
- c. gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor;

- d. në raste të tjera, që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore, për përdorimin e objektit ose ofrimin e shërbimeve, apo në realizimin e Kontratës.

Ndryshimet e kushteve thelbësore të Kontratës, që nuk parashikohen në dokumentacionin e tenderit dhe/ose në vetë Kontratën, kërkojnë zbatimin e një procedure të re të dhënies së Kontratës së Koncesionit/Partneritetit Publik Privat.

Termi “kushtet thelbësore” u referohet në veçanti kushteve, të cilat, në rast se do të ishin të përfshira në njoftimin fillestar të Kontratës ose në dokumentacionin e tenderit, do të kishin bërë të mundur që ofertuesit të dorëzonin një ofertë në thelb të ndryshme edhe në rast se ndryshimet do të kishin tejkaluar objektin e Kontratës, në masën që ndryshimet do të përfshinin shërbimet, të cilat nuk mbulohen fillimisht.

7. Zgjidhja e Kontratës (Neni 36, LKPP)

Rastet dhe shkaqet për zgjidhjen e një Kontrate PPP-je duhet të parashikohen në mënyrë të qartë dhe të plotë në Kontratën e lidhur midis palëve, pasi mosparashikimi i tyre në mënyrë të qartë mund të sjellë dëme të konsiderueshme në buxhetin e shtetit. Me marrëveshje palët mund të zgjidhin Kontratën.

Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë, Autoriteti Kontraktues mund të ndërpresë Kontratën kur:

- b) mund të provojë se Koncesionari/Partneri Privat nuk mund të kryejë detyrimet e veta, për shkak të paafësisë paguese, shkeljeve serioze apo çështjeve të tjera, që pengojnë apo nuk lejojnë vazhdimin e Kontratës, në përputhje me standardet teknike dhe me standardet e tjera të pranuar;
- c) Koncesionari/Partneri Privat dështon në sigurimin e financimit të projektit brenda 12 muajve nga nënshkrimi ose hyrja në fuqi e Kontratës.

Secila palë, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në Kontratë, ka të drejtë të zgjidhë marrëveshjen kontraktore, kur:

- a) përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave të secilës palë;
- b) ka shkelje serioze nga pala tjetër; kjo palë nuk mund ta korrigjojë këtë shkelje brenda afatit kohor dhe në mënyrën e përcaktuar në Kontratë.

Para zgjidhjes së Kontratës, në përputhje me këtë Nen, Autoriteti Kontraktues informon Ministrinë e Financave për të gjitha rrethanat e njohura, të cilat çojnë dhe krijojnë kushtet për zgjidhjen e Kontratës dhe kërkon mendimin e saj.

8. Treguesit (Indikatorët) për vlerësimin dhe monitorimin e respektimit të akteve ligjore dhe nënligjore për Zhvillimin e Procedurave të PPP-ve

Me qëllim monitorimin e respektimit të kriterëve dhe kushteve që duhet të përmbajë Kontrata e PPP-së, monitorimi duhet të orientohet drejt treguesve cilësorë dhe sasiorë. Disa nga treguesit mund të jenë:

	<i>Treguesit e performances</i>	Po/Jo
	A është lidhur Kontrata në mënyrë të shkruar?	
	A janë publikuar dokumentat për përzgjedhjen e Kontratës?	
	A janë publikuar kushtet/kriteri dhe dokumentacioni i kërkuar për Zhvillimin e Procedurës së PPP-së?	
	A është paraqitur Kontrata për miratim dhe vlerësim në Ministrinë përgjegjëse për financat përpara nënshkrimit?	
	A është shpallur operatori fitues brenda 2 viteve nga miratimi i studimit të fizibilitetit nga Ministria e Financave?	
	A përmban Kontrata elementet e mëposhtme:	
	○ <i>Gjeneraliteti i plotë të palëve kontraktuese (autoriteti kontraktor/ operatori ekonomik)</i>	
	○ <i>A është përcaktuar në mënyrë të qartë objekti i shërbimit apo veprës që do të realizohet me PPP-në?</i>	
	○ <i>A është përcaktuar vlera e Kontratës së PPP-së?</i>	
	○ <i>A janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e palëve në mënyrë konkrete, që përputhet me natyrën e PPP-së?</i>	
	○ <i>A është përcaktuar dispozitë që parashikon të drejtën për të ndryshuar vlerën apo kushtet e Kontratës së PPP-së?</i>	
	○ <i>A janë përcaktuar penalitete për moszbatimin e detyrimeve?</i>	
	○ <i>A është përcaktuar në mënyrë të shprehur rasti i zgjidhjes së Kontratës në rast se Operatori Ekonomik nuk zbaton detyrimet e përcaktuara në Kontratë?</i>	
	○ <i>Kompetente për të shqyrtuar mosmarrëveshjen janë gjykatat e brendshme?</i>	
	○ <i>Kompetente për të shqyrtuar mosmarrëveshjen është arbitrazhi ndërkombëtar?</i>	
	A janë bërë ndryshime në Kontratë?	
	A janë bërë ndryshime të kushteve thelbësore të Kontratës?	
	A janë parashikuar ndryshimi/rinegociimi i kushteve thelbësore në dokumentet standarde të tenderit?	
	A është marrë miratimi paraprak nga Ministria përgjegjëse për financat në ndryshimin e Kontratës	
	A është bashkangjitur dokumentacioni i mëposhtëm kërkesës dërguar Ministrisë përgjegjëse për financën për ndryshimin e kontratës:	
	• <i>një raport cilësor dhe sasior risku</i>	

	<i>një raport mbi implikimet fiskale vjetore të drejtpërdrejta dhe/ose të pritshme të ndryshimeve gjatë kohëzgjatjes së Kontratës</i>	
	A është miratuar kërkesa për ndryshimin e Kontratës brenda afatit 20 ditor nga marrja e kërkesës së bashku me dokumentacionin?	
	Në rastet kur ndryshimet sjellin dhe ritje financiare, që ndikojnë në buxhetin e shtetit, a është dërguar kërkesa për miratim në Këshillin e Ministrave?	
	A është dhënë Kontrata me nënkontraktim?	
	A është marrë miratimi nga Autoriteti Kontraktues për dhënien e Kontratës me nënkontraktim?	
	A ka pasur mosmarrëveshje midis palëve në/gjatë zbatimit të Kontratës?	
	A është ndërprerë Kontrata për shkak të falimentimit?	
	A është ndërprerë Kontrata për shkak të interesit publik?	
	A është zgjidhur Kontrata në datën e përfundimit të saj?	
	A është zgjidhur Kontrata për shkak të mospërbushjes së detyrimeve në Kontratë?	
	A ka pasur mosmarrëveshje midis palëve gjatë zbatimit të Kontratës?	
	A janë iniciuar procese gjyqësore në lidhje me përmbushjen e detyrimeve kontraktore?	
	Në rast se po, paditës është Autoriteti Kontraktor?	
	Nëse po, paditës është Operatori Ekonomik?	

Treguesit e performancës	Përqindje (shifër) %/Numër
Sa përqind e Kontratave të PPP-ve janë me afat 5-10 vite?	
Sa përqind e Kontratave të PPP-ve janë me afat nga 10-20 vite?	
Sa përqind e Kontratave të PPP-së janë me afat 35 vite?	
Sa përqind e Kontratave të PPP-së janë lidhur nga ministritë?	
Sa përqind e Kontratave të PPP-ve janë lidhur nga insitucionet vendore?	
Sa përqind e Kontratave janë lidhur në fushën e mjedisit?	
Sa përqind e Kontratave janë lidhur në fushën e shëndetësisë?	
Sa përqind e Kontratave janë lidhur në fushën e energjitikës?	

Sa përqind e Kontratave janë ndryshuar?	
Sa përqind e Kontratave kanë ndryshuar kushtet thelbësore?	
Sa përqind e Kontratave janë zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga Autoriteti Kontraktor?	
Sa përqind e Kontratave janë zgjidhur në mënyrë të njëanshme nga Operatori Ekonomik?	
Sa përqind e Kontratave janë ndërprerë për shkak të falimentimit?	
Sa përqind e gjyqeve janë fituar nga Autoriteti Kontraktor?	
Sa përqind e gjyqeve janë fituar nga Operatori Ekonomik?	

MODULI 4

MONITORIMI I ZBATIMIT TË KONTRATËS SË PPP-SË

1. Hyrje

Monitorimi i Kontratave të PPP-ve është një nga fazat më të rëndësishme, e cila ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë në cilësinë e ofrimit të shërbimit a kryerjes së veprimtarisë, si dhe në menaxhimin dhe pakësimin e pasojave negative në buxhetin e shtetit.

Faza e zbatimit të Kontratës është një nga hapat më të rëndësishëm, pasi gjatë kohës së zbatimit të tij ofrohet shërbimi apo kryhet veprimtaria objekt Koncesioni/PPP-je, si dhe fillojnë efektet financiare, të cilat mund të prekin buxhetin e shtetit.

Krijimi i një strukture dhe sistemi për monitorimin e Kontratave është shumë e rëndësishme, sidomos në kushtet kur Kontratat zgjasin nga disa vite deri në 35 vite. Ndaj krijimi i një sistemi me kriteret të mirëpërcaktuara shërben jo vetëm për dokumentimin e ecures së Kontratës, por edhe për ndërmarrjen e masave për dhënien e rekomandimeve e deri në ndërprerjen e Kontratës, në rast se Operatori Ekonomik nuk përmbush kushtet e parashikuara në Kontratë.

Në muajin mars të vitit 2019, filloi për herë të parë procesi i monitorimit të Kontratave të Koncesionit/PPP-së dhe raportimi nga Autoritetet Kontraktuese, në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 121, seksioni IV i Udhëzimit plotësues nr. 1, datë 17.01.2019. “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2019”. Me miratimin e ndryshimeve të ligjit “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, raportimi në lidhje me ecurinë e zbatimit të Kontratave të Koncesioneve/PPP-ve nga Autoritetet Kontraktuese kryhet në zbatim dhe sipas formateve të përcaktuara në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 35, datë 12.12.2019.⁵⁰

Në këtë modul do të analizohen kriteret, procedura dhe institucionet kompetente për monitorimin e zbatimit të Kontratave, duke i ndërthurur me shembuj nga praktika. Në fund të modulit do të pasqyrohen disa nga indikatorët, të cilët do të përdoren për të monitoruar procesin e zbatimit të Kontratave.

2. Situata aktuale e zbatimit të Kontratave të Koncesioneve/PPP-ve në Shqipëri

Ndryshimet ligjore në Ligjin për Koncesionet dhe PPP-të në Shqipëri nuk i kanë eliminuar të gjitha problematikat që janë shfaqur në praktikë. Një nga problematikat, që evidentohet si nga vetë

⁵⁰ <https://arkiva.financa.gov.al/ep-content/uploads/2022/11/Raporti-Vjetor-i-Permbledhur-2021.pdf>

institucionet publike ashtu edhe nga raportet ndërkombëtare, është mungesa e monitorimit të zbatimit të Kontratave të PPP-ve.

Ndonëse Udhëzimi daton 6 vite më përpara, nga informacionet e marra në rrugë zyrtare konstatohet që shumica e institucioneve nuk raportojnë dhe nuk e kryejnë monitorimin e Kontratave. Ministria e Financës dhe Ekonomisë u ka dërguar shkresa⁵¹ shtatë (7) institucioneve duke u shprehur:

“Duke ritheksuar rëndësinë e procesit të monitorimit të kontratave të koncesionit/PPP, si dhe faktit që kontratat e koncesionet që menaxhohen nga ana juaj janë me mbështetje nga buxheti i shtetit, ku në kuadër të llogaridhënies janë pjesë e rëndësishme e Raportit Vjetor të Përmbledhur të ecurisë së zbatimit të kontratave, për të cilat ka një interes të lartë publik, kërkojmë angazhimin maksimal tuaj për përmbushjen e detyrimit ligjor për sa i përket zbatimit të kontratave të koncesioneve/PPP. Kjo për të mundësuar një proces monitorimi efektiv, standard dhe kronologjik sipas legjislacionit në fuqi, me qëllim minimizimin apo eliminimin e risqeve të drejtëpërdrejta e të tërthorta që ndikojnë në buxhetin e shtetit gjatë zbatimit të kontratave koncesionare/PPP.”

Rezulton që kanë lidhur Kontrata Koncesioni/PPP-je tetë (8) institucione dhe shtatë (7) prej të cilëve nuk bëjnë raportimet periodike apo vjetore, lidhur me ecurinë dhe monitorimin e mënyrës së zbatimit të Kontratave.

Mosrespektimi i kuadrit ligjor për monitorimin e Kontratave evidentohet si për institucionet qendrore, ashtu edhe nga institucionet e qeverisjes vendore.

Kjo problematikë është evidentuar dhe në raportet e organizmave ndërkombëtare dhe institucioneve të brendshme, ku pasqyrohet që një nga problematikat e PPP-ve në Shqipëri lidhet me mos monitorimin e tyre në mënyrë periodike.

Në Progres Raportin e vitit 2024⁵² konstatohet se:

“Pas ndarjes së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO) do të jetë në varësi të Ministrisë së re të Ekonomisë. Si ATRAKO ashtu edhe Ministria e Financave duhet të forcojnë raportimin e tyre për PPP-të, gjë që mungon. Autoritetet kontraktore duhet të vazhdojnë të ndërtojnë kapacitete për të menaxhuar proceset e prokurimit publik. Për sa i përket parandalimit të korrupsionit në prokurimet publike, Shqipëria duhet të fokusohet në forcimin e mëtejshëm të funksionimit të sistemit të përgjithshëm për të rritur konkurrencën, pajtueshmërinë dhe profesionalizimin.”

Në raportin e dhjetorit të vitit 2022, Fondi Monetar Ndërkombëtar⁵³ konstaton:

“Një numër rekomandimesh kryesore nga Vlerësimi i Menaxhimit të Investimeve Publike në 2016 (PIMA) janë ende të pazgjidhura. Asnjë ndryshim domethënës nuk është bërë në kuadrin ligjor dhe vendimet për partneritetet publiko-private, të vlerësuara në 40% të PBB-së 2022 (duke reflektuar vlerën e kontratës së projekteve ekzistuese dhe atyre në tubacion, të cilat vazhdojnë të merren jashtë procesit buxhetor. Kuadri për koordinimin dhe menaxhimin e PPP-ve vazhdon të vuaj nga dobësi të rëndësishme dhe shtrirja e risqeve fiskale të lidhura mbetet e paqartë. Autoritetet duhet të

⁵¹ Informacioni është vënë në dispozicion nga Minsitria e Financave dhe Ekonomisë, është marrë një ilustrim nga shkresa nr.4426, datë 06.03.2023. Përafërsisht e njëjta përmbajtje është dhënë në shkresat drejtuar institucioneve të tjera.

⁵² https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf

⁵³ <https://altax.al/raporti-i-dhjetorit-2022-i-fmn-per-shqiperine-qendrimi-e-autoriteteve-shqiptare-dhe-mendimi-jone/>

dyfishojnë përpjekjet për të përforcuar kapacitetin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të luajtur një rol efektiv garantues në përzgjedhjen e projekteve dhe për t'u angazhuar në mënyrë aktive në vlerësim dhe monitorim. Përmirësimi i procesve PPP dhe PIM, me integrim të plotë në ciklin normal të buxhetit, mbetet një prioritet urgjent.”

Në Deklaratën përfundimtare të Misionit të Nenit IV, FMN 2023⁵⁴, FMN shprehet:

“Progresi i vazhduar në reformat fiskale strukturore do të ndihmojë në forcimin e menaxhimit të financave publike. Bërja funksionale (operacionalizimi) e udhëzimeve për menaxhimin e investimeve publike do të përmirësojë klasifikimin, menaxhimin dhe monitorimin e projekteve. Përfshirja e partneriteteve publike-private (PPP) në kuadrin e zakonshëm të investimeve publike dhe në proceset buxhetore është nevojë urgjente dhe për këtë duhen ndryshime ligjore. Publikimi i planifikuar i një pasqyre të vecantë të rreziqeve fiskale në vitin 2024 është një hap i rëndësishëm drejt monitorimit të ardhshëm të rreziqeve fiskale, duke përfshirë rreziqet, që rrjedhin nga PPP-të, detyrimet kontigjente të nënkuptuara dhe ato ligjore, dhe ndërmarrjet me pronësi shtetërore. Pasqyra e rreziqeve fiskale duhet gjithashtu të identifikojë qartë masat për uljen e rreziqeve, duke përfshirë shtimin e mbikëqyrjes dhe mirëqeverisjes e ndërmarrjeve shtetërore.”

Aktualisht Shqipëria ka miratuar Strategjinë Kombëtare për Prokurimin Publik 2024-2030, ku si qëllim kryesor ka garantimin e një sistemi prokurimi efektiv dhe rezultativ në përputhje me parimet e transparencës, konkurrencës së lirë dhe të ndershme, mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë, duke promovuar dhe nxitur një sistem të qëndrueshëm që garanton vlerën për para.

3. Monitorimi i zbatimit të Kontratave të PPP-ve

Autoriteti Kontraktor është përgjegjës dhe ka një rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen dhe monitorimin e Kontratës së PPP-së, në rast se projekti objekt PPP-je po zbatohet në përputhje me parashikimet në Kontratë dhe kuadrin ligjor në fuqi. Siç është parashtruar dhe në modulet e mëparshme, Autoriteti Kontraktor është përgjegjës ndaj publikut, në lidhje me cilësinë dhe efektivitetin e shërbimit/veprimtarisë së ofruar nga Operatori Ekonomik.


Gjatë fazës së monitorimit, Operatori Ekonomik duhet të raportojë te Autoriteti Kontraktor që ka lidhur kontratën, dhe ky i fundit te Ministria përgjegjëse për financat.

Autoritetet Kontraktuese duhet që të paraqesin në Ministrinë përgjegjëse për financat raporte të përmbledhura të monitorimit të zbatimit të Kontratave të Koncesionit/PPP-së me argumentet dhe shpjegimet përkatëse. (Neni 10 i Ligjit për PPP-të)

Raportet duhet t'i paraqesin jo më pak se tri herë në vit dhe në të gjitha rastet, kur kërkohet nga Ministria përgjegjëse e financës.

Autoritetet Kontraktuese, brenda gjashtëmujorit të parë të çdo viti, dërgojnë në Ministrinë përgjegjëse për financat pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe të konfirmuara nga autoritetet tatimore të vitit paraardhës të shoqërive koncesionare. (Neni 10 /3)

⁵⁴[file:///C:/Users/User/Downloads/mcs102723-albania-alb-staff-concluding-statement-of-the-2023-article-iv-mission%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/mcs102723-albania-alb-staff-concluding-statement-of-the-2023-article-iv-mission%20(1).pdf)



Çdo Autoritet Kontraktues të ngrehë struktura monitoruese për çdo Kontratë Koncesioni edhe kur Kontrata specifike nuk e përcakton një strukturë të tillë, me qëllim që informacioni i raportuar pranë Ministrisë së Financave të jetë i plotë, gjithëpërfshirës dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.⁵⁵

Bazuar në raportet e monitorimit, të specifikuara në pikën 4, të këtij Neni, Ministria përgjegjëse për financat mund t'u rekomandojë Autoriteteve Kontraktuese marrjen e masave për përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve dhe punëve publike, objekt i këtyre kontratave, si dhe për minimizimin apo eliminimin e risqeve të drejtpërdrejta e të tërthorta që ndikojnë në buxhetin e shtetit.

4. Procedura e monitorimit të zbatimit të Kontratave të Koncesionit/PPP-së

Procedura, rregullat standarde dhe afatet që duhet të ndiqen në procesin e raportimit dhe monitorimit të ecurisë dhe performancës financiare dhe jofinanciare të Kontratave të Koncesionit/PPP-së janë parashikuar në Udhëzimin nr. 35, datë 12.12.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Procesi formal i raportimit mbi ecurinë e monitorimit të Kontratave të Koncesionit/PPP-së kërkon përgatitjen e të paktën 4 raporteve periodike të monitorimit në vit për ecurinë dhe performancën financiare dhe jofinanciare të Kontratave të Koncesionit/PPP-së si dhe të një raporti vjetor monitorimi mbi ecurinë e termave të Kontratës së Koncesionit/PPP-së (pika II/1 e Udhëzimit).

Autoritetet kontraktore duhet të bëjnë raportet periodike të monitorimit sipas formateve të parashikuara në udhëzim, të cilat përfshijnë:

1. Profili i Projektit;⁵⁶

Profili i Projektit përmban të dhëna të përgjithshme që lidhen me Kontratën e Koncesionit/PPP-së. Më poshtë do të pasqyrojmë në tabelë elementet që duhet të plotësohen nga Autoriteti Kontraktor për plotësimin e formatit “profili i projektit”:

Aneksi 1: Profili i Projektit	Përshkrimi
Data	Data (dita/muaji/viti) në të cilën ky aneks është përditësuar.
Emri i Projektit	Projekti përfshin të gjitha Kontratat e lidhura (duke përfshirë Kontratat e veçanta të mbikëqyrjes). ⁵⁷
Autoriteti Kontraktues	Subjekti qeveritar përgjegjës (ministria e linjës/qeverisja lokale, etj.)-përgjegjës kryesor në procesin e monitorimit të këtij Projekti të Koncesionit/PPP-së.
Autoriteti Kontraktues nr.2 (n.q.s. ka)	Institucione të tjera qeveritare.
Partneri Privat	Emri i SPV ose strukturës tjetër të sektorit privat që bashkëpunon me qeverinë.
Vlera e Investimit (shpenzimet në lidhje me ndërtimin, përfshirë TVSH-në)	Të gjitha shpenzimet që lidhen me ndërtimin (përfshirë shpenzimet siç është dizenjimi) përfshirë dhe TVSH-në.
Kosto totale e planifikuar për qeverinë (përfshirë TVSH-në)	Shuma e kontributeve vjetore të planifikuara të buxhetit, përfshirë TVSH-në.
Data e fillimit të Kontratës	(DD/MM/YYYY) data e nënshkrimit të Kontratës.
Kohëzgjatja (vite)	Planifikim /ndërtim /operim /hibrid (pjesa ndërtimore dhe pjesa operative) /joaktive.
Faza e Projektit	Faza ku ndodhet procesi i Projektit
Përshkrimi i Projektit	Çfarë sektori është?
	Cili është shërbimi i ofruar nga Projekti i Koncesionit/PPP-së?
	Çfarë asetë përfshin?
	Çfarë ndodh me asetet në fund të Projektit?
Përmbledhja e progresit të Projektit	A është Projekti në rrugën e duhur? Çfarë po shkon mirë dhe cilat janë fushat me probleme?
	Arritjet dhe pengesat?

⁵⁶Aneksi i Udhëzimit nr.35, dat 12.12.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

⁵⁷ Shënim: Kontratat e mbikëqyrjes janë

	Përcaktoni në rast sesi/pse faktorët devijojnë materialisht nga (i) plani në nënshkrimin e Kontratës dhe (ii) plani nga raportet e mëparshme të monitorimit.
	Theksoni në rast sesi/pse plani ndryshon thelbësisht nga raportet e mëparshme të monitorimit
	A është Kontrata në rinegocim?
	A ka çështje gjyqësore në proces?
	A ka shikueshmëri të qartë në lidhje me pagesat buxhetore?
Risqet kryesore	Përmbledhja e risqeve më të rëndësishme për projektin që mund të materializohen në të ardhmen dhe duhet të monitorohen.
	Përmbledhje e risqeve më të rëndësishme për Projektin që janë materializuar tashmë.
	Shihni kategoritë e risqeve në Aneksin e matricës së risqeve dhe mjetin PFRAM në internet për të ndihmuar në identifikimin e rreziqeve kryesore.

Tabela nr.6

2. Ecuria vjetore e termave të kontratës së Koncesionit/PPP-së⁵⁸

Krahas formularit të “profilit të projektit”, Autoriteti Kontraktues duhet të plotësojë formularët e ecursë vjetore të termave të Kontratës. Formulari përfshin elemente që lidhen me pagesat e buxhetit, fazat e projektit. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet modeli i formularit të ecursë vjetore.

Aneksi 2: Statistika vjetore të Projektit			
Emri i Projektit			
Data në të cilën Aneksi është përditësuar (DD/MM/YYYY)			
			Përshkrimi i rreshtit
Financimi	Pagesa e buxhetit 1 (Autoriteti Kontraktues 1)	Planifikuar	Pagesat cash të planifikuara nga buxheti (me TVSH)
		Aktuale	Pagesat cash të kryera nga buxheti (me TVSH)
	Pagesa e buxhetit 2 (Autoriteti tjetër Kontraktues, në rast se ka)	Planifikuar	Pagesat cash të planifikuara nga buxheti (me TVSH)

⁵⁸ Aneksi i Udhëzimit nr. 35, datë 12.12.2019 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

		Aktuale	Pagesat cash të kryera nga buxheti (me TVSH)
	Të ardhurat nga përdoruesit	Vlerësuar	Të ardhurat cash të vlerësuar (me TVSH nëse ka)
		Aktuale	Të ardhurat cash të mbledhura (me TVSH nëse ka)
Ndërtim	Progresi i ndërtimeve (% e përfunduar; fundi i periudhës)		
Kërkesa (përdoruesit / shërbimet e ofruara)	Treguesi i kërkesës 1	Vlerësuar	
		Aktuale	
	Treguesi i kërkesës 2	Vlerësuar	
		Aktuale	
	Treguesi i kërkesës 3	Vlerësuar	
		Aktuale	
Performanca (matja e cilësisë së shërbimit)	Treguesi i performancës	I kërkuar	
		Aktual	
	Treguesi i performancës 2	I kërkuar	
		Aktual	
	Treguesi i performancës 3	I kërkuar	
		Aktual	

Tabela nr.7

3. Ecuria tremujore e termave të Kontratës së Koncesionit/PPP-së;⁵⁹

Formati i ecurisë tremujore është i ngjashëm me formularin e raportit vjetor, me ndryshimin që ky raport duhet të plotësohet çdo tre muaj, përfshin të dhënat financiare dhe ecurinë teknike të Projektit për periudhën tremujore. Në rast se Autoriteti Kontraktues është i përpiktë dhe plotëson çdo tre muaj Projektin, formulari i ecurisë vjetore është përmbledhje e raporteve periodike.

Emri i Projektit		
Data në të cilën Aneksi është përditësuar (DD/MM/YYYY)		
Financimi	Pagesa e buxhetit 1 (Autoriteti Kontraktues 1)	Planifikuar

⁵⁹ Aneksi i Udhëzimit nr. 35, datë 12.12.2019, i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

		Aktuale
	Pagesa e buxhetit 2 (Autoriteti tjetër Kontraktues, në rast se ka)	Planifikuar
	Të ardhurat nga përdoruesit	Aktuale
		Vlerësuar
		Aktuale
Ndërtim	Progresi i ndërtimeve (% e përfunduar; fundi i periudhës)	
Kërkesa (përdoruesit / shërbimet e ofruara)	Treguesi i kërkesës 1	Vlerësuar
		Aktuale
	Treguesi i kërkesës 2	Vlerësuar
		Aktuale
	Treguesi i kërkesës 3	Vlerësuar
		Aktuale
Performanca (matja e cilësisë së shërbimit)	Treguesi i performancës 1	I kërkuar
		Aktual
	Treguesi i performancës 2	I kërkuar
		Aktual
	Treguesi i performancës 3	I kërkuar
		Aktual

Tabela nr. 8

Plotësimi i formularëve në mënyrë të detajuar, duke pasqyruar të gjitha të dhënat e ecurisë së Projektit, shërben si një udhëzues për Autoritetin Kontraktues për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të Kontratës hap pas hapi, duke i mundësuar Autoritetit Kontraktues menaxhimin e situatës, si dhe marrjen e masave për eliminimin e efekteve negative apo risqeve. Afatet shumë të gjata të Kontratave (deri në 35 vite), kërkojnë mbajtjen e një dokumentacioni të plotë dhe të përditësuar për menaxhimin dhe mbikëqyrjen në mënyrë efektive të shërbimit, që ofrohet ose veprimtarisë që kryhet.

4. Monitorimi periodik i risqeve për Kontratën e Koncesionit/PPP-së⁶⁰

Në Modulin 1 është trajtuar koncepti i riskut si një nga elementet kyçe, që shërben për të bërë dallimin midis Kontratave të PPP-së dhe Kontratave të tjera publike. Për të monitoruar risqet që mund të vijnë gjatë zbatimit të kontratës, çdo autoritet publik duhet të bëjë monitorimin periodik të risqeve, me qëllim marrjen e masave për t'i menaxhuar edhe eliminuar ato në të ardhmen.

⁶⁰ Aneksi i Udhëzimit nr. 35, datë 12.12.2019, i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Analizimi i risqeve është një nga elementet që duhet të raportojnë Autoritetet Kontraktuese çdo 3 muaj. Analizimi i riskut duhet të bëhet sipas formatit të mëposhtëm, i cili i është bashkangjitur Udhëzimit nr. 35/2019:

	Probabiliteti që risku fiskal të materializohet në të ardhmen: • I lartë • I mesëm • I ulët	Ndikimi fiskal në rast se risku materializohet në të ardhmen: • I lartë • I mesëm • I ulët	Kalsifikimi i riskut në të ardhshëm në këtë kategori - vlerësimi i rrezikut: • I parëndësishëm; • I ulët; • I mesëm; • I lartë; • Kritik
Risku i ndërtimit: ⁶¹ vonesat e Projektit ose tejkalimi i kostos në fazën e ndërtimit			
Risku i kërkesës: ⁶² devijimi i kërkesës për shërbim (përdorim) nga parashikimi			
Risku operacional: Projekti PPP nuk është në gjendje të ofrojë shërbimin me cilësinë dhe sasinë e kërkuar			
Risqet financiare: rreziqet që lidhen me luhatjet e kursit të këmbimit, normës së interesit dhe kushteve të tjera financiare			
Risku i forcës madhore: rrethana të paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve, që e pengojnë			

⁶¹ Ky artikull duhet të diskutojë kostot e mundshme shtesë me të cilat Qeveria mund të përballlet në rast se Projekti PPP nuk është dorëzuar me kohë ose ka komplikime të tjera në lidhje me ndërtimin, përfshirë çështjet në lidhje me shpronësimin e tokës, riskun gjeologjik, etj.

⁶² Ky artikull është i nevojshëm për të nxjerrë në pah klauzolat e Kontratës, siç janë klauzolat për sasinë minimale të kërkesës / të të ardhurave ose penalitetet në rast se kërkesa tejkalon një nivel të caktuar etj.

koncesionarin të përmbushë kontratën			
Risku i veprimeve negative të qeverisë (MAGA)			
Risku i ndryshimit të ligjit			
Risku i rinegociimit: ndryshim në Kontratë me kosto të mundshme fiskale			
Risku i përfundimit para kohe të kontratës: anulimi i Projektit			
Risqe të tjera: çdo rrezik tjetër material që nuk bën pjesë në kategoritë e mësipërme			

Tabela nr. 9

Mbajtja e të dhënave në mënyrë sistematike nga ana e Autoritetit Kontraktues jo vetëm është një pasqyrim real i situatës së zbatimit të një Kontrate PPP-je, por shërben dhe si një Udhëzues për sqarimin e Operatorit Ekonomik në respektimin e afateve dhe detyrimeve kontraktuale, me qëllim mbrojtjen e buxhetit dhe ofrimin e një shërbimi/veprimtarie cilësore.

5. Afatet e monitorimit të zbatimit të Kontratave të Koncesioneve/PPP-ve

Brenda datës 10 të muajit pasardhës të periudhës tremujore në monitorim, dërgohet raportimi, si edhe sa herë që kërkohet nga Ministria përgjegjëse për Financat, lidhur me periudha të caktuara apo specifika eventuale.

Çdo vit Ministria e Financave përgatit dhe publikon Raportin Vjetor të Përmbledhur, i cili është një dokument që përfshin mbledhjen dhe raportimin e të dhënave, të ecures dhe performancës financiare dhe jofinanciare të Kontratave të Koncesionit/PPP-së, i cili synon që të sigurojë që risqet kryesore fiskale nga Kontratat e Koncesionit/PPP-së janë identifikuar dhe raportuar në mënyrë sistematike. (pika III e Udhëzimit).

6. Treguesit (Indikatorët) për monitorimin e fazës së zbatimit të Kontratave të Koncesionit/PPP-ve

Me qëllim monitorimin e fazës së monitorimit të zbatimit të Kontratës së PPP-së, përmbajtjes së Kontratës dhe përfundimit të saj, monitorimi duhet të orientohet drejt indikatorëve cilësorë dhe sasiorë.

Disa nga indikatorët mund të jenë:

	Treguesit e performancës	PO/JO
	A janë dërguar raporte të përmbledhura monitorimi nga Autoritetet Kontraktuese te Ministria e Financave?	
	A janë dërguar raporte periodike çdo tre muaj?	
	A janë plotësuar të gjitha rubrikat në Aneksin “profili i projektit”	
	A janë plotësuar të gjitha elementet në Aneksin “ecuria tremujore e projektit”	
	A janë plotësuar të gjitha elementet në Aneksin “matrica e riskut”?	
	A janë klasifikuar risqet sipas kritereve të përcaktura?	
	A janë lehtësisht të identifikueshëm risqet?	
	Referuar raporteve të monitorimit sipas Anekseve a mund të përcaktoni ecurinë e Projektit?	
	Referuar raporteve të monitorimit a mund të identifikoni në rast se një procedurë PPP-je është në proces gjyqësor?	
	A janë bërë raportime vjetore nga Autoritet Kontraktuese të Ministrisë së Financave?	
	A janë dhënë rekomandime nga Ministria në lidhje me zbatimin dhe ecurinë e kontratave?	
	A janë depozituar pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe të konfirmuara nga Autoritetet Tatimore të vitit paraardhës të shoqërive koncesionare brenda afatit të gjashtëmujorit të parë?	
	A raportojnë në mënyrë periodike Operatorët Ekonomikë te Autoriteti Kontraktues në lidhje me vijimin e Kontratave?	
	Ministritë raportojnë rregullisht mbi monitorimet e Kontratave të PPP-ve?	
	Institucionet e qeverisjes vendore raportojnë rregullisht mbi monitorimet e Kontratave të PPP-ve?	
	A janë marrë masa nga Ministria përgjegjëse për financat kundrejt institucioneve që nuk raportojnë në mënyrë periodike?	

	A janë të trajnuar nëpunësit civilë për mbajtjen e të dhënave periodike mbi monitorimin e Kontratave të PPP-ve?	
	A janë të trajnuar nëpunësit civilë në lidhje me plotësimin në mënyrë të duhur të formularëve të raportimeve?	

MODULI 5

TRANSPARENCA DHE MARRJA E INFORMACIONIT MBI NJË PROCEDURË/KONTRATË PPP-JE

1. Hyrje

Transparenca e Zhvillimit të Procedurave të PPP-ve është një nga parimet bazë, e cila garanton respektimin e rregullave të Zhvillimit të Procedurës, si dhe i mundëson publikut që të ushtrojë të drejtën e tij për të monitoruar menaxhimin e buxhetit të shtetit në rastet e delegimit të kompetencës për kryerjen e një shërbimi/veprimtarie nga institucioni publik te privati.

Procedura e dhënies së PPP-ve duhet të jetë transparente, nga momenti i publikimit të procedurës, kritereve, dokumentacionit deri në përzgjedhjen e Operatorit Ekonomik. Detyrimi për të respektuar parimin e transparencës në rastin e PPP-ve shtrihet deri në përfundim të Kontratës së PPP-së.

Transparenca dhe informimi janë dy parime shumë të rëndësishme, kur bëhet fjalë për PPP-të, pasi në kushtet kur nëpërmjet këtyre procedurave i “delegohet” subjektit privat kryerja e një shërbimi apo pune publike me financimin nga buxheti i shtetit, institucionit publik i lind detyrimi për të informuar qytetarët në lidhje me përdorimin dhe menaxhimin e taksave të tyre/buxhetit të shtetit. Edhe në rastin kur financimi bëhet nga vetë Operatori Ekonomik, në kushtet kur ai kryen një shërbim apo veprimtari që ka interes publik, lind detyrimi që gjithë procedura deri në përfundimin e Kontratës të jetë transparente.

Një nga problematikat e identifikuara në raportet e brendshme, ashtu edhe në raportet ndërkombëtare, është mungesa e transparencës në lidhje me Procedurat e Dhënies së PPP-ve, publikimit të Kontratave, raporteve të monitorimit të zbatimit të Kontratave të PPP-ve. Duke iu referuar afateve të gjata të Kontratave të PPP-së, mospublikimi në mënyrë periodike i të dhënave dhe ecurisë së një Kontrate PPP-je sjell një situatë të “errët” dhe të paqartë sesi po menaxhohet buxheti i shtetit, cilësia e ofrimit të shërbimit publik/kryerjes së veprimtarisë.

Në këtë modul do të analizohet kuadri ligjor, mjetet juridike për të kërkuar informacion në lidhje me Procedurat dhe Kontratat e Partneritetit Privat Publik, rastet e kufizimeve dhe e drejta për të kërkuar në rrugë administrative dhe gjyqësore informacionin/dokumentacionin në lidhje me PPP-të.

Duke qenë se dhënia e një procedure PPP-je kërkon ndërveprimin midis disa institucioneve, informacioni dhe dokumentacioni për faza të ndryshme të procesit të PPP-së mund të përftohet në disa mënyra:

1. Monitorimi i faqeve zyrtare, duke identifikuar dokumentacionin e publikuar në mënyrë pro aktive nga institucionet;
2. Kërkesë për informacion në lidhje me procedura konkrete të koncesionit/PPP-së;
3. Monitorimi i raporteve dhe statistikave të publikuara nga institucionet;

Moduli do të përfshijë dhe një përshkrim hap pas hapi të rrugëve dhe mjeteve për të monitoruar transparencën e institucioneve në lidhje me procedurat e PPP-ve nga momenti i njoftimit të Kontratës/Shpalljes së Procedurës, deri në zbatimin e saj.

Në fund të modulit do të pasqyrohen disa nga indikatorët, të cilët do të shërbejnë si një guidë për të monitoruar respektimin e parimit të transparencës dhe të drejtën e informimit nga institucionet kompetente.

2. Transparenca e institucioneve publike në lidhje me Zhvillimin Procedurës së PPP-ve

Transparenca dhe e drejta e informimit janë dy koncepte të cilat vendosin përpara përgjegjësisë institucionin publik që gjatë ushtrimit të veprimtarisë publike të jetë transparente (proaktiv), çka do të thotë se pavarësisht në rast se informacioni kërkohet apo jo nga një qytetar, institucioni e publikon atë dhe, nga ana tjetër institucioni ka detyrimin që edhe në rast se nuk ka publikuar një procedurë, kur një qytetar i kërkon informacion, duhet t’ia vendosë në dispozicion.

Në Nenin 5 të K. Pr. Administrative, parimi i transparencës nënkupton që organet publike ushtrojnë veprimtarinë administrative në mënyrë transparente dhe në bashkëpunim të ngushtë me personat fizikë dhe juridikë të përfshirë në të. (Neni 5 i K.Pr. Administrative).

Gjykata Evropiane e Drejtësisë është shprehur se:⁶³

“Detyrimi për transparencë që i imponohet autoritetit kontraktor konsiston në sigurimin, për përfitimin e çdo ofertuesi të mundshëm, një shkallë reklamimi të mjaftueshme për të mundësuar hapjen e tregut të shërbimeve ndaj konkurrencës dhe paanshmërisë të rishikimit të procedurave të prokurimit.”

Detyrimi i institucionit publik për të bërë transparente Procedurat e Koncesioneve/PPP-ve rrjedh dhe nga Neni 7, pika ë) i Ligjit nr.119/2014, i cili parashikon se:

⁶³ Ruth Nielsen, Law Department, Copenhagen Business School
<https://arbetsratt.juridicum.su.se/filer/pdf/kLaw46/discrimination.procurement.pdf>

“Në përuthje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin paraprakisht, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet kategoritë e mëposhtme të informacionit:

...ë) informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit /partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr. 9643, datë 20.12.2006, “Për prokurimin publik”, dhe të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë:

i) listën e kontratave të lidhura;

ii) shumën e kontraktuar;

m. palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara;

n. informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme;”

Sa më sipër, institucionet publike kanë detyrimin që të publikojnë informacionin në lidhje me Koncesionet/PPP-të në mënyrë proaktive dhe në mënyrë të vazhdueshme.

Monitorimi i transparencës së institucioneve në lidhje me Procedurat e Koncesioneve/PPP-ve në faza të ndryshme të procesit dhe identifikimi i tyre mund të realizohet në disa mënyra, duke aksesuar burime të ndryshme nga faqet zyrtare të institucioneve, si më poshtë:

2.1 Regjistri i Koncesioneve/Partneritetit Publik Privat

Të dhënat në lidhje me Kontratat e lidhura të PPP-së në Republikën e Shqipërisë mbahen në regjistrin e Koncesionit/Partneritetit Publik Privat, i cili krijohet dhe mbahet nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO), në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Faqja ku mund të aksesohet regjistri është atrako.gov.al, në rubrikën “Regjistri”:

← → ↻ Not secure atrako.gov.al/?page_id=112


Agjencia e Trajtimin të Koncesioneve



[Kreu](#)
[Rreth Nesh](#)
[Legjislacioni](#)
[Regjistri](#)
[Publikime](#)
[Programi i Trasparencës](#)
[Kontakt](#)
[Denonco](#)

Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale.

Data e nënshkrimit: **2015-12-10** | Fusha e veprimtarisë: **Shendetesi** | Lloji i kontratës: **Kontrate Sherbimesh**

Çmimi i shërbimit: **0** | Vlera e investimit: **1503282620** | Tarifa të tjera: **0%** | [Më shumë...](#)

Menaxhimi, operimi, mirembajtja dhe pëmirësimi teknik i terminalit të konteinerneve në portin e Durrësit

Data e nënshkrimit: **2011-06-22** | Fusha e veprimtarisë: **Transport** | Lloji i kontratës: **Kontrate Pune**

Çmimi i shërbimit: **0** | Vlera e investimit: **32500000** | Tarifa të tjera: **2%** | [Më shumë...](#)

Pasi keni hyrë në faqen zyrtare të ATRAKO-s, duhet të shkoni te rubrika “Regjistri” dhe pas klikimit të saj do Kontratave të Koncesionit/PPP-ve, i cili përmban të dhëna në lidhje me datën e nënshkrimit të Kontratës, fushën e veprimtarisë, llojin e Kontratës, vlerën e investimit.

Nëse klikoni rubrikën “Më shumë”, do shfaqen të dhëna të detajuara që lidhen me kohëzgjatjen e Projektit, vendodhjen e kryerjes së shërbimit/veprimtarisë, financimi dhe mënyra e kryerjes së tij.

Kreu	Rreth Nesh	Legjislacioni	Regjistri	Publikime	Programi i Trasparencës	Kontakt	Denonco
Ofrimi i setit të personalizuar të instrumenteve kirurgjikale, material mjekësor steril njëpërdorimësh në sallat kirurgjikale, trajtimi i mbetjeve biologjike dhe dezinfektimi i sallave kirurgjikale.							
Data e nënshkrimit:	2015-12-10						
Lloji i kontratës:	Kontrate Shërbimesh						
Vlera e investimit:	1503282620 ALL						
Tarifa:	0 %						
Shënime:	Pagesa për shërbimet e koncesionarit do të kryhet nga buxheti i shtetit nepermjet Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor						
Kohëzgjatja në vite:	10						
Fusha e veprimtarisë:	Shëndetesi						
Çmimi i shërbimit:	0						
Vendodhja:	 Harta						
Përshkrimi:	Cmimet: Mëshkuria me intensitet të lartë 27.700 loka						

Nëse kërkon informacion të detajuar në lidhje me përmbajtjen e Kontratës dhe përcaktimit të kushteve dhe kriterëve, mënyrës së përcaktimit dhe transferimit të riskut, në fund të faqes mund të shkarkohet Kontrata e lidhur e Koncesionit/PPP-së.

Kohëzgjatja në vite:	10
Fusha e veprimtarisë:	Shëndetesi
Çmimi i shërbimit:	0
Vendodhja:	 Harta
Përshkrimi:	Cmimet: Mëshkuria me intensitet të lartë 27.700 loka
Partnerët Private	
SaniService	
Autoritetet Kontraktuese	
Ministria e Shëndetësisë	
Lista e Dokumentave	
Titulli i dokumentit	Shkarko
20161229155906-sterilizimi edit.pdf	

Të dhënat e publikuara në regjistër mund të ndihmojnë në krijimin e një tabloje të përgjithshme të Kontratave të lidhura të Koncesioneve/PPP-ve duke marrë informacion në lidhje me:

- Llojin e Kontratës
- Fushën
- Kohëzgjatjen
- Vlerën e investimit
- Të dhënat e operatorëve
- Mënyrën e financimit

Këto të dhëna shërbejnë si pikënisje për të thelluar monitorimin në lidhje me përmbushjen e kritereve ligjore të dhënies së Koncesioneve/PPP-ve dhe mënyrës së zbatimit të Kontratave.

2.2 Programet e transparencës


Ligji për të Drejtën e Informimit (Nenet 4 deri në 6) parashikon se çdo Autoritet Publik duhet të miratojë dhe të zbatojë një "program institucional të transparencës". Programi institucional i transparencës, në thelb konsiston në tërësinë e informacionit që duhet të bëhet publik “ex officio” (pa kërkesë) nga Autoriteti Publik, i cili duhet ta përgatisë këtë informacion paraprakisht në një format lehtësisht të kuptueshëm dhe të aksesueshëm, mandej ta publikojë në faqen përkatëse të internetit.⁶⁴

Një nga informacionet që duhet të publikohet pa kërkesë janë dhe Procedurat e Koncesioneve/PPP-ve. Publikimi i këtyre informacioneve/dokumentacionit sjell jo vetëm transparencë të institucionit në lidhje me mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë, menaxhimit të buxhetit të shtetit, por rrit besimin e publikut dhe ndikon në krijimin e një situate të barabarë dhe të paanshme midis konkurrentëve pjesëmarrës në Procedurat e Koncesioneve/PPP-ve.

Me qëllim që të njiheni me planin e institucioneve publike në lidhje me iniciimin e Procedurave të Koncesionit/PPP-ve, Projektet e realizuara dhe Kontratave të lidhura, duhet të aksesoni faqet zyrtare të internetit të institucionit.

Për të ilustruar aksesimin e informacionit, i cili është publikuar në mënyrë “ex officio” nga institucioni publik, është marrë si shembull faqja zyrtare e Ministrisë së Financave, duke qenë se është dhe institucioni mbikëqyrës i Procesit të Koncesioneve/PPP-ve.

⁶⁴ Udhëzues i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Autoritetet publike në zbatim të Ligjit për të Drejtën e Informimit”, aksesuar https://idp.al/ep-content/uploads/2024/04/Udhezues_kush_eshte_AP.pdf



Pasi kemi aksesuar faqen zyrtare të internetit të institucionit, klikojmë në rubrikën “Programi i transparencës”. Programi i transparencës përfshin disa nënrubrika, një nga të cilat është dhe informacioni mbi Procedurat e Prokurimit Publik dhe Koncesionit/PPP-ve. Pasi klikojmë në nënrubrikën “*Informacione për Procedurat e Prokurimit/Procedurat e Koncesionit*”, do të shfaqen:

- Regjistri i realizimit të prokurimit publik;
- Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik;
- Lista e kontratave të lidhura;

Duhet të theksojmë që nuk bëhet një ndarje midis të dhënave për Procedurat e Prokurimit Publik me Procedurat e Koncesionit/PPP-të. Duke iu referuar kritereve të përcaktuara në këtë Manual dhe të dhënave të marra nga regjistri i Koncesioneve/PPP-ve mund të identifikojmë të dhënat që lidhen me PPP-të, të cilat do jenë dhe objekt i monitorimit.

Transparenca mbi Procedurat e PPP-së duhet të jetë nga momenti i fillimit të procedurës deri në fazën e përfundimit, duke përfshirë dhe fazën e monitorimit të zbatimit të Kontratës.

2.3 Informacioni në lidhje me dokumentet standarde të Procedurës së PPP-së dhe njoftimit të PPP-ve

Shpallja e Procedurave të Dhënies me Koncesion/PPP të një projekti/shërbimi, e cila fillon me njoftimin e Kontratës, që publikohet në formë elektronike në platformën elektronike të prokurimit dhe në Buletinin e Prokurimit Publik. Me qëllim monitorimin e respektimit të kritereve dhe

plotësimi të dokumentacionit në përputhje me kuadrin ligjor, dokumentacioni mund të aksesohet në faqen zyrtare të internetit të APP-së, [ëëë.app.gov.al](http://eëë.app.gov.al).

← → ↻ app.gov.al/të-tjera/arkiva/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik/arkiva-e-buletinit-të-prokurimit-publik-2025/

**AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Kërko përmbajtjen e portalit 🔍 ➡ 🇦🇱

Njoftim: Njoftohen të gjithë Autoritetet Kontraktore, Operatorët Ekonomikë, Audituesit si dhe çdo A...

KREU E-PROKURIM RRETH NESH ▾ LEGJISLACIONI ▾ DOKUMENTA PËR KONSULTIM ▾ NJOFTIME ▾ TRANSPARENCA ▾ TË TJERA ▾

> Arkiva e Buletinit të Prokurimit Publik

> **Arkiva e Buletinit të Prokurimit Publik 2025**

> Arkiva e Buletinit të Prokurimeve Publike 2024

> Arkiva e Buletinit të Prokurimit Publik 2023

> Arkiva e Buletinit të Prokurimit Publik 2022

> Arkiva e Buletinit të Prokurimit Publik 2021

> Arkiva e Buletinit të Prokurimit Publik 2020

> Arkiva e Buletinit të Prokurimit Publik 2019

> Arkiva e Buletinit të Prokurimit Publik 2018

> Arkiva e Buletinit të Prokurimit Publik 2017

PRILL 2025

[BULETINI I POSAÇËM NR.19 DATË 16.04.2025](#)

[BULETINI NR.18 DATË 14.04.2025](#)

[BULETINI I POSAÇËM NR.17 DATË 07.04.2025](#)

[BULETINI NR.16 DATË 07.04.2025](#)

[BULETINI NR.15 DATË 01.04.2025](#)

MARS 2025

[BULETINI NR.14 DATË 25.03.2025](#)

[BULETINI NR.13 DATË 17.03.2025](#)

[BULETINI NR.12 DATË 10.03.2025](#)

[BULETINI NR.11 DATË 03.03.2025](#)


SHKURT 2025

[BULETINI I POSAÇËM NR.10 DATË 25.02.2025](#)

[BULETINI NR.09 DATË 24.02.2025](#)

Activate Windows
Go to Settings to activate

Në rubrikën “Arkiva e Buletinit të Prokurimit Publik” në bazë të objektit të monitorimit, vitit, muajit, klikohet në buletin me të dhënat që kërkoni dhe ju shfaqet përmbajtja e dokumentacionit të publikuar në lidhje me një Procedurë për Dhënien e Koncesionit/PPP-së.



Edhe në faqen zyrtare të APP-së nuk kemi një kategorizim apo ndarje të llojeve të procedurave të Prokurimit Publik dhe Koncesioneve/PPP-ve. Duke i ndërthurur informacionet e marra nga faqe të ndryshme, mund të arrihet përfitimi i të dhënave sasiore, të cilat shërbejnë si indicie për të thelluar kërkimet me qëllim përfitimin e të dhënave cilësore, të cilat mundësojnë monitorimin e Procedurave Konkrete të PPP-ve.

Krahas aksesimit të faqeve të mësipërme, një burim i rëndësishëm i përfitimit të të dhënave dhe identifikimit të kriterëve të zbatimit të ligjit në lidhje me Dhënien e Procedurave të PPP-ve janë dhe raportet zyrtare të institucioneve, periodike apo vjetore, si dhe raportet e auditimit, nëpërmjet të cilave mund të identifikohen në mënyrë të kryqëzuar të dhëna sasiore dhe cilësore në lidhje me Procedurat, Kontratat e PPP-ve dhe zbatimin e tyre në praktikë.

3. E drejta për të kërkuar informacion mbi një procedurë koncesioni/PPP-je

Krahas detyrimit të institucionit publik për të publikuar informacionin në mënyrë "ex officio", ky i fundit ka detyrimin që të vendosë në dispozicion të çdo personi fizik apo juridik çdo informacion që ka të bëjë me veprimtarinë e institucionit, duke përfshirë informacionin dhe/ose dokumentacionin në lidhje me Procedurat e Dhënies së Koncesioneve/PPP-ve nga momenti i inicimit të projektit e deri në përfundimin e Kontratës.

Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion publik, që ka të bëjë me veprimtarinë e organit publik, pa qenë i detyruar të shpjegojë motivet, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon të drejtën e informimit. Në rastet kur informacioni i kërkuar refuzohet, organi publik merr vendim

të arsyetuar me shkrim, i cili përmban edhe udhëzimet për ushtrimin e së drejtës për ankim dhe u njoftohet menjëherë palëve në proces. (Neni 6, K.Pr. Administrative)

E drejta për t'u informuar parashikohet në Kushtetutë, konkretisht Neni 23 parashikon:

1. *E drejta e informimit është e garantuar.*
2. *Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.*
3. *Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.*

Gjithashtu në Nenin 10 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut parashikohet:

1. *Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë. Ky nen nuk i ndalon Shtetet që të kërkojnë licensimin e ndërmarrjeve të transmetimit kinematografik ose televiziv.*
2. *Ushtrimi i këtyre lirive që përmban detyrime dhe përgjegjësi, mund t'u nënshtrohet atyre formaliteteve, kushteve, kufizimeve ose sanksioneve të parashikuara me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, integritetit territorial ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, për mbrojtjen e dinjitetit ose të të drejtave të të tjerëve, për të ndaluar përhapjen e të dhënave konfidenciale ose për të garantuar autoritetin dhe paanshmërinë e pushtetit gjyqësor.*

Autoriteti Publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç kur Ligji i posaçëm parashikon ndryshe. (Neni 15 i Ligjit 119/2014)

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në një sërë vendimesh ka konsoliduar praktikën në lidhje me publikimin e të dhënave të prokurimeve publike, përfshirë dhe PPP-të, duke u shprehur se:

*“Fryma e përgjithshme e legjislacionit për prokurimit publik, është të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik, nga ana e Autoriteteve Publike, duke bërë publik sa më tepër informacion që lidhet me këto procedura dhe jo duke e kufizuar atë.”*⁶⁵

Autoriteti Kontraktues ka detyrimin që të bëjë publik jo vetëm dokumentacionin që prodhon vetë, por dhe të gjithë dokumentacionin që administron në kuadër të Procesit të Prokurimit Publik,⁶⁶ pavarësisht llojit dhe formës së Prokurimit Publik.

SHEMBULL

⁶⁵ Vendim nr.14, datë 13.05.2022 i KDI

⁶⁶ Po aty

Autoriteti kontraktor ka lidhur kontratën e PPP-së me subjektin privat X për ndërtimin e autostradës Y. Gazetari “A” i drejtohet Autoritetit Kontraktues për vënien në dispozicion të gjithë praktikës së zhvillimit të PPP-së dhe kopjes të Kontratës së lidhur. Autoriteti Kontraktues i kthen përgjigje që dokumentacioni për Procedurat e Dhënies së PPP-së gjenden te Agjencia e Prokurimit Publik dhe ai mund të aksesohet në faqen zyrtare [ëëë.app.gov.al](http://eëë.app.gov.al).

Pyetja që ngrihet në rastin konkret:

c. A është respektuar parimi i transparencës dhe të drejtës së informimit?

Në rastin konkret nuk është zbatuar, pasi siç u analizua dhe më lart, Autoriteti Publik ka detyrimin:

- Së pari, në mënyrë proaktive të bëjë publike të gjithë informacionin dhe dokumentacionin për Zhvillimin e Procedurave dhe Dhënien e PPP-së.
- Së dyti, në rastin kur i kërkohet informacion duhet të tregojë në mënyrë të saktë linkun/adresën konkrete se ku gjendet secili dokument i kërkuar.
- Së treti, edhe në rastet kur nuk ka prodhuar një dokument, por e administron atë, është i detyruar ta vendosë në dispozicion të kërkuarit.

Në rast se institucioni publik refuzon dhënien e informacionit apo vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, personi mund t’i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit.

Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat në lidhje me marrjen e informacionit ose dokumentacionit për procedurat e PPP-së, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (Neni 24/1 i Ligjit nr.119/2014).

Në rast se Komisioneri për të Drejtën e Informimit nuk shqyrton ankesën ose vendos rrëzimin e saj, ankuesi mund t’i drejtohet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4.E drejta e informimit dhe respektimi i parimit të konfidencialitetit

E drejta për informim dhe respektimi i parimit të konfidencialitetit shpesh përplasen me njëra-tjetrën dhe në rastin e publikimit apo vënien në dispozicion të dokumentacionit, që lidhet me Procedurat e Koncesionit/PPP-së, Autoritetet Publike shpesh e justifikojnë refuzimin e dhënies së informacionit për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit apo sekretit tregtar.

Neni 15 i Ligjit për Koncesionet dhe PPP-të është një dispozitë blankete, e cila parashikon parimin e konfidencialitetit, por për rregullat dhe mënyrën e zbatimit të tij referon te Ligji për Prokurimin Publik.

Në Nenin 16 të Ligjit për Prokurimin Publik, parashikohet e drejta e një Operatori Ekonomik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, mund të mos bëjë publik ose shpërndajë informacione të caktuara, përfshirë sekretet teknike ose tregtare, veçoritë konfidenciale të ofertave dhe kërkesave për pjesëmarrje.

Nëse Operatori Ekonomik e ka klasifikuar informacionin si konfidencial, ai është i detyruar të cilësojë bazën juridike mbi të cilën ky informacion është klasifikuar si i tillë.

Operatori Ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera, që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Ligj ose në legjislacionin e brendshëm, në veçanti legjislacioni në fuqi për të drejtën e informimit, dhe pa cënuar detyrimet që lidhen me publikimin e Kontratave të dhëna dhe me informimin e kandidatëve dhe ofertuesve sipas parashikimeve në këtë Ligj, Autoriteti ose Enti Kontraktues nuk bën publike informacionet e dërguara nga Operatorët Ekonomikë, të cilët këta të fundit i kanë përcaktuar si konfidenciale, duke përfshirë, por pa u kufizuar me sekrete teknike ose tregtare dhe aspektet konfidenciale të ofertave.

Autoriteti ose Enti Kontraktues nuk do të bëjë publike informacionin konfidencial, të dhënë nga kandidati ose ofertuesi që merr pjesë në negociata ose dialog, në një Procedurë Konkurruese me negociim, Procedurë me Negocim me Shpallje Paraprake të njoftimit të Kontratës, dialog konkurrues ose partneritet për inovacion, pa dhënien e pëlqimit të këtij të fundit, me anë të një deklarate me shkrim. Kjo deklaratë nuk mund të përdoret si pengesë për aksesimin e të gjitha informacioneve, por duhet të lidhet vetëm me informacionin në fjalë.

Autoriteti ose Enti kontraktues mund t'u kërkojë Operatorëve Ekonomikë të ruajnë natyrën konfidenciale të informacionit që Autoriteti ose Enti Kontraktues vë në dispozicion përgjatë Procedurës së Prokurimit.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit në disa vendime ka konsolidur praktikën duke u shprehur: *“Në çdo rast, sipas pikes 3 të nenit 16 të ligjit të sipërcituar, nëse operatori ekonomik e ka klasifikuar informacionin si konfidencial, ai është i detyruar të cilësojë bazën juridike mbi të cilën ky informacion është klasifikuar si i tillë, argumentim i cili nuk është paraqitur nga ana e Autoritetit Publik. Për më tepër, fryma e përgjithshme e legjislacionit për prokurimin publik, është të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik, nga ana e Autoriteteve*

Publike, duke bërë publik sa me tepër informacion që lidhet me këto procedura dhe jo duke e kufizuar atë. Po ashtu, Komisioneri vlerëson se, bazuar në pikën 6 të nenit 17 të LDI, sipas të cilit parashikohet se: "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuar. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të këtij neni është bërë ky refuzim", Autoriteti Publik, duhet të kishte vlerësuar kufizimin e pjesëve të kontratës, të cilat sipas gjykimit të tij i nënshtrohen kufizimeve të trajtuara me siper, duke vënë në dispozicion të kërkuar pjesën tjetër të informacionit.

Sa më sipër, është detyrë e institucionit publik që të hetojë rast pas rasti nëse informacioni i kërkuar prek të drejtën e konfidencialitetit dhe në çfarë mase e prek, duke balancuar respektimin e dy të drejtave.

5.Indikatorët për monitorimin e transparencës dhe respektimit të së drejtës së informimit nga institucionet publike

Me qëllim monitorimin e transparencës së intitucioneve dhe respektimit të së drejtës për informim, monitorimi duhet të orientohet drejt indikatorëve cilësorë dhe sasiorë. Disa nga indikatorët mund të jenë:

	Treguesi i performancës	Po/Jo
	A janë publikuar dokumentet standarde për Zhvillimin e Procedurës së Koncesionit/PPP-së?	
	A janë publikuar kushtet/kriteri dhe dokumentacioni i kërkuar për Zhvillimin e Procedurës së PPP-së:	
	Emri, adresa, numri i telefonit, numri i faksit dhe adresa e postës elektronike të Autoritetit Kontraktues;	
	Lloji, subjekti dhe objekti i Koncesionit;	
	Vendndodhja e veprimtarisë koncesionare që do të ndërmerret;	
	kohëzgjatja e Kontratës së Koncesionit;	
	vlera e parashikuar e Kontratës koncesionare;	
	afati i fundit për dorëzimin e ofertave;	
	adresa në të cilën duhet të dërgohen ofertat;	
	gjuha/gjuhët dhe shkrimi/shkrimet, në të cilën/cilat duhet të hartohen ofertat;	
	koha dhe vendi i hapjes publike të ofertave;	
	kriteret në lidhje me gjendjen ligjore dhe përshtatshmërinë për të ndjekur aktivitetin profesional, aftësinë;	

	• kriteret për përjashtimin e ofertuesve;	
	• Kriteret teknike dhe profesionale, si dhe dëshmitë e të dhënat, me anë të të cilave një operator ekonomik vërteton plotësimin e kërkesave të tilla;	
	• Lloji dhe vlera e garancisë së tenderit që ofertuesit duhet të paraqesin;	
	• Kriteret për dhënien e Kontratës;	
	• Emri dhe adresa e organit përgjegjës për procedurën e shqyrtimit, si dhe të dhënat për afatet për shqyrtimin e kërkesës;	
	A është i përditësuar dhe plotësuar regjistri i publikimit të Kontratave të Koncesionit/PPP-ve?	
	A jeni drejtuar me kërkesë për informacion në bazë të Ligjit 119/2014?	
	A ju është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar?	
	A ju është vënë në dispozicion informacioni i kërkuar brenda afatit 10 ditor?	
	Nëse informacioni/dokumentacioni ju është refuzuar, a keni bërë ankim administrativ të KDMDHP?	
	A është pranuar ankimi nga KDMDHP?	
	A janë publikuar raportet tremujore të monitorimit të Zbatimit të Projektit të PPP-së?	
	A janë publikuar raportet vjetore të monitorimit të Zbatimit të Projektit të PPP-së?	

RASTE STUDIMORE

Kazus nr. 1

Midis Ministrisë së Energjitikës dhe Infrastrukturës dhe operatorit ekonomik (bashkimit të shoqërive Y) në datën 01.01.2010 është lidhur kontrata e PPP-së me objekt “Ndërtimin e HEC në lumin X për një afat 20-vjeçar. Në datën 05.05.2020 palët kontraktuese bëjnë një ndryshim të kontratës, duke ritur vlerën e financimit nga buxheti i shtetit për shkak të ndryshimeve ligjore, rritjes së çmimit të zërave të Projektit.

Treguesit e realizimit/indikatorët

- A është kryer procedura për ndryshimin e Kontratës në përputhje me kuadrin ligjor?
- A është ndryshimi i vlerës së financimit një nga kushtet thelbësore të Kontratës?
- A është marrë miratimi i Ministrisë përgjegjëse për financat për ndryshimin?
- Nëse rritja e vlerës së financimit është një kusht thelbësor, a është marrë miratimi nga Këshilli i Ministrave?
- A janë kryer monitorime në lidhje me ecurinë 10-vjeçare të Projektit?
- A janë kryer raportime periodike çdo tre muaj në lidhje me Projektin, risqet etj.?
- A ka pasur raste kur Operatori Ekonomik nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale?
- A janë marrë masa nga Autoriteti Kontraktues?
- Bazuar në raportet e monitorimit, a janë dhënë rekomandime nga ana e Ministrisë përgjegjëse për financat?

LITERATURA

- Kaja, D. Doktoratura “Partneriteti Publik Privat, Koncesionet si një mënyrë menaxhimi dhe financimi i shërbimeve publike”, aksesuar në datën 29.01.2025 në linkun [Doktoratura-Durim-Kraja-Fakulteti-Ekonomik-Departamenti-i-Manaxhimit_2 PPP.pdf](#)
- Manualin i Auditimit të Projekteve të Partneritetit Privat Publik (PPP), Kontrolli i Lartë i Shtetit
- Ruth Nielsen, Law Department, Copenhagen Business School
<https://arbetsratt.juridicum.su.se/filer/pdf/kLaw46/discrimination.procurement.pdf>
- Zhidro, A.& Kurti, A. “Kryerja e një vepre penale, kriter skualifikues për të marrë pjesë në prokurimet publike dhe përfitimin e fondeve publike. Rastet përjashtimore.” Konferencë Shkencore, organizuar nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë, 18 shkurt 2021
- Komentari i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, SIGMA, aksesuar në:
https://www.drejtesia.gov.al/wpcontent/uploads/2018/05/Komentari_i_kodit_te_procedurave_administrative_te_Republikes_se_shqiperise nga_SIGMA_edition_April_2018.pdf
- [Kapitulli 1 - Partneriteti Publik-Privat - Hyrje dhe Pasqyrë.pdf](#)
- Udhëzues i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale “Autoritetet publike në zbatim të Ligjit për të Drejtën e Informimit”, aksesuar https://idp.al/wp-content/uploads/2024/04/Udhezues_kush_eshte_AP.pdf
- Raporti vjetor i Minsitrisë së Financës dhe Ekonomisë

Jurisprudenca

- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 70 datë 27.12.2023;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 20.04.2021;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 16.01.2017;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 05.07.2021;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 20.04.2021;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 16, datë 01.03.2017;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 20.12.2005;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.02.2007;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 12.02.2010;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 12.11.2008.
- Vendim i Gjykatës kushtetuese nr.34, datë.20.12.2005.
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.34, datë 20.12.2005;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.4, datë 12.02.2010;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr.24, datë 12.11.2008;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 20, datë 15.04.2015;

- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 4 datë 23.02.2016.
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 9, datë 26.02.2007;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 43 datë 26.06.2015;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 36, datë 15.10.2007;
- Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 5 datë 05.02.2015;
- Vendim nr.14, datë 13.05.2022, i KDIMDHP

Faqe interneti

- http://atrako.gov.al/?page_id=973
- <https://financa.gov.al/ëp-content/uploads/2024/06/RVP-2023-.pdf>
- <https://ppp-certification.com/sites/ëëë.ppp-certification.com/files/documents/Kapitulli%201%20-%20Partneriteti%20Publik-Privat%20-%20Hyrje%20dhe%20Pasqyr%C3%AB.pdf>
- <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/AL-STUDIM-FIZIBILITETI-VIA.pdf>
- <https://www.app.gov.al/legjislacioni/koncesionetppp/dokumente-standarde/>
- Udhëzues: <https://ppp-certification.com/sites/www.ppp-certification.com/files/documents/Kapitulli%201%20-%20Partneriteti%20Publik-Privat%20-%20Hyrje%20dhe%20Pasqyr%C3%AB.pdf>
- https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf
- <https://altax.al/raporti-i-dhjetorit-2022-i-fmn-per-shqiperine-qendrimi-e-autoriteteve-shqiptare-dhe-mendimi-jone/>
- [file:///C:/Users/User/Downloads/mcs102723-albania-alb-staff-concluding-statement-of-the-2023-article-iv-mission%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/User/Downloads/mcs102723-albania-alb-staff-concluding-statement-of-the-2023-article-iv-mission%20(1).pdf)

Kuadri ligjor

- Kushtetuta
- Kodi Procedurës Administrative
- Kodi Civil
- Kodi Penal
- Direktivat 2014 /23/BE “*Mbi dhënien e kontratave të koncesionit*”
- Ligj nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”
- Ligji nr. 125/2013 “Për koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”, I ndryshuar
- Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, I ndryshuar
- VKM nr. 575, datë 10.7.2013 “Për miratimin e rregullave për vlerësimin dhe dhënien me koncesion/partneritet publik privat,” i ndryshuar
- Udhëzimin nr.35, datë 12.12.2019, e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

